

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

VJETARI 2017



38

PRISHTINË
2018

VJETARI 2017

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

YEAR-BOOK 2017

38



PRISHTINA
2018

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

VJETARI 2017

38



Redaktor

Isuf Krasniqi

Sekretar shkencor

i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

PËRMBAJTJA

PËRBËRJA E AKADEMISË

A. KRYESIA.....	7
B. ANËTARËT E AKADEMISË.....	7
I. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË	7
II. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE	7
III. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS	8
IV. SEKSIONI I ARTEVE.....	8
V. ANËTARËT IN MEMORIAM	8
VI. ANËTARËT JASHTË TRUPIT TË PËRHERSHËM TË PUNËS.....	9
VII. ANËTARËT E JASHTËM.....	9
VIII. ANËTARË NDERI.....	10
C. SHËRBIMET ADMINISTRATIVE, PROFESIONALE DHE TEKNIKE.....	10
RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2017	11
I. KUVENDI	13
II. KRYESIA.....	13
III. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË	28
IV. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE	31
V. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS	33
VI. SEKSIONI I ARTEVE.....	37
VII. SHËRBIMET ADMINISTRATIVE, PROFESIONALE E TEKNIKE.....	39
PROGRAMI I PUNËS SË ASHAK-ut PËR VITIN 2018	45
PROCESVERBALET E KUVENDIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË	
ARTEVE TË KOSOVËS.....	61
KRONIKË - 2017	73

A. KRYESIA

Akademik **Hivzi Islami**, kryetar,
Akademik **Ali Aliu**, nënkryetar,
Akademik **Isuf Krasniqi**, sekretar i përgjithshëm,
Akademik **Eqrem Basha**, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë,
Anëtar korrespondent **Jusuf Bajraktari**, sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore,
Akademik **Fejzullah Krasniqi**, sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës,
Anëtar korrespondent **Luan Mulliqi**, sekretar i Seksionit të Arteve.

B. ANËTARËT E AKADEMISË

I. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Ali Aliu (1934), i zgjedhur më 2000,
Eqrem Basha (1948), i zgjedhur më 2004,
Idriz Ajeti (1917), i zgjedhur më 1975,
Mehmet Kraja (1952), i zgjedhur më 2008,
Rexhep Ismajli (1947), i zgjedhur më 1996,
Rexhep Qosja (1936), i zgjedhur më 1975,
Sabri Hamiti (1950), i zgjedhur më 2008.
Zejnullah Rrahmani (1952), i zgjedhur më 2016.

b) Anëtarët korrespondentë:

Bardh Rugova (1974) i zgjedhur më 2016,
Kujtim Shala (1974), i zgjedhur më 2016,
Mehmet Halimi (1937), i zgjedhur më 2012.

II. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Anton K. Berishaj (1954), i zgjedhur më 2016,
Ekrem Murtezai (1931), i zgjedhur më 2000,
Hivzi Islami (1946), i zgjedhur më 2000,
Isa Mustafa (1951), i zgjedhur më 2012,
Jusuf Bajraktari (1948), i zgjedhur më 2016.

b) Anëtarët korrespondentë:

Arsim Bajrami (1960), i zgjedhur më 2012,
Edi Shukriu (1950), e zgjedhur më 2012,
Frashër Demaj (1973), i zgjedhur më 2016,
Gjyljeta Mushkolaj (1963), e zgjedhur më 2016,
Justina Pula (1953), e zgjedhur më 2016,
Muhamedin Kullashi (1949), i zgjedhur më 2016.

III. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Fejzullah Krasniqi (1953), i zgjedhur më 2012,
Feriz Krasniqi (1931), i zgjedhur më 2000,
Isuf Krasniqi (1948), i zgjedhur më 2012,
Minir Dushi (1929), i zgjedhur më 1979,
Nexhat Daci (1944), i zgjedhur më 1996.

b) Anëtarët korrespondentë:

Arsim Morina (1956), i zgjedhur më 2012,
Fetah Podvorica (1968), i zgjedhur më 2016,
Myzafere Limani (1954), e zgjedhur më 2016,
Qamil Haxhibeqiri (1949), i zgjedhur më 2012,
Salih Gashi (1944), i zgjedhur më 2012.

IV. SEKSIONI I ARTEVE

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Rauf Dhomi (1945), i zgjedhur më 1996,
Rexhep Ferri (1937), i zgjedhur më 2000,
Tahir Emra (1938), i zgjedhur më 2008,
Zeqirja Ballata (1943), i zgjedhur më 2000.

b) Anëtarët korrespondentë:

Luan Mulliqi (1953), i zgjedhur më 2012,
Xhevdet Xhafa (1934), i zgjedhur më 2012.

V. ANËTARËT IN MEMORIAM

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Agim Çavdërbasha,
Ali Hadri,
Ali Podrimja,

Besim Bokshi,
Dervish Rozhaja,
Engjëll Berisha,
Esat Stavileci,
Enver Gjerqeku,
Esad Mekuli,
Fehmi Agani,
Gazmend Zajmi,
Jashar Rexhepagiq,
Latif Susuri,
Mark Krasniqi,
Muharrem Berisha,
Musa Haxhiu,
Muslim Mulliqi,
Osman Imami,
Pajazit Nushi,
Remzi Bakalli,
Syrja Popovci,
Vladeta Vukoviq,
Vukasin Filipoviq.

b) Anëtarët korrespondentë:

Anton Pashku,
Eshref Ademaj,
Hajredin Hoxha,
Ibrahim Rugova,
Ruzhdi Pllana.

VI. ANËTARËT JASHTË TRUPIT TË PËRHERSHËM TË PUNËS

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Sinan Hasani (letërsi), Serbi, i zgjedhur më 1986.

b) Anëtarët korrespondentë:

Zef Mirdita (histori), Kroaci, i zgjedhur më 1991.

VII. ANËTARËT E JASHTËM

Aleksandar Stipçeviq (histori), Kroaci, i zgjedhur më 1983,
Ismail Kadare (letërsi), Shqipëri, i zgjedhur më 1991,
Wilfried Fiedler (gjuhësi), Gjermani, i zgjedhur më 1991,
Eric Hamp (gjuhësi), i zgjedhur më 1991,

Shaban Demiraj (gjuhësi), Shqipëri, i zgjedhur më 1996,
Gunnar Svane (gjuhësi), Danimarkë, i zgjedhur më 1996,
Kristian Gyt (histori e kulturës), Francë, i zgjedhur më 1996,
Gjelosh Gjokaj (art figurativ), Gjermani, i zgjedhur më 1996,
Leonard Newmark (gjuhësi), SHBA, i zgjedhur më 2000,
Robert Elsie (letërsi), Kanada, i zgjedhur më 2000,
Michel Roux (gjeografi, gjeopolitikë), Francë, i zgjedhur më 2000,
Muhamedin Kullashi (filozofi), Francë, i zgjedhur më 2000,
Tomë Berisha (elektroteknikë), Kroaci, i zgjedhur më 2000,
Noel Malcolm (histori), Angli, i zgjedhur më 2004,
Victor Friedman (gjuhësi), SHBA, i zgjedhur më 2004,
Emin Riza (arkitekturë), Shqipëri, i zgjedhur më 2008,
Françesko Altimari (gjuhësi), Itali, i zgjedhur më 2008,
Muhamet Mufaku (histori), Jordan, i zgjedhur më 2008,
Alajdin Abazi (elektroteknikë), Maqedoni, i zgjedhur më 2012,
Kolec Topalli (gjuhësi), Shqipëri, i zgjedhur më 2012,
Oliver Schmit (histori), Austri, i zgjedhur më 2012,
Radoslav Katicic (gjuhësi), Kroaci, i zgjedhur më 2012,
Bahri Beci (gjuhësi), Shqipëri, i zgjedhur më 2016,
Matteo Mandala (gjuhësi), Itali, i zgjedhur më 2016,
Mentor Petrela (mjekësi), Shqipëri, i zgjedhur më 2016,
Kristaq Prifti (histori), Shqipëri, i zgjedhur më 2016.

VIII. ANËTARË NDERI

Ferid Murati, nobelist, jeton në SHBA, i zgjedhur më 2000.

C. SHËRBIMET ADMINISTRATIVE, PROFESIONALE E TEKNIKE

Lendita Juniku Pula, sekretare e Akademisë,
Ali Caka, drejtor i Departamentit të Përkrahjes Profesionale dhe të
 Teknologjisë së Informacionit e Komunikimeve,
Vjollca Hykolli, drejtoreshë e Departamentit Financiar,
Hilmi Zogjani, drejtor i Departamentit të Bibliotekës dhe Arkivit,
Furtuna Naka, udhëheqëse e prokurimit,
Taulant Veseli, administrator i lartë i sistemeve të TIK-ut,
Burim Rexhepi, zyrtar i lartë i redaktimit teknik,
Hasime Maliqi, zyrtare certifikuese,
Premtim Farizi, zyrtar i TI-së për përkrahje,
Rejhane Ajeti Islami, zyrtare e bibliotekës dhe këmbimit
Lirijeta Bunjaku, zyrtare e lartë për buxhet dhe financa,
Xhemshit Brajshori, zyrtar i lartë i komunikimit dhe përkthyes,

Dafina Kavaja, asistente ekzekutive,
Lidije Kelmendi, zyrtare e librarisë,
Bedri Pllana, zyrtar bibliotekar,
Avdi Gashi, zyrtar i logjistikës,
Alban Bytyçi, vozitës-korrier,
Valbona Olluri, zyrtare teknike.

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2017



I. KUVENDI

Organi më i lartë i qeverisjes - Kuvendi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në vitin 2017 është mbledhur tri herë. Për herë të parë më 16 mars 2017 (Mbledhja XCI), për herë të dytë më 29 qershor (Mbledhja XCII) dhe për herë të tretë më 21 dhjetor (Mbledhja XCIII).

I. Në mbledhjen e parë të këtij viti (Mbledhja XCI), si zakonisht, përveç miratimit të procesverbalit nga mbledhja pararendëse, u shqyrtuan edhe pikat: Raporti mbi punën e Akademisë për vitin 2016; Raporti financiar i Akademisë për vitin 2016; Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë së Akademisë; Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për veprimtarinë botuese; Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për honorarët e veprimtarisë botuese dhe çështje vijuese.

Mbledhjen e hapi Kryetari Islami, i cili bëri një vështrim të punës së Akademisë për vitin 2017. Fjala e kryetarit është pasqyruar në procesverbalin e mbledhjes së Kuvendit.

Pas fjalës së Kryetarit filloi shqyrtimi i pikave të rendit të ditës.

Kuvendi shqyrtoi Raportin e punës së ASHAK për vitin 2016, me radhë sipas seksioneve. Raporti u miratua njëzëri dhe do të botohet në Revistën Vjetari 2016.

Kuvendi shqyrtoi edhe Raportin financiar për vitin 2016. M. Kraja shtroi

pyetjen se pse Raporti kësaj radhe ndryshon nga ai i vitit të kaluar? L. Pula sqaroi se kodet në raport janë të përcaktuara nga Ministria e Financave, ndërsa kësaj radhe është bërë një zbërthim më i detajuar, vetëm për shkak që shënimet të jenë më të qarta dhe sa më transparente. N. Daci në diskutimin e tij propozoi që në të ardhmen të ndahen më shumë mjete për pajisje të teknologjisë së informacionit, ashtu që kabinetet të jenë më të pajisura.

Pas diskutimeve Kuvendi njëzëri miratoi Raportin financiar për vitin 2016, i cili po ashtu është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe do të botohet në revistën Vjetari 2016.

Më pas filloi shqyrtimi i draftit të Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë së Akademisë. Në diskutimet e tyre L. Mulliqi, A. Bajrami, M. Kraja, R. Dhomi paraqitën disa vërejtje dhe sugjerime për Statutin dhe rregulloret e miratuara më parë. N. Daci në diskutimin e tij tha se çështja e Statutit dhe e Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë, nuk është në rendin e ditës të kësaj mbledhjeje, prandaj nuk ka vend sot për diskutim. Edhe Z. Rrahmani, propozoi që Kuvendi t'i përmbahet rendit të ditës dhe të vazhdohet me shqyrtimin e rregulloreve.

Pas diskutimeve Kryetari Islami vazhdoi mbledhjen sipas rendit të ditës. Ai sqaroi se gjatë afatit shtatë ditor nga të gjithë anëtarët e Akademisë vetëm tre prej tyre: Mehmet Kraja, Rauf Dhomi dhe Fetah

Podvorica kanë paraqitur disa vërejtje dhe sugjerime me shkrim, për plotësimin e drafteve të rregulloreve të reja. Grupi punues është mbledhur dhe i ka shqyrtuar të gjitha shkresat. Propozimi i R. Dhomit nuk është inkorporuar meqë bie ndesh me Ligjin dhe Statutin e Akademisë, ndërsa propozimi i F. Podvoricës është marrë parasysh dhe është implementuar. Vërejtje dhe sugjerime më së shumti ka paraqitur M. Kraja dhe shumica prej tyre janë inkorporuar në draftet e rregulloreve përkatëse. Rregulloret u janë lënë në dispozicion për një javë të gjithë anëtarëve të Akademisë. Po ashtu materialet e Kuvendit u janë ndarë 15 ditë përpara të gjithë anëtarëve të Akademisë. Kohë për t'i lexuar dhe shqyrtuar ka pasur mjaftueshëm. Ai më pas tha se sot jemi këtu për t'i shqyrtuar draftet që i kemi përpara, shkojmë nen për nen dhe ku ka ndërhyrje diskutojmë.

Pas diskutimeve filloi shqyrtimi i Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë së Akademisë, nen për nen. Rregullorja u miratua me 32 vota për dhe një kundër (R. Dhomi).

Kuvendi shqyrtoi nen për nen edhe draftin e Rregullores për veprimtarinë botuese. Rregullorja u miratua unanimit, me disa plotësime të vogla, të natyrës teknike.

Sipas radhës u shqyrtua nen për nen dhe Rregullorja për honorarët e veprimtarisë botuese, e cila po ashtu u miratua unanimit.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës M. Dushi propozoi që të

mbahet një mbledhje e jashtëzakonshme e Kuvendit në të cilën do të diskutohet në një pikë të veçantë të rendit të ditës për realizimin e programeve të punës shkencore dhe artistike të ASHAK-ut në periudhën e kaluar, sfidat, vlerat dhe kundërvlerat e shfaqura për gjatë këtij rrugëtimi.

Kryetari Islami tha se kërkesa e akademik Dushit për mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit duhet të shtrohet në procedurë të veçantë në përputhje me Ligjin dhe Statutin e Akademisë.

II. Në mbledhjen e XCII pas miratimit të rendit të ditës Kryetari Islami në fjalën hyrëse tha: "Para se të kalojmë te pikat e rendit të ditës, ju lus shumë që t'i përmbahemi rendit të ditës. Në mbledhjen e fundit, ju kujtohet dolëm nga rendi i ditës. Ndonëse si pikë qendrore i kishim miratimin e Programit të punës për vitin 2016 dhe pika tjera, gati e braktisëm rendin e ditës, duke mos e thënë askush asnjë fjalë të vetme për Programin e vitit paraprak, përveç meje si i detyruar të jepja një pasqyrë të shkurtër të punës. Të kërkohet që një pjesë e normave ligjore të Akademisë të abrogohen ende pa u miratuar (tri rregullore prisnin diskutimin dhe aprovimin) dhe dokumentet tjera bazike, çfarë janë Ligji dhe Statuti, ende të njomë, të ndryshohen, është diçka e paparë. Dëshiroj që diçka e tillë të mospërsëritet. Ky institucion është i të gjithëve, në si udhëheqje natyrisht që e kemi përgjegjësinë më të madhe, por institucioni është i të gjithëve.

Akademia edhe në situata dramatike në historinë e saj, ka arritur ta ruaj individualitetin dhe pavarësinë. Është investuar shumë në autonominë e kësaj themelate, që është një pasuri e madhe, por janë ruajtur edhe raportet ndërkolegjiale brenda nesh, që është gjithashtu një pasuri tjetër e madhe - në komisione e grupe punuese, në redaksi, në seksione, në Kryesi, në Kuvend, me gjithë mospajtimet për çështje të ndryshme. Dhe duhet të mos pajtohemi për çështje të karakterit të punës, të perspektivës së këtij institucioni, sepse mospajtimi këtu del pozitiv”.

Më pas Kuvendi miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes pararendëse dhe filloi shqyrtimin e Programit të punës të ASHAK-ut për vitin 2018.

Kryetari Islami në fjalën e tij bëri një përshkrim të përgatitjes së Programit të punës. Fjala e Kryetarit pasqyrohet e plotë në Procesverbalin e mbledhjes përkatëse të Kuvendit.

Më pas filloi shqyrtimi i Programit të punës me radhë sipas seksioneve. Kryetari Islami tha se sekretarët e seksioneve dhe sekretari shkencor nëse kërkohet mund të shtojnë apo të arsyetojnë diçka, në çdo moment gjatë diskutimit. M. Kraja në diskutimin e tij kërkoi disa sqarime rreth programit të punës së SSHSH dhe paraqiti disa sugjerime për përmirësime të natyrës teknike. Sa i përket organizimit të konferencës shkencore: Teatri si temë e mendimit filozofik - Raportet midis teatrit bashkëkohor dhe teatrit modern

evropian dhe simpoziumit shkencor: Pavarësia e Kosovës dhe sfidat e shtet ndërtimit, M. Kraja propozoi që të dy këto aktivitete të organizohen në nivel të Akademisë e jo vetëm të seksionit të SHSH.

J. Bajraktari më pas ofroi sqarimet e kërkuara për programin e punës së SSHSH, ndërsa për aktivitetet shkencore tha se ato janë propozuar nga SSHSH, por kur të fillojnë përgatitjet (ngritja e këshillit organizativ) mund të ketë përfshirje edhe të seksioneve të tjera.

Diskutuan H. Islami, N. Daci, R. Ismajli dhe pas diskutimeve Kuvendi miratoi njëzëri Programin e punës për vitin 2018, i cili është bashkëlidhur procesverbalit.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kuvendi u njoftua për buxhetin dhe planin financiar të ASHAK-ut, bazuar në Qarkoren buxhetore 2018/1.

L. Pula sqaroi se Qarkorja në fjalë është shqyrtuar dhe miratuar nga Kryesia e Akademisë dhe se me Statutin e ri të Akademisë ajo duhet të miratohet edhe në Kuvend.

M. Kraja kërkoi sqarime për pjesën e kategorisë shpenzime kapitale, përkatësisht për mjetet e ndara në vlerë prej 255,000.006. L. Pula sqaroi se mjetet janë ndarë sipas kërkesës së ASHAK-ut, një pjesë e tyre janë të dedikuara për blerjen e pajisjeve të sofistikuara të TI, dhe pjesa tjetër për ndërhyrje në mjediset ku do të vendosen pajisjet dhe pjesët përcjellëse të tyre. Ajo tha se brenda dy ditëve do t'iu dërgojë të gjithë

anëtarëve të Akademisë nëpër kabinete, të gjitha dokumentet që lidhen me projektin në fjalë.

Kuvendi njëzëri miratoi buxhetin dhe planin financiar të ASHAK-ut, bazuar në Qarkoren buxhetore 2018/1.

III. Mbledhja e tretë e Kuvendit (XCIII) u mbajt më 21 dhjetor.

Kryetari Hivzi Islami pasi u uroi mirëseardhje të gjithë anëtarëve të Akademisë njoftoi Kuvendin se nga 38 anëtarë sa ka Akademia, në sallë janë të pranishëm 35 anëtarë, kuorum ka dhe se Kuvendi mund të vazhdojë me punë. Ai propozoi që bazuar në Statutin e Akademisë, neni 29, të mos përfshihen në kuorum akademikët Idriz Ajeti dhe Rexhep Qosja. Propozimi u miratua unanimisht. Ai po ashtu njoftoi se bazuar në aktet normative të ASHAK-ut, kandidatë të zgjedhur konsiderohen ata që fitojnë shumicën e votave të anëtarëve të rregullt dhe të anëtarëve korrespondentë të Akademisë, që do të thotë 19 vota.

Në vazhdim Kryetari Islami njoftoi Kuvendin se zgjedhjet për Kryesinë e Akademisë kanë filluar me kohë dhe në përputhje me aktet normative të Akademisë. Janë mbajtur mbledhjet I dhe II të seksioneve dhe nga ato kanë dalë propozimet:

Për Kryetar e kanë fituar të drejtën e kandidimit dy kandidatë: Nexhat Daci i kandiduar në tri seksione dhe Sabri Hamiti i kandiduar në një seksion, por në ndërkohë Sabri Hamiti është tërhequr për arsye personale, prandaj në garë mbetet vetëm Nexhat Daci.

Për Nënkryetar e ka fituar të drejtën e kandidimit akademik Jusuf Bajraktari, i kandiduar në tri seksione;

Për Sekretar shkencor e kanë fituar të drejtën e kandidimit dy kandidatë: Fejzullah Krasniqi, i kandiduar në një seksion dhe Myzafer Limani, e kandiduar në dy seksione.

Ai propozoi përbërjen e Komisionit të zgjedhjeve për zgjedhjen e Kryesisë së Akademisë: Feriz Krasniqi, kryetar, dhe Zeqirja Ballata, Zejnullah Rrahmani dhe Edi Shukriu, anëtarë. Propozimi u miratua njëzëri nga Kuvendi.

Komisioni i zgjedhjeve i përgatiti dhe i shpërndau fletëvotimet për zgjedhjen e Kryetarit, Nënkryetarit dhe të Sekretarit shkencor të Akademisë. Pas votimit me vota të fshehta, Komisioni i votimeve u tërhoq, i numëroi votat dhe konstatoi se votimi ka dhënë këto rezultate:

1. Për zgjedhjen e Kryetarit të Akademisë: votuan 35 anëtarë të ASHAK-ut. U gjetën 23 fletëvotime të vlefshme dhe 12 të pavlefshme.

Kandidati Nexhat Daci mori 23 vota dhe u zgjodh Kryetar i Akademisë, për mandatin e përcaktuar me Statut.

2. Për zgjedhjen e Nënkryetarit të Akademisë: votuan 35 anëtarë të ASHAK-ut. U gjetën 21 fletëvotime të vlefshme dhe 14 të pavlefshme.

Kandidati Jusuf Bajraktari mori 21 vota dhe u zgjodh Nënkryetar i Akademisë, për mandatin e përcaktuar me Statut.

3. Për pozitën e Sekretarit shkencor të Akademisë u votua dy herë.

Në votimin e parë:

Votuan 35 anëtarë të ASHAK-ut. U gjetën 31 fletëvotime të vlefshme dhe 4 të pavlefshme.

Kandidati Fejzullah Krasniqi mori 14 vota

Kandidatja Myzaferë Limani mori 17 vota.

Më pas, sipas Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë së Akademisë, neni 12, paragrafi 3, votimi u përsërit për dy kandidatët që herën e parë fituan numrin më të madh të votave (M. Limani dhe F. Krasniqi).

Në votimin e dytë:

Votuan 35 anëtarë të ASHAK-ut. U gjetën 29 fletëvotime të vlefshme dhe 6 të pavlefshme.

Kandidatja Myzaferë Limani mori 19 vota.

Kandidati Fejzullah Krasniqi mori 10 vota

Kandidatja Myzaferë Limani u zgjodh Sekretare shkencore e Akademisë. për mandatin e përcaktuar me Statut.

Kuvendi po ashtu miratoi zgjedhjen e sekretarëve të seksioneve të Akademisë:

1. Akademik Eqrem Basha, Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë;
2. Anëtare korrespondente Justina Pula, Sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore;
3. Anëtar korrespondent Fetah Podvorica, Sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës;
4. Anëtar korrespondent Luan Mulliqi, Sekretar i Seksionit të Arteve.

Pas përfundimit të votimit Kryetari

Islami uroi zgjedhjen e Kryesisë së re. Fjala e Kryetarit pasqyrohet në Procesverbalin e mbledhjes përkatëse, ndërsa akademik Nexhat Daci pas zgjedhjes Kryetar i Akademisë, i uroi edhe të zgjedhurit e tjerë të Kryesisë.

Kuvendi në kuadër të kësaj mbledhjeje shqyrtoi Rregulloren për përdorimin e mjeteve financiare të donacionit për stimulimin e zhvillimit të punës shkencore-kërkimore të të rinjve nga lëmi i shkencave të natyrës dhe Rregulloren për blerjen e veprave artistike. Kryetari Islami njoftoi se draftet e rregulloreve janë hartuar në koordinim me Sekretarin e Seksionit të Shkencave të Natyrës dhe Sekretarin e Seksionit të Arteve dhe se janë është shqyrtuar edhe në Kryesinë e Akademisë. Kuvendi pa asnjë votë kundër miratoi rregulloret në fjalë.

II. KRYESIA

Bazuar në kompetencat dhe obligimet e përcaktuara me Ligjin për Akademinë dhe me Statutin e saj, Kryesia e Akademisë në 14 mbledhjet e vitit 2017 është marrë me shqyrtimin e shumë çështjeve.

Në vazhdim në mënyrë kronologjike do të pasqyrohet aktiviteti i Kryesisë së Akademisë.

1. Kryesia në mbledhjen (XXV) e 18 janarit pas miratimit të procesverbalit nga mbledhja pararendëse mori vendim për shpalljen e konkursit publik për ndarjen e Shpërblimit mbështetës 2017, me kriter: për kandidatin e moshës së re që ka arritur

rezultate të rëndësishme në fushën e shkencës dhe të artit.

Më pas Kryetari Islami njoftoi Kryesinë për ndryshimet që ka bërë Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Financave. Tani e tutje kërkohet një planifikim më i saktë për shpenzimin e buxhetit sipas kodeve të përcaktuara dhe sipas afateve. Ai më pas kërkoi nga Sekretarja e Akademisë të njoftojë më hollësisht Kryesinë për çështjen në fjalë.

L. Pula sqaroi se sa i përket shpenzimit të buxhetit për punët e rëndomta, administrata do të vazhdojmë t'i kryejë sipas rregullit, por disa punë që kanë të bëjnë me veprimtarinë botuese dhe aktivitetet që lidhen me programin e punës së seksioneve të Akademisë kërkojnë trajtim në nivel më të lartë, në rastin tonë në Kryesi. Deri më tani alokimi i mjeteve është kërkuar çdo vit duke u bazuar në përvojën e vitit paraprak, duke shtuar dhe munguar aty këtu, por ka pasur mundësi të lëvizjes.

Nga ky vit Qeveria i ka ashpërsuar kriteret. Alokimi i mjeteve bëhet çdo tre muaj, ndërsa ASHAK-u obligohet të dorëzojë në MF planin e rrjedhës së parasë që tani për tërë vitin. Rëndësi paraqet çështja e veprimtarisë botuese, projektet, aktivitetet e ndryshme dhe udhëtimet zyrtare, meqë kërkohet planifikim i saktë se kur do të realizohen ato. Tani e tutje mjetet e kërkuara nëse nuk shpenzohen, gjithnjë ekziston mundësia që i tërheq Buxheti i shtetit, ndodh edhe pa paralajmërim. Vitin që shkoi pjesa më e madhe e mjeteve u shpenzua në fund të vitit, kjo për arsye

se dorëshkrimet u vonuan, me botimin e dorëshkrimit lidhet edhe pagesa e autorësisë, ashtu që u desh të shpejtojmë me pagesat për FEK.

Por nga ky vit është më vështirë sepse duhet planifikim i mirë dhe i saktë.

Çështja tjetër është FEK, që është projekt i Akademisë dhe duhet planifikuar saktë kur do të botohet Fjalori. Kostoja e tij është shumë e madhe dhe nëse realizohen të gjitha botimet e planifikuara, për botimin e Fjalorit duhet kërkuar mjetet shtesë.

Kryetari Islami kërkoi nga sekretarët e seksioneve që të angazhohen në këtë drejtim dhe të ofrojnë shënimet që kërkohen.

Në kuadër të pikës vijuese të rendit të ditës u shqyrtua raporti vjetor të punës (janar-dhjetor 2016) për projektin: "Parametrat e jashtëm projektues të klimës për disa qytete të Kosovës".

Kryesia e miratoi raportin në fjalë dhe mori vendim për pagimin e paushallëve personave të angazhuar në projekt, si më poshtë:

1. Akademik Fejzullah Krasniqi, 2,400.00€;
2. Akademik Isuf Krasniqi, 1,200.00€;
3. Dr. sc. Rexhep Selimaj, 1,600.00€;
4. Prof. dr. Fehmi Krasniqi, 500.00€;
5. Inxh. dipl. Letafete Latifi, 500.00€.

Në vazhdim Kryesia:

- Miratoi për botim dorëshkrimin jubilar për 100-vjetorin e lindjes së akademik Idriz Ajeti (përmbledhja e punimeve), në 300 kopje, si dhe vendosi të shtohet tirazhi i revistave

jubilare: Studime 4 dhe Studime 14 (80-vjetori dhe 90-vjetori i lindjes së akademik Idriz Ajetit) nga 200 kopje për secilën revistë;

- Vendosi që: z. Zeni Ballazhit t'i paguhet shuma bruto prej 300.00€ për punën që ka bërë në cilësinë e dizajnerit grafik dhe Enver Bylykbashit t'i paguhet shuma bruto prej 200.00€ për punimin e fotografive të katalogut për ekspozitën e anëtarit korrespondent Luan Mulliqi, botim i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës;

- Vendosi që Z. Millosh Lindro t'i paguhet paushalli në vlerë prej 250.00€ bruto, për lekturimin e vargjeve të përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhën maqedonase dhe për lekturimin e shënimeve të autorëve me parathënie, të përkthyer, për dorëshkrimin: Antologjia e poetëve dhe tregimtarëve të ASHAK-ut;

Njëherësh në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës, Kryetari Islami kërkoi nga Redaksia e faqesueb të ASHAK-ut të fillojnë me plotësimin e të dhënave dhe freskimin e faqesueb dhe kërkoi nga sekretarët e seksioneve të caktojnë mbledhjet e seksioneve për shqyrtimin e Raportit të punës së seksioneve.

2. Në mbledhjen (XXVI) e mbajtur më 2 shkurt Kryesia diskutoi për pamfletin e nënshkruesve lidhur me zgjedhjet. Diskutuan H. Islami, A. Aliu, J. Bajraktari, L. Mulliqi. Pas diskutimeve Kryesia miratoi përgjigjen për grupin e nënshkruesve kundër ASHAK-ut, si në vijim:

“AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE PËRGJIGJE GRUPIT TË NËNSHKRUESVE KUNDËR ASHAK-ut

Lidhur me pamfletin e pazakonshëm dhe shfryrjen e mllëfit ndaj Akademisë, të nënshkruesve lidhur me zgjedhjet, Kryesia Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës jep sqarimin vijues:

1. Zgjedhjet për anëtarë të rinj të Akademisë janë zhvilluar sipas të gjitha procedurave të parashikuara me Ligjin për Akademinë dhe me Statutin e Akademisë: janë respektuar deri në fund afatet, procedurat e propozimit, procedurat e informimit të rregullt të të gjithë anëtarëve dhe të opinionit për të gjithë kandidatët dhe brenda afitit shtatë ditor të ekspozimit të materialeve për diskutim publik, në adresë të Akademisë nuk është deponuar asnjë vërejtje për kandidatët e zgjedhur. Secili anëtar me të drejtë vote i ka marrë të gjitha informatat e disponueshme dhe ka pasur mundësinë ta formojë opinionin e vet për secilin kandidat të propozuar.

2. Pas gjithë kësaj procedure dhe pas evidentimit të vërejtjeve nga opinionit të deponuara në Akademi, instancat përkatëse kanë proceduar më tej përmes votimeve. Në Akademi kanë arritur 56 propozime, ndërsa janë pranuar 8 anëtarë të rinj; për avancim kanë konkurruar 11 dhe janë avancuar 3. Këtë herë, ndryshe nga të tjerat, janë zgjedhur tri anëtarë të reja dhe përgjithësisht anëtarë me moshë më të re.

3. Çdo kandidat është dashur të

merrte numrin e nevojshëm të votave; secili votues e drejton votën e tij sipas bindjes së vet dhe nuk i përgjigjet askujt për të. Në këtë votim të realizuar me saktësi absolute kanë dalë rezultatet që kanë dalë. Instancat e Akademisë vetëm këtë tagër kanë, nuk kanë mundësi të sigurojnë vota për askënd.

4. Pamfleti është nënshkruar nga 11 pretendentë për t'u zgjedhur anëtarë në kohë të ndryshme, në këto zgjedhje 5 syresh. Të tjerët kanë qenë më herët. Ka ndodhur shumë herë, përveç në zgjedhjet e para, që një kandidat të mos i ketë marrë votat e nevojshme në një palë zgjedhje, ndërsa të jetë zgjedhur në një tjetër më vonë. Ka dhe të atillë që nuk janë zgjedhur. Sido që të jetë, e mirëkuptojmë zemërimin e atyre që nuk janë zgjedhur. Po të ishin zgjedhur, sigurisht se nuk do të shfrynin kështu tërë atë mllaf ndaj institucionit ku synojnë të jenë dhe ndaj kolegëve të tyre në të njëjtë garë.

5. Shumica e nënshkruesve janë nga Instituti Albanologjik i Prishtinës (22), ndërsa të gjithë nga qarqet që sillen aty. Ata madje pretendojnë të japin vlerësime për punën e Akademisë. Në mesin e të nënshkruarve mungojnë vetëm emrat e nxitësve të kësaj fushate dhe shumë fushatave të tjera, që kanë urrejtje patologjike ndaj Akademisë dhe jo vetëm ndaj saj. Të nënshkruarit nga ky Institut dhe nga qarku përreth, para se ta bënin këtë, do të bënin mirë t'i drejtohen institucionit ku punojnë ose kanë punuar dhe ta pyesin veten pse u nënshtrohen fushatave e prapaskenave tashmë të

lexueshme deri edhe te vetëmandatimi i tyre për të "shitur" dhe "blerë" territore dhe për të shpërndarë cilësime për njerëzit si "patriotë" ose "tradhtarë, varësisht nga shijet e tyre.

6. Akademia i ka instancat ligjore që merren me këto çështje. Instituti Albanologjik, si të tjerët, është vetëm një nga propozuesit potencialë. Përzgjedhjen e kandidatëve nga propozimet e bëjnë instancat e Akademisë, të cilat kanë autorizim përfundimtar ligjor. Ato e marrin përgjegjësinë për suksesin ose për dështimin.

7. Bashkëpunimin e Akademisë me institucionet e tjera e bëjnë po ashtu instancat përkatëse të Akademisë sipas mundësive dhe interesave të institucionit. Instituti Albanologjik, Instituti i Historisë, Instituti i Arkeologjisë, universitetet publike janë vazhdimisht të pranishme në veprimtaritë e Akademisë. Disa prej të nënshkruarve janë pjesëtarë të projekteve të saj, ndër to edhe të Fjalorit Enciklopedik, të cilin po e zhvlerësojnë ende pa u kryer, ndërkohë që edhe vetë janë të përfshirë. Me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, Akademia jonë ka bashkëpunim të veçantë mbi bazë të marrëveshjes dhe të protokolleve që po realizohen me përpikëri.

8. Shumë prej të nënshkruarve janë të identifikueshëm fare lehtë sa i përket filiacionit edhe politik (ose të klubit intelektual), e megjithatë bëjnë vërejtje për përkatësinë partiake të të tjerëve. Ligji për Akademinë nuk ia merr të drejtën për të qenë anëtar

askujt, pavarësisht nga bindjet e tij politike ose të tjera.

9. Krejtësisht primitive tingëllojnë vërejtjet grupe të pamfletistëve lidhur me përkatësinë rajonale të anëtarëve të Akademisë në një vend ku secilën pikë nga qendra e Prishtinës e zë për një orë. Gënjeshtër nuk fshihet: nga 38 anëtarë sa ka sot Akademia, nga Presheva ka vetëm një anëtar dhe ai është pranuar më 1993, nga Bujanovci ka dy, njëri më 1993, tjetri më 1996 dhe më s'ka pasur. Ka qenë një kandidat në këto zgjedhje dhe ai nuk është kualifikuar për një votë. Por e tërë kjo e zbulon burimin e nxitjes të tërë grupit.

10. Duken paksa të çuditshme ftesat e tilla të pamfletistëve të frustruar për ndërhyrje nga jashtë në punën e institucioneve kështu të larta. Diçka e tillë i ka ndodhur kësaj Akademie edhe më herët në regjime pak si tjetër fare. As Kuvendi dhe askush tjetër nuk ka këtë të drejtë, as këtu dhe as në ndonjë akademi evropiane, të ndërhyjë për çka do qoftë në punën e Akademisë. Kuvendi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës është e vetmja instancë që merret me vlerësimin e punës së Akademisë.

KRYESIA E AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS

U tha që përgjigja t'u dërgohet të gjitha mediave të shkruara dhe elektronike.

3. Kryesia në Mbledhjen e dt.14 shkurt (XXII) pas miratimit, si zakonisht të procesverbaleve të mbledhjeve pararendëse, shqyrtoi draftet e rregulloreve: Rregullorja për

propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë së Akademisë, Rregullorja për veprimtarinë botuese dhe Rregullorja për honorarët e veprimtarisë botuese. Kryetari Islami tha se Grupi punues ka hartuar draftet e para të rregulloreve dhe propozoi që ato t'u ndahen anëtarëve të Akademisë dhe t'u lihen në dispozicion deri më 22 shkurt për të dhënë vërejtjet dhe sugjerimet eventuale. Vërejtjet dhe sugjerimet t'u dorëzohen me shkrim dhe të nënshkruara sekretarëve të seksioneve përkatëse, ashtu që sekretarët deri më 23 shkurt t'ia dërgojnë Grupit punues. Kryesia miratoi njëzëri propozimin e Kryetarit. Në vazhdim të kësaj mbledhjeje Kryesia:

- Shqyrtoi kërkesën e akademik Mehmet Krajës, Kryeredaktor i FEK dhe mori vendim për angazhimin e z. Bahri Koskoviku, që të bëjë lekturën (korrekturën) e dytë të teksteve të Fjalorit Enciklopedik të Kosovës. Pjesa e të lartpërmendurit bëhet në pajtim me Rregulloren për honorarët e veprimtarisë botuese të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, neni 8, pika a, në vlerë të përgjysmuar (50%);

- Vendosi që për mbajtjen e takimit të punonjësve të Administratës të ASHAK-ut dhe të ASHSH-së në Tiranë, sipas datave të përcaktuara nga ASHSH.

4. Në mbledhjen (XXVIII) e mbajtur më 2 mars, Kryesia shqyrtoi Raportin e punës së ASHAK-ut për vitin 2016, me radhë sipas seksioneve. Kryetari Islami

në diskutimin e tij tha se Raporti pasqyron punën e Akademisë gjatë gjithë vitit dhe është mjaft voluminoz. Vitin që shkoi janë mbajtur katër mbledhje të Kuvendit, pesëmbëdhjetë mbledhje të Kryesisë së Akademisë dhe mbledhjet e rregullta të seksioneve. Seksionet gjatë muajit shkurt i kanë shqyrtuar raportet e punës së tyre dhe i kanë sjellë për shqyrtim edhe në Kryesi. U tha se Raporti si i tillë do t'i dërgohet për miratim Kuvendit të Akademisë. Raporti është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

U Shqyrtua edhe Raporti financiar të ASHAK-ut për vitin 2016. U tha se raporti është përpiluar në detaje dhe pasqyron saktë shpenzimin e buxhetit. Raporti është pjesë përbërëse e këtij procesverballi dhe do t'i dërgohet Kuvendit të Akademisë për miratim.

Në vazhdim Kryesia u njoftua me punën e Grupit punues për hartimin e rregulloreve të ASHAK. L. Pula njoftoi Kryesinë se brenda afatit shtatë ditor katër anëtarë të Akademisë: Mehmet Kraja, Jusuf Bajraktari, Rauf Dhomi dhe Fetah Podvorica kanë paraqitur disa vërejtje dhe sugjerime me shkrim, për plotësimin e drafteve të rregulloreve të reja. Grupi punues është mbledhur dhe i ka shqyrtuar të gjitha shkresat. Sugjerimet e J. Bajraktarit dhe R. Dhomit nuk janë inkorporuar meqë bien ndesh me Ligjin dhe Statutin e Akademisë, ndërsa propozimi i F. Podvoricës është marrë parasysht dhe është implementuar. Vërejtje dhe sugjerime më së shumti ka paraqitur M. Kraja

dhe shumica prej tyre janë inkorporuar në draftet e rregulloreve përkatëse.

Më pas Kryesia diskutoi për dy propozime të M. Krajës për të cilat Grupi punues ka dilema.

-Propozimi i parë ka të bëjë me plotësimin e nenit 8 të Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë së Akademisë, ku propozohet që në rrethin e parë të votohet me vota të fshehta për nominimin e kandidatëve dhe më pas nga radhët e kandidatëve të nominuar, anëtarët e seksionit me vota të fshehta të votojnë propozimet për zgjedhjen e kandidatëve për funksionet e caktuara.

Për propozimin e në fjalë diskutuan H. Islami, A. Aliu, E. Basha dhe F. Krasniqi dhe të gjithë shprehën mendimin e njëjtë, se kjo procedurë nuk sjell ndonjë ndryshim, nga ajo që është paraparë në draftin e Rregullores, vetëm se e komplikon dhe e zgjatë procesin e votimit në seksione.

-Propozimi i dytë ka të bëjë me plotësimin e nenit 3, paragrafi 5, ku propozohet që plani botues vjetor i Akademisë të hartohet me dorëshkrime të recensionuara.

Edhe për këtë propozim diskutuan shumica e anëtarëve të Kryesisë. U tha se propozimi është i drejtë por është vështirë të implementohet, meqë programi i punës së ASHAK-ut është vjetor dhe se një gjë e tillë merr kohë.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje Kryesia vendosi të thërrasë mbledhjen e XCI të Kuvendit të Akademisë dhe caktoi

këtë rend dite: miratimi i procesverbalit të mbledhjes së XC të Kuvendit; Miratimi i Raportit të punës të ASHAK-ut për vitin 2016; Miratimi i Raportit financiar të ASHAK-ut për vitin 2016; Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë së Akademisë; Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për veprimtarinë botuese; Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për honorarët e veprimtarisë botuese, dhe çështje vijuese.

5. Mbledhja (XXIX) e Kryesisë mbajtur më 30 mars, Kryesia u mor me një varg çështjesh:

- Caktoi Këshillin për Bashkëpunim Ndërkombëtar të ASHAK-ut, në përbërje prej:

1. Akademik Rexhep Ismajli;
2. Akademik Rexhep Ferri;
3. Anëtare korrespondente Myzafer Limani;
4. Anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj, dhe
5. Anëtar korrespondent Muhamedin Kullashi;

- Diskutoi për ngritjen e redaksive të revistave të Akademisë. Kryetari Islami tha se me Rregulloren e re për veprimtarinë botuese të ASHAK-ut është përcaktuar se redaksitë e revistave propozohen dhe zgjidhen në seksionet përkatëse, me mandat tre vjeçar. Ai kërkoi nga sekretarët e seksioneve që në mbledhjet e radhës të seksioneve të ngritën redaksitë e revistave, sipas rregullores së re;

- Diskutoi për realizimin e pikës 7 të Protokollit ASHAK-ASHSH (Koncert i përbashkët veprash kamerale (muzikë dhome) dhe ekspozitë e përbashkët veprash pamore të anëtarëve të akademive, Tiranë – Prishtinë, 2016. Kryetari Islami njoftoi Kryesinë se nga akademik Zeqirja Ballata ka pranuar një propozim për mënyrën e organizimit të koncertit, ku përfshihet dhe organizimi i një Tribune muzikologjike kushtuar akademik Vasil Tole. Diskutuan A. Aliu, L. Mulliqi, J. Bajraktari dhe pas diskutimeve u tha se koncerti mund të mbahet, ndërsa Tribuna muzikologjike nuk mund të mbahet, meqë nuk është paraparën në pikën 7 të Protokollit. Lidhur me këtë u tha që Sekretari shkencor dhe sekretari i Seksionit të Arteve të njoftojnë me shkrim ASHSH-në. Sa i përket mbajtjes së ekspozitës, u tha që Seksioni i Arteve të merret me organizimin e saj dhe me kohë të njoftohet administrata për obligimet dhe punët rreth ekspozitës;

- Shqyrtoi kërkesën e akademik Mehmet Kraja, kryeredaktor i FEK-ut, për caktimin e lektorit për lekturimin e teksteve të FEK-ut. U tha se deri më tani janë bërë dy lektura të teksteve të FEK-ut në formë elektronike dhe tani është e nevojshme të bëhet edhe lektura-korrektura e tretë, në letër. Kërkesa u miratua dhe u vendos të angazhohet z. Shefqet Riza, për të bërë lekturën-korrekturën e tretë, në letër. Pagesa e të lartpërmendurit realizohet në pajtim me Rregulloren për honorarët e veprimtarisë botuese të ASHAK-ut;

- Diskutoi çështjen e promovimit të botimeve të reja të ASHAK-ut. U tha që sekretarët e seksioneve të fillojnë përgatitjet, ashtu që promovimi i botimeve të bëhet në periudhën prill-maj 2017;

- Diskutoi për çështjen e ndarjes së Shpërblimit mbështetës 2017. U tha se konkursi është shpallur dy herë, por kësaj radhe nuk ka pasur kandidatë që i plotësojnë kushtet për të qenë laureatë të shpërblimit. U vendos që konkursi të mos rishpallet.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës L. Pula njoftoi Kryesinë se Grupi i punës për menaxhimin e rrezikut ka mbajtur takimin e rregullt dhe ka shqyrtuar planin e menaxhimit të rrezikut në ASHAK, shkallën dhe masat e ndërmarra deri më sot, të cilat kanë ndikuar në uljen e ekspozimit ndaj rrezikut. Nuk janë përmendur rreziqe të reja, prandaj do të vazhdohet me sistemin tanimë të vendosur të kontrollit të rreziqeve të mundshme.

6. Kryesia (XXX) e dt.4 maj shqyrtoi disa çështje. U diskutua për propozimet për Programin e punës së ASHAK-ut për vitin 2018. U tha që sekretarët e seksioneve të fillojnë përgatitjet, ashtu që javën e parë të qershorit të përfundojnë mbledhjet e seksioneve dhe të përgatiten propozimet që do të shqyrtohen më pas në Kryesi dhe do të miratohen në Kuvendin e Akademisë. U tha që krahas propozimeve të seksioneve për Programin e punës, nëpër mbledhjet e seksioneve të paraqiten edhe

propozimet për Protokollin me ASHSH-në.

Kryesia shqyrtoi propozimin e akademik Zeqirja Ballatës për mbajtjen e Koncertit të përbashkët ASHAK-ASHSH me vepra kamerale (muzikë dhome), më 18 maj 2018, si dhe listën e interpretëve dhe instrumentistëve.

Propozimi u përkrah dhe Kryesia vendosi që pjesëmarrësve të koncertit t'u paguhen paushallët si më poshtë:

1. Visar Kuçi & Drejtues art. (4 p.) 400 €
2. Alberta Troni (6 p.) 300 €
3. Kaltrina Miftari (1 p.) 100 €
4. Kaltrina Krasniqi (1 p.) 100 €
5. Antonio Gashi (4 p.) 280 €
6. Festim Fanaj (4 p.) 280 €
7. Arianit Shehu (3 p.) 240 €
8. Shkumbin Bajraktari (2 p.) 100 €
9. Astrit Mustafa (2 p.) 180 €
10. Kenan Bytyqi (2 p.) 180 €
11. Venera Mehmedagaj (3 p.) 240 €
12. Albin Abazi (1 p.) 100 €
13. Bledar Bujupi (1 p.) 100 €
14. Meriton Ferizi (1 p.) 100 €
15. Erlinda Gashi (2 p.) 180 €
16. Arsim Mustafa (1p.) 100 €
17. Valbon Haxhibeqiri (2 p.) 180 €
18. Liridon Ballata (2 p.) 100 €
19. Avni Thaqi (2 p.) 180 €
20. Shpend Ballata (1 p.) 100 €
21. Lumniye Osmani (2 p.) 180 €
22. Adorel Haxhiaj (1 p.) 100 €
23. Shkodran Osmanaj (1p.) 100 €
24. Uran Bllaca (1p.) 100€

25. Njomza Bislimi (2p.) 180€

26. Hajrullah Sylja-Dirigjent 180 €

27. Mehdi Jusufi- punëtor për skenë 30€

Po ashtu u vendos që z. Bajram Osmani t'i paguhet paushalli për rregullimin (akordimin) e pianos në shumë prej 70€.

Kryesia shqyrtoi propozimin e Seksionit të Arteve, për caktimin e dizajnerit, fotografit dhe stafit ndihmës, për dizajnimin e katalogut për ekspozitën personale të akademik Rexhep Ferrit dhe të katalogut për ekspozitën e përbashkët me vepra të arteve pamore të anëtarëve të akademive, që do të mbahet në Tiranë.

Propozimi u miratua dhe Kryesia vendosi që Z. Zeni Ballazhi të angazhohet për punët në cilësinë e dizajnerit grafik dhe Z. Enver Bylykbashi të angazhohet për punët në cilësinë e fotografit.

Po ashtu u vendos që secilit prej tyre t'u paguhet paushalli në vlerë prej 600.00€ për secilin katalog, nga 300.00€.

Kryesia po ashtu:

- Vendosi që promovimi i botimeve të reja të Akademisë të bëhet më 31 maj 2017, ora 12:00.

- Shqyrtoi kërkesën e anëtares korrespondente Edi Shukriu për botimin e punimeve të tryezës shkencore: "Trashëgimia kulturore e Kosovës sot". U tha se tryeza është mbajtur në kuadër të Programit të punës së ASHAK-ut dhe mund të vazhdojë puna rreth përgatitjes së botimit.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës, L. Mulliqi njoftoi Kryesinë se Seksioni i Arteve në mbledhjen e fundit ka propozuar që të gjithë anëtarët e Seksionit të fushës së Arteve pamore të sjellin në ASHAK veprat e tyre pa kompensim, ashtu që mjediset e Akademisë të mbushen me vepra artistike.

Kryesia u pajtua me propozimin dhe u tha që anëtarët e Seksionit të Arteve të merren me rivendosjen e veprave artistike në mjediset e Akademisë.

7. Në Mbledhjen (XXXI) të saj mbajtur më 6 qershor, Kryesia shqyrtoi propozimbuxhetin për periudhën 2018 - 2020 duke u bazuar në Qarkoren buxhetore 2018/1.

L. Pula njoftoi Kryesinë se buxheti i propozuar i paraqitur në kode ekonomike pesë shifrore duhet të shpenzohet duke i respektuar kufijtë buxhetorë. H. Islami në diskutimin e tij tha se buxheti i ndarë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, nuk është i mjaftueshëm për arritjen e objektivave të ASHAK-ut, por si gjithnjë do të bëjmë përpjekje të jemi racional dhe të arrijmë përmbushjen e objektivave. E kemi parasysh se duhet të respektohen kufijtë buxhetorë të lejuar me Qarkore 2018/1, por ASHAK-u do të ketë nevojë për mjetet shtesë dhe për këtë do t'i drejtohet Qeverisë, përkatësisht Ministrisë së Financave, me shkresë zyrtare. Diskutuan edhe anëtarët e tjerë të Kryesisë dhe pas diskutimeve u miratua propozimbuxheti. Kryesia po ashtu vendosi të kërkohej mjete shtesë në të dy kategoritë ekonomike. Në kategorinë

paga e mëdijtje të kërkoen mjete shtesë për arsye të mbulimit të mungesës së mjeteve pas zgjedhjes së anëtarëve të rinj të Akademisë dhe avancimit të anëtarëve korrespondentë. Ndërsa në kategorinë mallra e shërbime të kërkoen mjete shtesë në vlerë prej 150,000.00€.

8. Në mbledhjen e dt. 14 qershor (XXXII) pikë qendrore e rendit të ditës ishte shqyrtimi i Programit të punës së Akademisë për vitin 2018. Kryesia shqyrtoi Programin e punës së Akademisë për vitin 2018 me radhë sipas seksioneve. Kryetari Islami në fjalën e tij tha se Programi është mjaft i pasur, ka propozime të mira, por duhet pasur parasysh edhe gjendjen e mjeteve financiare që nuk është e kënaqshme. Kësaj radhe nuk mund të miratohen propozimet e autorëve jashtë Akademisë dhe duhet të reduktohen edhe disa propozime brenda Akademisë. Ai kërkoi nga sekretarët e seksioneve të bëjnë përpjekje duke kërkuar donacione për realizimin e projekteve përkatëse. Diskutuan edhe anëtarët e tjerë të Kryesisë dhe gjatë diskutimeve u vendos të hiqen disa propozime. Kryesia finalizoi draftin e fundit të Programit të punës për vitin 2018, i cili është bashkëlidhur këtij procesverballi dhe do t'i dërgohet për miratim Kuvendit të Akademisë.

Kryesia vazhdoi me shqyrtimin e pikave të tjera të rendit të ditës:

- Vendosi të thërrasë mbledhjen e XCI të Kuvendit të Akademisë, më 29 qershor 2017 dhe caktoi rendin e ditës si në vijim: 1. Miratimi i procesverballit

të mbledhjes XCI të Kuvendit; 2. Miratimi i Programit të punës së Akademisë për vitin 2018; 3. Njoftim për buxhetin dhe planin financiar të ASHAK-ut, bazuar në Qarkoren buxhetore 2018/1 dhe 4. Çështje vijuese;

- Shqyrtoi kërkesën e Isuf Krasniqit, kryesues i Këshillit botues të ASHAK-ut, për angazhimin z. Agon Qeta në cilësinë e fotografit për përgatitjen e fotografive të FEK-ut. Kryesia miratoi kërkesën në fjalë dhe vendosi që të lartpërmendurit t'i paguhet paushalli në vlerë prej 2,800.00€ bruto. U tha që puna të vazhdojë, ashtu që Fjalori të përfundohet sa më parë.

- Vendosi që Prof. dr. Nebi Cakës t'i vazhdohet angazhimi për punët në QLE, deri më 31.12.2017 dhe t'i paguhet paushalli në shumë prej 400.00€ bruto, për çdo muaj.

Po ashtu u vendos që dhe një punonjës të angazhohet për punët në QLE dhe u caktua paga në vlerë prej 250€ bruto.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje L. Pula, njoftoi Kryesinë më planin e shfrytëzimit të pushimeve vjetore. Ajo tha se pjesa më e madhe e stafit do të shkojnë në pushim vjetor gjatë muajit gusht, meqë në këtë kohë aktivitetet në Akademi janë më të pakta dhe secili udhëheqës në departamentin e tij do të kujdeset që pikat kyçe të mos mbeten pa punonjës. Për shkak të numrit të vogël të stafit, si dhe mbajtjes së rregullit të bufesë, ajo propozoi që gjatë muajit gusht bufeja të mbyllet. Propozimi u përkrah nga Kryesia.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës, Kryesia miratoi raportet e udhëtimeve zyrtare, si më poshtë:

-Raportin e akademik Rexhep Ismajli për qëndrimin e tij në Tiranë, bashkë me akademik Ali Aliun, me qëllim të pjesëmarrjes në ceremoninë e varrimit të shkrimtarit Dritëro Agolli;

- Raportin e pjesëmarrjes së stafit administrativ (L. Pula, V. Hykolli, F. Naka, H. Maliqi, L. Bunjaku, L. Kelmendi dhe V. Olluri) në punëtorinë e përbashkët me stafin administrativ të ASHSH, në Durrës, më 8-10 mars 2017;

- Raportin e akademik Jusuf Bajraktari dhe anëtar korrespondent Frashër Demaj, për qëndrimin e tyre në Tiranë, në Arkivin Qendror të Republikës së Shqipërisë, më 20-24 mars 2017;

- Raportin e akademik Rexhep Ferri, për qëndrimin e tij në Tiranë, më 25 mars 2017, me qëllim të kryerjes së punëve për Ekspozitën e tij personale, pjesë Programit të punës së Seksionit;

- Raportin e akademik Eqrem Basha dhe anëtar korrespondent Bardh Rugova, për qëndrimin e tyre ASHSH, në Tiranë, më 21 prill 2017 me qëllim të pjesëmarrjes në takimin për përgatitjen e shënimit të 70-vjeteorit të lindjes të akademik Rexhep Ismajli;

- Raportin e akademik Rexhep Ismajli për qëndrimin e tij studimor në Vjenë, më 20 prill – 20 maj 2017;

- Raportin e akademik Rexhep Ismajli për qëndrimin e tij në Francë, më 4-7 maj 2017, me ftesë të Akademisë Franceze, për mbajtjen e ligjëratës me titull: "Dinamika e shqipes standarde

nga vitet 90 dhe perspektivat e zhvillimeve të saj";

- Raportin e akademik Hivzi Islami, për qëndrimin e tij në Vjenë, më 19-21 maj 2017, me qëllim të pjesëmarrjes në Sesionin Ceremonial vjetor të Akademisë Austriake;

- Raportin e akademik Ali Aliu dhe Eqrem Basha, për qëndrimin e tyre në Shkup, në Akademinë Maqedonase, me qëllim të avancimit të punëve për botimin e dy antologjive respektive të shkrimtarëve të të dy akademive, më 25 maj 2017.

9. Në mbledhjen e dt. 27 korrik (XXXIII), pas miratimit të procesverbalit nga mbledhja pararendëse Kryesia diskutoi për çështjen e funksionalizimit të QLE-së. Kryetari Islami njoftoi se ka kohë që ASHAK-u ka ngritur çështjen e funksionalizimit të QLE-së. Vite me radhë janë kërkuar mjete financiare nga Qeveria, por nuk ka pasur përgjigje pozitive. Në vitin 2016 me rastin e rishikimit të buxhetit, ASHAK-u ka përsëritur kërkesën, sipas projektit të paraqitur, në vlerë prej 245,000.00€, për periudhën tri vjeçare. Ai në vazhdim kërkoi nga Sekretarja e Akademisë të ofrojë sqarimet përkatëse.

L. Pula në fjalën e saj njoftoi Kryesinë se me Qarkoren e parë buxhetore për vitin 2017, janë ndarë mjetet financiare në vlerë prej 185,000.00€, për vitet 2017-2019. Me Qarkoren e dytë buxhetore për vitin 2017, vlera e mjeteve të ndara për projektin në fjalë ka arritur vlerën 255.000,00€ dhe shtrirja është bërë për vitet 2017-

2020. Pra janë ndarë edhe 10,000.00€ më shumë se sa janë kërkuar nga ASHAK-u dhe ato për periudhën katër vjeçare.

Për vitin 2017 janë në dispozicion 50,000.00€ për shpenzim. Deri më tani 25,000.00€ janë zotuar, kanë përfunduar procedurat e tenderimit, është përzgjedhur kompania fituese, është nënshkruar kontrata dhe tani vazhdojnë procedurat e parapara me Ligj, ndërsa për pjesën tjetër në vlerë prej 25,000.00€, deri më tani nuk ka filluar asnjë aktivitet, meqë kemi qenë në pritje të përgjigjes nga MAP-i, përkundër faktit se kërkesën atyre iu kemi dërguar në muajt e parë të vitit.

Mjetet e tjera për QLE-së, të ndara me Qarkoren e parë buxhetore për vitin 2018-2020, në këtë fazë konsiderohen jo finale, deri më aprovimin e Ligjit të buxhetit për vitin 2018, që nënkupton se mund të ketë edhe ndryshime, përkatësisht shkurtim të mjeteve.

L. Pula njëherësh njoftoi se para fillimit të kësaj mbledhjeje nga Thesari i shtetit kemi marrë njoftimin se janë bllokuar të gjitha mjetet financiare, në të gjitha kategoritë, për të gjitha institucionet e vendit. Deri në marrjen e një njoftimi të ri nuk mund të bëhet asnjë zotim. Në këtë drejtim duhet të jemi të kujdesshëm dhe të mos hyjmë në obligime. Problem nga sot paraqet çështja e pagesës së skanerit në vlerë prej 25,000.00€, meqë kontrata me operatorin është nënshkruar pa qenë në dijeni për bllokimin e mjeteve.

Në fund ajo njoftoi se pjesa tjetër e aktiviteteve (mjetet në vlerë prej 25,000.00€) nuk mund të fillojë pa

pasur mjete në dispozicion, përkatësisht pa njoftim zyrtar nga Qeveria. Bllokimi i këtyre mjeteve në afat më të gjatë se javën e parë të muajit gusht, pamundëson realizimin e punëve të parapara, meqë bëhet fjalë për punë që kërkojnë kohë (tenderi, afatet ligjore, realizimi i punëve, pranimi teknik, realizimi i pagesave, etj.), e që nënkupton se ka rrezik që nuk mund të shpenzohen mjetet.

Pas diskutimit të L. Pulës, kryetari Islami shtoi se çështja e projektit të QLE-së tani më është punë e kryer, është miratuar në Seksionin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, është shqyrtuar nga Kryesia dhe është miratuar në Kuvendin e Akademisë, bashkë me Programin e punës së ASHAK-ut, në formë aneksi. Qarkorja buxhetore 2018-2020 është miratuar në Kryesi dhe në Kuvend, pra kanë marrë fund të gjitha procedurat. Diskutuan edhe anëtarët e tjerë të Kryesisë dhe në fund u vendos të vazhdojnë punët sipas projektit dhe gjithnjë në përputhje me vendimet e Qeverisë.

Në vazhdim Kryetari Islami njoftoi Kryesinë se në Raportin e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 kemi pasur vetëm një rekomandim: "Kryetari i Akademisë duhet të sigurojë se ka hartuar planin strategjik gjithëpërfshirës në mënyrë që synimet e organizatës të përcaktohen në terma më afatgjatë. Progresi i arritjes së synimeve duhet të monitorohet në baza të rregullta kohore për të vlerësuar rezultatet e arritura".

Ai propozoi të ngrihet Grupi punues për hartimin e planit strategjik gjithëpërfshirës për periudhën tri vjeçare dhe propozoi përbërjen e grupit:

1. Myzafere Limani, kryetare;
2. Justina Pula, anëtare;
3. Bardh Rugova, anëtar;
4. Fetah Podvorica, anëtar;
5. Lendita Pula, anëtare.

Për mbështetjen teknike të grupit gjatë punës, propozoi z. Ali Caka.

Propozimi u përkrah nga të gjithë anëtarët e pranishëm të Kryesisë. U tha që pas përfundimit të pushimeve vjetore, grupi të fillojë me punë.

Më pas L. Pula njoftoi Kryesinë me Raportin për menaxhimin e rrezikut për periudhën gjashtëmujore. Ajo tha se grupi punues për menaxhimin e rrezikut ka mbajtur takime të rregullta dhe gjatë periudhës janar-qershor nuk është evidentuar ndonjë rrezik. Për pjesën tjetër të vitit do të përcillet situata dhe do të raportohet me kohë.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës J. Bajraktari në diskutimin e tij shprehu shqetësim për gjendjen e objektit të ASHAK-ut. Ai tha se ka shumë dëmtime, pastërtia nuk është në nivel, kur ka të reshura ka dëme, etj. Diskutuan edhe anëtarët e tjerë të Kryesisë dhe të gjithë shprehën shqetësimin e njëjtë. Në diskutimin e saj L. Pula po ashtu shprehu shqetësim për çështjen në fjalë. Ajo tha se që nga hyrja në objektin e ri të Akademisë jemi përballur me probleme dhe të njëjtat po vijnë duke u shtuar. Ajo tha se rregullisht i drejtohen shkresa me

shkrim Ministrisë së Administratës Publike, të gjitha të shoqëruara me fotografi përkatëse ku paraqitet gjendja e objektit. Ajo vazhdoi duke thënë se shkresë i është drejtuar dhe Ministrit të MAP-i, nga ana e Kryetarit të Akademisë. Po ashtu me Ministrin kemi zhvilluar një takim, në zyrën e tij, akademik Isuf Krasniqi dhe unë. Në takim i kemi shpalosur të gjitha parregullsitë dhe nevojën për ndërhyrje urgjente. Nga Ministri kemi marrë premtim se brenda dy ditëve do të dërgojë një grup të zyrarëve kompetentë dhe do të ndërmarrin më pas veprimet për sanimin e gjendjes, por nga ai takim ka kaluar gati një vit dhe nuk ka pasur asnjë kontakt apo veprim.

10. Në mbledhjen e dt. 4 tetor (XXXIV) Kryesia:

- Shqyrtoi kërkesën e Isuf Krasniqit, kryesues i Këshillit botues të ASHAK-ut, për angazhimin z. Samir Haliti në cilësinë e dizajnerit për FEK. Kryesia miratoi kërkesën në fjalë dhe vendosi që të lartpërmendurit t'i paguhet paushalli në vlerë prej 2,300.00€ bruto.

- U njoftua nga Kryetari Islami se Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Maqedonisë kremton 50-vjetorin e themelimit dhe se është ftuar ai dhe nënkryetari të marrin pjesë. Ai në vazhdim tha se me këtë rast ASHAM duhet t'i dërgohet një dhuratë, meqë edhe nga ata kemi pranuar dhuratë me rastin e 40-vjetorit të themelimit. Ai propozoi për dhuratë pikturën e Gjeloš Gjokajt: "Pa titull", akrilik në pëlhurë (55 x 65 cm), nga Fondi i

veprave artistike të Akademisë. Propozimi u miratua.

- Shqyrtoi propozimin e Seksionit të Arteve për caktimin e autorit për përgatitjen e katalogut për ekspozitën që do të organizohet në Tiranë dhe vendosi që znj. Suzana Varvarica Kuka të caktohet autore për përgatitjen e katalogut në fjalë dhe asaj t'i bëhet kompensimi në përputhje me aktet normative të Akademisë. Më pas Kryetari njoftoi Kryesinë se nga ASHSH-JA, para dy dite kemi marrë njoftimin se Ekspozita nuk mund të organizohet këtë vit dhe se duhet të shtyhet për muajin janar të vitit 2018. Ai tha se mjetet për ekspozitë janë planifikuar për këtë vit dhe ato nuk mund të barten vitin që vjen. Diskutuan me radhë të gjithë anëtarët e Kryesisë dhe pas diskutimeve u vendos që Sekretari shkencor t'i kërkojë sekretarit të Seksionit të Arteve, anëtar korrespondent L. Mulliqi, të paraqesë raport me shkrim për rrjedhën e punëve që janë kryer dhe ato që duhet të kryhen për organizimin e Ekspozitës, ashtu deri në fund të javës që vjen, raporti t'i dërgohet Kryesisë. Po ashtu u tha se SA duhet të paraqesë me kohë kërkesat financiare për aktivitetet e Seksionit, sepse për ekspozitën janë ndarë mjetet financiare dhe tani për shkak të mosrealizimit të saj, mjetet mund të shkojnë suficit dhe kjo i bën dëm buxhetit të Akademisë, edhe ashtu të pamjaftueshëm për realizimin e Programit të punës.

Në vazhdim të mbledhjes Kryesia:

- Diskutoi për ndryshimin e Rregullores

së Fondit për stimulimin e zhvillimit të punës shkencore-kërkimore të rinjve nga lëmi i shkencave të natyrës. U tha se me nxjerrjen e Ligjit të ri për Akademinë dhe Statutit të ri edhe Rregullorja në fjalë duhet të harmonizohet me legjislacionin e ri. Kryesia mori Vendim për ndryshimin e Rregullores së lartpërmendur dhe caktoi I. Krasniqin dhe L. Pulën të bëjnë ndryshimet përkatëse. Njëherësh u tha që me ndryshimet e Rregullores të njoftohet me shkrim donatori dhe pasi të merret pëlqimi nga ana e tij, Rregullorja të procedohet për miratim në Kuvendin e Akademisë;

- U njoftua me Raportin nga dëgjimi buxhetor të përgatitur nga L. Pula dhe V. Hykolli;

- Diskutoi për promovimin e botimeve të Akademisë. U tha se deri më tani promovimi i botimeve është bërë bashkërisht për të gjitha seksionet e Akademisë. Tani e tutje u vendos që promovimet të bëhen, ashtu që secili seksion të promovojë botimet e veta.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kryesia:

-Ngriti Redaksinë e re për faqenueb të ASHAK-ut, në përbërje prej anëtarëve korrespondentë: Bardh Rugova, kryetar dhe Gjyljeta Mushkolaj, Fetah Podvorica dhe Frashër Demaj, anëtarë;

- Caktoi Këshillin organizues për organizimin e Simpoziumit shkencor ndërkombëtar: "Pavarësia e Kosovës dhe sfidat e shtet ndërtimit", me këtë përbërje:

1. Akademik Jusuf Bajraktari, kryetar;
2. Prof. dr. Mark Weller, anëtar;
3. Akademik Rexhep Ismajli, anëtar;
4. Anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj, anëtare;
5. Anëtar korrespondent Muhamedin Kullashi, anëtar;
6. Anëtar korrespondent Frashër Demaj, anëtar;

- U dakordua që gjatë muajit tetor të mbahen mbledhjet e seksioneve, në të cilat seksionet do të shqyrtojnë shkallën e realizimit të programit të punës për vitin 2017, si dhe do të njoftohen për punën e Grupit punues për hartimin e planit strategjik gjithëpërfshirës.

Kryesia po ashtu miratoi raportet e udhëtimeve zyrtare:

- Raportin e punonjësve të DPPTIK-ut (Taulant Veseli, Burim Rexhepi dhe Premtim Farizi) për qëndrimin e tyre në ASHSH, Tiranë, me qëllim të këmbimit të përvojave në fushat e përbashkëta, më 13-15 korrik 2017;

- Raportin e akademikëve Ali Aliu dhe Eqrem Basha, për qëndrimin e tyre në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë, në Shkup, më 18 shtator 2017, me qëllim të finalizimit të projektit të antologjive respektive, ASHAK-ASHAM;

- Raportin e akademikëve Hivzi Islami, Jusuf Bajraktari dhe anëtar korrespondent Frashër Demaj, për qëndrimin e tyre në Tiranë, në Institutin e Historisë të Akademisë së Studimeve Albanologjike, më 18-20 shtator 2017, me qëllim të realizimit të

takimeve për organizimin e aktiviteteve në fusha të përbashkëta;

- Raportin e punonjësve Hasime Maliqi, Lirijeta Bunjaku, Lidije Kelmendi dhe Rejhane Islami, për vijimin e trajnimit "Raporti nëntë mujor financiar dhe pasqyrat financiare", në Ohër, më 21-24 shtator 2017.

11. Në mbledhjen e Kryesisë të dt. 23 tetor (XXXV) u shqyrtua shpërndarja e buxhetit sipas kodeve ekonomike pesë shifrore për shpenzim, sipas Qarkores buxhetore 2018/2. Kryetari Islami njoftoi Kryesinë se shpërndarja e buxhetit sipas kodeve ekonomike pesë shifrore për shpenzim, sipas Qarkores buxhetore 2018/1 është miratuar nga Kryesia dhe Kuvendi i Akademisë. Nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës (MF) të premten, më 20 tetor, rreth orës 14:00, ka ardhur njoftimi bashkë me kërkesë që shpërndarja e buxhetit sipas kodeve ekonomike pesë shifrore për shpenzim, sipas Qarkores buxhetore 2018/2, të përgatitet gjatë vikendit, ashtu që sot t'i dërgohet Ministrisë së Financave. Stafi i Departamentit për buxhet dhe financa, në koordinim me Sekretaren e Akademisë gjatë vikendit ka komunikuar vazhdimisht me zyrtarët e MF-it dhe ka përgatitur materialin për Kryesi, sipas Qarkores 2018/1. Qarkoja 2018/2 është pranuar nga ASHAK-u, më 22 tetor në mbrëmje. Sot në mëngjes stafi i DBF-së, gjithnjë në koordinim me Sekretaren e Akademisë e kanë përgatitur materialin të cilin e kemi para vetes për shqyrtim dhe miratim.

L. Pula njoftoi se në kategorinë Shpenzime kapitale, për vitin 2018 është miratuar buxheti në vlerë prej 25,000.00€. Me këto mjete do të paguhet operatori ekonomik me të cilin kemi hyrë në obligime në vitin 2017 për blerjen e skanerit. Në vitin 2018 nuk ka mjete të tjera në kategorinë Shpenzime kapitale, por vetëm në vitin 2019-2020 në Qarkore figurojnë mjetet në vlerë pre 140,000.00€, pra nga 70,000.00€ në këto dy vite (2019-2020). Ajo po ashtu njoftoi se buxheti për vitet 2019-2020 është preliminar dhe mund të pësojë ndryshime, sikundër mund të ketë ndryshime edhe buxheti për vitin 2018. Po ashtu mjetet shtesë të kërkuara për FEK dhe për pozitat të reja, nuk janë miratuar.

Diskutuan A. Aliu, H. Islami, L. Mulliqi dhe pas diskutimeve Kryesia e miratoi shpërndarjen e buxhetit sipas kodeve ekonomike pesë shifrore për shpenzim, sipas Qarkores buxhetore 2018/2.

Njëherësh u tha që MF-it t'i dërgohet edhe një herë kërkesa për mjetet shtesë në vlerë prej 60,000.00€ për FEK, kërkesa për miratimin e pozitave të reja, si dhe për kompensimin në formë retroaktive (janar-qershor 2017) për anëtarin e ri korrespondent të zgjedhur në zgjedhjet e fundit.

12. Në mbledhjen e dt. 8 nëntor (XXXVI) Kryesia shqyrtoi shkallën e realizimit të Programit të punës së Akademisë për vitin 2017. U tha se Programi i punës është realizuar në shkallë të mirë, por këtë vit mungesa e mjeteve financiare ka ndikuar në

mospërfundimin e një pjese të botimeve dhe aktiviteteve shkencore dhe artistike.

Në vazhdim Kryetari Islami njoftoi Kryesinë se këtë vit është koha për mbajtjen e zgjedhjeve për zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë së Akademisë. Ai më pas tha se sipas Ligjit, Statutit dhe Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë së Akademisë, sot shpallim zgjedhjet. Ai propozoi që seanca zgjedhore e Kuvendit të Akademisë të mbahet më 21 dhjetor 2017, me këtë rend dite: Miratimi i procesverbalit të mbledhjes XCII të Kuvendit të Akademisë; Caktimi i Komisionit të zgjedhjeve për zgjedhjen e Kryesisë së Akademisë; Votimi për zgjedhjen e Kryesisë së Akademisë dhe shpallja e rezultateve të votimit; Miratimi i zgjedhjes së sekretarëve të seksioneve të Akademisë; Miratimi i Rregullores për përdorimin e mjeteve financiare të donacionit për stimulimin e zhvillimit të punës shkencore-kërkimore të rinjve nga lëmi i shkencave të natyrës, të ASHAK-ut; Miratimi i Rregullores për blerjen e veprave artistike, të ASHAK-ut dhe çështje vijuese. Propozimi u miratua njëzëri nga Kryesia, bashkë me agjendën e aktiviteteve parazgjedhore.

Më pas u shqyrtua drafti i Rregullores për përdorimin e mjeteve financiare të donacionit për stimulimin e zhvillimit të punës shkencore-kërkimore të rinjve nga lëmi i shkencave të natyrës dhe drafti i Rregullores për blerjen e veprave artistike. U tha se rregulloret nuk kanë ndryshime përmbajtësore

por duhet të harmonizohen me Ligjin dhe Statutin e ri. U vendos që ato t'i përcillen Kuvendit të Akademisë për miratim.

Kryesia po ashtu:

-Shqyrtoi propozimin e Seksionit të Arteve për caktimin e dizajnerit dhe fotografit për punët përkatëse për dorëshkrimin Abdurrahim Buza – Monografi. Propozimi u miratua dhe u vendos që dizajnerit dhe fotografit t'u paguhet paushalli në shumën bruto prej 1,000.00 €, nga 500.00€ për secilin prej tyre;

-Mori vendim për blerjen e veprave artistike, sipas përzgjedhjes së Komisionit për blerjen e veprave artistike të ASHAK, si më poshtë:

1. Nga cikli: “Tre Hapa” pikturë e autorit, akademik Rexhep Ferri. Dimensioni 89 x 116 cm, vaj në pëlhurë, 2005, me çmim prej 3,130.00€;

2. “Peizazh”, pikturë e autorit Nebi Muriqi. Dimensioni 91 x 72 cm, vaj në pëlhurë, 2001, me çmim prej 2,130.00€;

-Vendosi që katalogu për ekspozitën që do të mbahet në Tiranë, të procedohet për botim gjatë këtij viti.

13. Në mbledhjen e dt. 27 nëntor (XXXVII) Kryesia shqyrtoi raportet e seksioneve për rezultatet e propozimeve të kandidatëve për anëtarë të Kryesisë së Akademisë.

Sekretarët e Seksioneve raportuan për rezultatet e propozimeve në seksionet përkatëse:

I. Seksioni i Gjuhësisë dhe i letërsisë:

1.Për Kryetar të Akademisë, akademik Sabri Hamiti.

2. Për Nënkyetar të Akademisë, Seksioni nuk ka kandidat të vetin.

3.Për Sekretar shkencor të Akademisë, Seksioni nuk ka kandidat të vetin.

Akademik Eqrem Basha është zgjedhur Sekretar i Seksionit.

II. Seksioni i Shkencave Shoqërore:

1. Për Kryetar të Akademisë, Seksioni nuk ka kandidat të vetin.

2. Për Nënkyetar të Akademisë akademik Jusuf Bajraktari.

3. Për Sekretar shkencor të Akademisë anëtare korrespondente Myzafere Limani.

Anëtare korrespondente Justina Pula është zgjedhur Sekretare e Seksionit.

III. Seksioni i Shkencave të Natyrës:

1. Për Kryetar të Akademisë, akademik Nexhat Daci.

2. Për Nënkyetar të Akademisë, Seksioni nuk ka kandidat të vetin.

3. Për Sekretar shkencor të Akademisë akademik Fejzullah Krasniqi.

Anëtar korrespondent Fetah Podvorica është zgjedhur Sekretar i Seksionit.

IV. Seksioni i Arteve:

1. Për Kryetar të Akademisë Seksioni nuk ka kandidat të vetin.

2. Për Nënkyetar të Akademisë, Seksioni nuk ka kandidat të vetin.

3. Për Sekretar shkencor të Akademisë, Seksioni nuk ka kandidat të vetin.

Anëtar korrespondent Luan Mulliqi është zgjedhur Sekretar i Seksionit.

U tha se në mbledhjet II votohen vetëm kandidatët e propozuar në mbledhjet I.

14. Në mbledhjen e fundit të vitit 2017, dt. 27 dhjetor (XXXVIII) Kryesia shqyrtoi draftin e Planit strategjik gjithëpërfshirës të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës për periudhën 2018 – 2021. Kryetari Islami njoftoi Kryesinë se Grupi punues për hartimin e planit strategjik fillimisht ka hartuar Strukturën themelore të planit strategjik gjithëpërfshirës, të cilën ua ka ndarë me akt përcjellës të gjithë anëtarëve të Akademisë për të dhënë propozimet dhe sugjerimet e tyre. Brenda afatit kohor prej dhjetë ditësh, vetëm një anëtar i Akademisë (Mehmet Halimi) ka dorëzuar me shkrim disa propozime. Pas kalimit të afatit të përcaktuar, grupi është mbledhur dhe ka hartuar draftin e Planit strategjik gjithëpërfshirës të ASHAK-ut, për periudhën 2018–2021. Ky draft duhet të miratohet në Kuvendin e Akademisë, i cili do të caktohet nga Kryesia e re, gjatë vitit 2018. Ai më pas propozoi që i njëjti Grup punues, në përbërje prej: Myzafere Limani, kryetare, Justina Pula, anëtare, Luan Mulliqi, anëtar, Bardh Rugova, anëtar, Fetah Podvorica, anëtar, Lendita Pula, anëtare dhe Ali Caka, anëtar për mbështetje teknike, të caktohet për hartimin e të gjitha dokumenteve të nevojshme për realizimin e Planit strategjik gjithëpërfshirës 2018-2021. Propozimi u miratua nga të gjithë anëtarët e Kryesisë.

Në vazhdim u diskutua për projektet e përfunduara të seksioneve të ASHAK-ut. Kryetari Islami njoftoi se raportet e projekteve të Seksionit të Shkencave të Natyrës dhe të Seksionit të Shkencave Shoqërore janë të gatshme dhe sipas procedurave të rregullta ato, bashkë me paushallët përkatëse për personat e angazhuar në projekte duhet t'i miratojë Kryesia e Akademisë. Meqë këtë vit nuk ka mjete të mjaftueshme financiare, Kryesia e tanishme nuk mund t'i miratojë projektet, meqë nuk mund t'i barten obligimet Kryesisë së re. Vitin e ardhshëm pas alokimit të buxhetit për vitin 2018, i mbetet Kryesisë të marrë vendimet përkatëse.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje u diskutua çështja e QLE-së. Kryetari Islami njoftoi Kryesinë se në QLE deri më tani kanë qenë të angazhuar me kontratë mbi vepër dy punonjës. Punët e parapara për QLE-në në këtë fazë nuk mund të vazhdojnë, meqë për shkak të mungesës së mjeteve financiare në kategorinë shpenzime kapitale ka ngecje në blerjen dhe funksionalizimin e pajisjeve dhe hapësirave për vendosjen e tyre. Kryesia nuk mund të marrë vendim për vazhdimin e angazhimit të punonjësve në këtë fazë, prandaj atyre nuk iu vazhdohet kontrata mbi vepër.

Më pas Sekretarja e Akademisë njoftoi Kryesinë për menaxhimin e rrezikut në ASHAK-ut për vitin 2017. Ajo tha se gjatë vitit 2017 është përdorur një sistem i kontrollit të rreziqeve të mundshme, i cili është treguar efikas

për rastet e realizimit të planeve dhe objektivave në nivel operacional.

Sa i përket DPPTIK-ut, DBA-së dhe njësisë së personelit, nuk ka pasur ndryshime në vlerësimin e rreziqeve.

Njësia e prokurimit ka paraqitur rastin e projektit Nr. 15203, të titulluar “Përgatitja e infrastrukturës së skanimit dhe digjitalizimit”, për blerjen e skanerit profesional në regjistrin e rrezikut për periudhën janar-dhjetor 2017. Projekti në fjalë edhe pse i planifikuar dhe për të cilin janë ndërmarr me kohë aktivitetet e nevojshme nuk është përfunduar për mungesë mjetesh, pas kufizimeve buxhetore me Vendimin nr.08/151 me datë 02.08.2017.

Në vazhdim të mbledhjes Kryesia mori vendim për shpenzimet e telefonisë mobile për vitin 2018, si më poshtë:

1. Akademik Nexhat Daci, kryetar, 50 €;
2. Akademik Jusuf Bajraktari, nënkryetar, 50 €;
3. Anëtare korrespondente Myzafer Limani, sekretare shkencore, 50 €;
4. Akademik Eqrem Basha, Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, 30 €;
5. Anëtare korrespondente Justina Pula, sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore, 30 €
6. Anëtar korrespondent Fetah Podvorica, sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës, 30 €;
7. Anëtar korrespondent Luan Mulliqi, sekretar i Seksionit të Arteve 30, €;
8. Akademik Rexhep Ismajli, kryetar i Këshillit për bashkëpunim ndërkombëtar, 50€;

9. Akademik Mehmet Kraja, kryeredaktor i Fjalorit Enciklopedik të Kosovës, 30€;

10. Lendita Pula, sekretare e Akademisë, 30 €;

11. Vjollca Hykolli, drejtoreshë e DBF, 30 €;

12. Ali Caka, drejtor DPPTIK, 30€;

13. Hilmi Zogjani, drejtor i DBA, 30 €;

14. Furtuna Naka, udhëheqës i prokurimit, 30 €;

15. Alban Bytyqi, vozitës – korrier, 20 €;

16. Asistent ekzekutive-zyrtar i personelit, 20 €;

17. Xhemshit Brajshori, zyrtar i lartë i komunikimit dhe përkthyes, 10€;

18. Hasime Maliqi, zyrtar certifikues, 10 €;

19. Lirijeta Bunjaku, zyrtar i lartë i buxhetit dhe financave, 10 €;

20. Taulant Veseli, administrator i lartë i sistemeve të TIK-ut, 10 €;

21. Burim Rexhepi, zyrtar i lartë i redaktimit teknik, 10€;

22. Lidije Kelmendi, zyrtar i librarisë, 10 €;

23. Rejhane Ajeti Islami, zyrtar i bibliotekës dhe këmbimit, 10 €;

24. Bedri Pllana, zyrtar bibliotekar, 10 €;

25. Valbona Olluri, zyrtar teknik, 10 €.

26. Premtim Farizi, zyrtar i TI-së për përkrahje, 10€.

27. Zyrtar i logjistikës, 20€.

Në një pikë të veçantë të kësaj mbledhjeje Kryesia diskutoi për sjelljet e shoferit të Akademisë. Sekretarja e Akademisë njoftoi Kryesinë se shpesh anëtarët e Akademisë kanë paraqitur ankesa për sjelljet e shoferit dhe se ajo ia ka tërhequr vazhdimisht atij vërejtjen me gojë e disa herë edhe me

shkrim. Pas vërejtjeve që i janë bërë, për një kohë ka filluar të përmirësohet, por përmirësimi ka zgjatur shkurt dhe prapë gjithnjë kanë ndodhur gabimet e njëjta. Gjatë nëntorit ka pasur dy-tri raste kur i është tërhequr vërejtje me gojë për veprime të pamatura. Më 4 dhjetor i është tërhequr vërejtje me shkrim me paralajmërim se në rast edhe të një gabimi më të vogël do të suspendohet nga puna, në pajtim me legjislacionin në fuqi. Kjo ka ndodhur se më 27 nëntor ai është parë në mjediset e Akademisë në orët e vona të mbrëmjes, i dehur dhe duke sharë e ofenduar pa kuptim. Policia ka ndërhyrë duke e hequr zvarrë dhe e kanë larguar nga ndërtesa. Gjatë kohës sa ka qenë i dehur në ndërtesë diku rreth orës 20:00 i ka dërguar edhe një mesazh kërcënues dhe ofendues sekretares së Akademisë.

Pas fjalës së Sekretares diskutuan edhe anëtarët e Kryesisë të cilët shprehën shqetësim lidhur me sjelljet e shoferit. U tha që sjellje të tilla kanë ndodhur shpesh gjatë kohës sa shoferi punon në Akademi dhe se ai shpesh ka marrë vërejtje dhe dy herë të tjera vite më parë edhe është suspenduar nga puna. Pas diskutimeve u tha që të përcjellën sjelljet e tij dhe në rast edhe të një gabimi më të vogël, mos të ketë tolerancë.

Në kuadër të kësaj pikës së fundit të rendit të ditës Kryesia miratoi:

-Raportin e akademik Isuf Krasniqit dhe Lendita Pulës për qëndrimin në Tiranë, më 23-24 tetor, me qëllim të pjesëmarrjes në ceremoninë e

nënshkrimit të Protokollit të bashkëpunimit ASHAK-ASHSH, 2018-2020;

-Raportin e anëtarit korrespondent Muhamedin Kullashi, për qëndrimin e tij në Tokio, më 22-26 tetor 2017, me qëllim të pjesëmarrjes në Asamblenë e përgjithshme të Unionit Akademik Ndërkombëtar (UAI);

-Raportin e delegacionit të ASHAK-ut (akad. Ali Aliu, akad. Rexhep Ismajli, anëtar korrespo. Kujtim Shala dhe Lendita Pula) për qëndrimin në Tiranë, në ASHSH, me qëllim të pjesëmarrjes në Konferencën ndërkombëtare "Qytetërimi i Voskopojës dhe shekulli i Iluminizmit në Ballkan", më 12-15 nëntor 2017;

-Raportin e pjesëmarrjes së stafit të Bibliotekës dhe zyrtarëve të administratës në panairin e 20-të ndërkombëtar të librit "Tirana 2017", më 15-19 nëntor 2017;

-Raportin e akademikëve Hivzi Islami dhe Jusuf Bajraktari, për qëndrimin në Tiranë, në ASHSH dhe në panairin e librit, më 17-19 nëntor 2017;

-Raportin e akademik Rexhep Ismajlit për qëndrimin në Kinë, në Foreign Studies University - Departamenti i gjuhës shqipe në Pekin, më 26 nëntor – 5 dhjetor 2017;

-Raportin e akademik Hivzi Islamit për qëndrimin në Shqipëri, me qëllim të pjesëmarrjes në Konferencën shkencore ndërkombëtare: "Hapësirat Ndërkufitare- Dinamika dhe Sfida", më 1-3 dhjetor 2017;

-Raportin e akademik Rexhep Ismajlit për qëndrimin në Tiranë, me qëllim të

pjesëmarrjes në Konferencën shkencore ndërkombëtare: "Gjuha shqipe në kontakt me gjuhët e tjera", më 5-6 dhjetor 2017;

-Raportin e Grupit punues për hartimin e Planit strategjik gjithëpërfshirës të ASHAK-ut, për qëndrimin në Durrës, më 23-26 nëntor 2017, me qëllim të vijimit të punëtorisë për hartimin e draftit të Planit strategjik gjithëpërfshirës të ASHAK-ut, 2018-2021;

-Raportin e delegacionit të ASHAK-ut, për qëndrimin në Tiranë, në ASHSH, me qëllim të realizimit të takimit të përbashkët të fundvitit, më 15-18 dhjetor 2017.

Njëherësh në kuadër të po kësaj pike të rendit të ditës Kryetari Islami njoftoi se nga data 1 janar 2018 e deri në përfundimin e mandatit ligjor, anëtarëve të Kryesisë së re iu paguhen shtesat funksionale.

AKTIVITETET E REALIZUARA NGA KRYESIA E AKADEMISË

Antologjia e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë: "Poetët dhe shkrimtarët akademikë".

Dy antologjitë – Poetët akademikë / Antologji e poetëve anëtarë të Akademisë Maqedonase të Shkencave dhe të Arteve, përkthyer në gjuhën shqipe dhe Poetët dhe tregimtarët akademikë /Antologji e poetëve dhe tregimtarëve anëtarë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, përkthyer në gjuhën maqedonase, e

para e botuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, dhe e dyta e botuar nga Akademia Maqedonase e Shkencave dhe e Arteve, janë pjesë e Marrëveshjes për bashkëpunim midis dy Akademive, e cila parasheh programe të përbashkëta nga fusha të ndryshme të shkencave dhe të arteve. Kjo Marrëveshje, e iniciuar që në pranverën e vitit 2012, në takimin e delegacioneve të të dy palëve të kryesuar nga Kryetari i ASHAK, akademik Hivzi Islami dhe kryetari i atëhershëm i AMSHA, akademik Vllado Kambovski, parasheh edhe veprimtari të tjera të përbashkëta shkencore nga shkencat e natyrës, shkencat shoqërore, mbrojtja e mjedisit, etj. Në bazë të kësaj marrëveshje akademik Ali Aliu nga ASHAK, bëri përzgjedhjen dhe shkroi parathëniet për poetë e tregimtarë, anëtarë të ASHAK-ut, që u përkthyen në gjuhën maqedonase nga R. Shabani dhe F. Shehu dhe iu dha për botim AMSHA-së, ndërsa akademik Georgi Stardellov bëri përzgjedhjen e poetëve akademik të AMSHA dhe shkroi parathënien e antologjisë, e cila u përkthyer në shqipe nga R. Shabani dhe iu dorëzua për shtyp ASHAK-ut. Të dy antologjitë u përgatitën me dizajn dhe faqosjeje të njëjta dhe tashmë kanë dalë, njëra (e shtypur nga ASHAK) në tetor, 2017, ndërsa tjetra (e shtypur nga AMSHA) në janar 2018, të redaktuara nga nënkryetarët e dy akademive: akademik Ali Aliu dhe akademik Luan Starova. Është menduar edhe promovimet respektive të këtyre antologjive në të dy akademitë.

III. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

PROJEKTET

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës. – Ka përfunduar përgatitja e dorëshkrimit të Fjalorit Enciklopedik të Kosovës, që është projekt i përbashkët afatgjatë i të gjithë seksioneve. Ka qenë e planifikuar që dorëshkrimi të dorëzohet për shtyp që në muajt shtator-tetor të vitit 2017. Mungesa e mjeteve materiale e ka shtyrë finalizimin e botimit për fillimin e vitit 2018.

2. Këshilli Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe. – Puna e Këshillit gjatë viti 2017 ka ecur me ritme të ngadalësuar dhe nuk ka shënuar pothuaj asnjë aktivitet. Nga Seksioni është kërkuar që Këshilli të përfshihet sërish në Protokollin e ri të Bashkëpunimit midis ASHAK dhe ASHSH për vitet 2017/2018, duke konsideruar se puna e tij nuk është përmbyllur. Pritet përgatitja e materialeve për botim, të cilat mund të sistemohen gjatë vitit 2018. Megjithatë, për shkak të gjendjes së tashme në ASHSH, nuk mund të parashihet se si do të shkojë më tutje.

3. Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX. – Projekti kishte paraparë që brenda vitit 2017 të finalizohet puna rreth botimit Leksiku shqip i revistës “Përparimi”, 1955-1968. Materiali është gati, një dorëshkrim prej rreth 1000 faqesh, që është duke u lexuar këto ditë. Pritej, gjithashtu, që brenda vitit të kaluar të tejkaloheshin vështirësitë rreth ngritjes së

kapaciteteve dhe aftësimit teknik e profesional të Qendrës Leksikografike Enciklopedike, para së gjithash sigurimi i skanerit me performanca të sofistikuar, i domosdoshëm për punën e mëtejme të projektit. Por, edhe pse skaneri ishte porositur dhe ishin zotuar mjetet, shkurtime buxhetore pamundësuan që kjo të kryhet brenda vitit të kaluar, kështu që kjo ndikoi të shtyhen dhe pikat e tjera.

4. Vepra e plotë e Norbert Joklit. – Deri tash kanë dalë dy vepra të albanologut austriak, e dyta në fillim të vitit 2017 (shih Botimet). Është duke u përgatitur vëllimi “Hulumtime linguistike – kulturo-historike në fushë të shqipes”, i cili është dhënë në ripërkthim, për shkak se përkthimi ekzistues i Anton Krajnit ka mungesa pjesësh, janë vërejtur përkthime në shpejtësi dhe ka qenë i nevojshëm plotësimi i tekstit në shqipen e sotme letrare, si dhe paraqitjet e sakta të shenjave e grafive. Ky botim është parashikuar të kryhet gjatë vitit 2018. Projekti do të vazhdojë edhe me mbledhjen, sistemimin, përkthimin dhe botimin e kontributeve të tjera të Norbert Joklit, me qëllim që vepra e tij të dalë sa më e plotë.

TUBIMET SHKENCORE

1. 100 vjetori i lindjes së Idriz Ajetit. – Konferenca shkencore kushtuar 100 vjetorit të lindjes së akademik Idriz Ajetit, organizuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë, u mbajt më 27 janar 2017 në mjediset e ASHAK-ut, në praninë e prof. Ajetit dhe

shumë të ftuarve, mysafirëve nga Kosova, Shqipëria, Gjermania, Italia, Polonia, etj. Në tri seanca të Konferencës u paraqitën rreth 30 kumtesa që ndriçuan, me kontribute të reja, jetën dhe veprën e akademik Idriz Ajetit. Në pjesën protokollare, në nismë të aktivitetit, konferencës iu drejtuan me fjalë rasti kryetari i ASHAK, akademik Hivzi Islami, kryetari i ASHSH, akademik Myzafer Korkuti, rektori i UP-së, prof. dr. Marjan Demaj, drejtori i IAP, prof. dr. Hysen Matoshi dhe albanologu gjerman, prof. dr. Wilfried Fiedler. Konferenca u vlerësua e përgatitur mirë dhe u ndoq me shumë jehonë në qarqet shkencore si dhe në media, në Kosovë e në Shqipëri.

2. Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht (Albanistische Forschungen in den deutschsprachigen Ländern). – Konferencë ndërkombëtare shkencore, e organizuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë, e mbajtur me datë 26 dhe 27 tetor 2017 në mjediset e ASHAK. Konferenca, që ishte pjesë e Protokollit të bashkëpunimit midis ASHAK dhe ASHSH, e mbështetur edhe nga Ministria e Kulturës, për akomodimin e pjesëmarrësve nga jashtë, u përgatit nga Këshilli Organizues i drejtuar nga akademik Rexhep Ismajli. Duke qenë një nga aktivitetet më të gjera dhe më komplekse të realizuar nga Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i ASHAK, Konferenca, që tuboi emra të njohur studiuesish, jo vetëm në vendet ku flitet gjermanisht, por edhe nga

Kosova, Shqipëria dhe disa vende të tjera të Europës, solli kontribute të rëndësishme shkencore, në shtatë seanca me rreth 50 kumtues, shoqëruar me diskutime të gjera, që po tubohen dhe do të botohen në një vëllim të veçantë brenda vitit 2018.

3. 70 vjetorit të lindjes së Rexhep Ismajlit. - Me iniciativën e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe në bashkëpunim me SGJL të ASHAK, në mjediset e ASHSH në Tiranë, me 8 qershor 2017 u organizua Konferenca shkencore jubilarë kushtuar 70 vjetorit të lindjes së akademik Rexhep Ismajlit. Konferenca e drejtuar nga akademik Floresha Dado, u zhvillua në tri pjesë: fjalët përshëndetëse të akademik Muzafer Korkuti, kryetar i ASHSH, akademik Ali Aliu, nënkryetarit i ASHAK dhe dr. Lindita Sejdiu Rugova dekanë Fakultetit Filologjik të UP-së dhe e prof. dr. Françesko Altinari nga Universiteti i Kozencës. Në pjesën shkencore me kumtesa u paraqitën: Seit Mansaku, Rahman Paçarizi, Ethem Likaj, Aljula Jubani dhe Shaban Sinani. Në fund u përrua libri Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik, për të cilin foli Bardh Rugova dhe u lexua vështrimi i Kolec Topallit.

BOTIMET

1. Ndre Mjedja - 150 vjetori i lindjes – Materialet e Konferencës shkencore “Ndre Mjedja - 50 vjetori i lindjes” që u mbajt me 15 shtator 2016 si pjesë e Protokollit të bashkëpunimit me ASHSH u mblodhën në një vëllim prej 250 faqesh dhe u bënë gati që në nëntor 2016, por dolën nga shtypi në

fillim të 2017-ës për shkak të vonesave në tenderimin e shtypshkronjës. Në të janë botuar 18 kumtesa, të po aq pjesëmarrësve në konferencën që u vlerësua e suksesshme dhe solli kontribute me interes për krijimtarinë poetike të Mjedjes, studimet e tij, kërkimet gjuhësore dhe shkrimet fetare. Konferenca ndriçoi shumë aspekte më pak të njohura për jetën dhe veprën e Mjedjes, ndërsa botimi mbylli shënimin e këtij përvjetori të rëndësishëm të letërsisë shqipe.

2. Idriz Ajeti Studime për gjuhën shqipe, vepra të zgjedhura. Botim jubilar që ndoqi shënimin e 100 vjetorin e lindjes së njërës nga albanologët më të shquar të kohës sonë, anëtar i ditëve të para të ASHAK dhe kryetar i saj në dy mandate. Libri doli në prag të Konferencës që i kushtojë akademik Ajetit dhe këtij jubileu të rrallë, më të veçantit të kremtuar ndonjëherë në mesin tonë, në praninë e tij dhe në bashkëorganizim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Në një vëllim prej 805 faqesh përfshihet pjesa më e rëndësishme e veprës së tij shkencore. Libri ka dhe vlerën e veçantë se përmbledh në një vend boshtin e studimeve të tij gjuhësore dhe disa nga shkrimet kritike dhe polemike. Botimin e zgjodhi dhe e përgatiti akademik Rexhep Ismajli, që shkroi dhe parathënie.

3. Norbert Jokl, Studime historiko-krahasuese për gjuhën shqipe – Historisch-Vergleichende Untersuchungen über das Albanische – Vëllimi II i veprës së albanologut

austriak i përgatitur nga akademik Rexhep Ismajli dhe prof. dr. Heiner Eichner, që doli në fillim të vitit 2017, përfshin studime që kanë të bëjnë me historinë e lashtë të shqipes në trungun indoeuropian, raportet e saj me gjuhët e vjetra dhe ka një vëllim prej 943 faqesh. Disa prej këtyre teksteve janë gjetur në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë në Tiranë, ndërsa një pjesë e tyre janë përkthyer nga Skënder Gashi, Eqrem Çabej, Anton Krajni, Ali Dhrimo, Ethem Lika, Genc Lefe etj. Janë tubuar dhe tekstet origjinale në gjuhën gjermane dhe janë paraqitur të skanuara me cilësinë e duhur për botim. Libri është pjesë e projektit afatgjatë për botimin e veprës së plotë të Joklit dhe serisë së botimeve të albanologëve të traditës që është nisur shumë vite më parë.

4. Shaban Demiraj Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët. - Në serinë e librave të albanologëve të shquar, ku janë botuar Pedersen, Jokl, Cimohovski, Buda, Çabej, etj. këtë vit u planifikua një libër me studime të zgjedhura të studiuesit, albanologut Shaban Demiraj, ish kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Përzgjedhja iu besua Bardhyl Demirajt, profesor i gjuhës shqipe në Universitetin e Muniut, i biri i autorit, gjuhëtar dhe studiues që e njeh më së miri veprën e akademik Demirajt. Libri ka rreth 240 faqe dhe është gati për shtyp që nga fillimi i vitit, por nuk u realizua për shkak të mungesës së mjeteve.

5. Idriz Ajeti – 100 vjetori i lindjes. - Materialet e konferencës jubilarë shkencore të mbajtur më 27 janar 2017, me rastin e 100-vjetorit të lindjes së akademik Idriz Ajetit, janë tubuar në një dorëshkrim rreth 300 faqesh që është përgatitur dhe pritët të dorëzohet për shtyp. Dorëshkrimi përmban rreth 30 kumtesa të mbajtura në këtë konferencë jubilarë, si dhe fjalët përshëndetëse.

6. Ali Aliu, Urtia e fjalës (fillimisht me titull pune Studime dhe kritika letrare). - Dorëshkrimi përmban studime, artikuj, kritika letrare, të botuara në shtypin e përditshëm dhe periodik, të paraqitur në aktivitete shkencore, tryeza e konferenca, si dhe studime të papublikuara. Vëmendja e akademik Aliut në këtë vëllim i kushtohet kryesisht autorëve bashkëkohorë shqiptarë, veprave të veçanta të tyre, apo lëvizjeve të reja në letërsinë shqipe. Vëllimi ka rreth 360 faqe dhe është dorëzuar në fillim të muajit shtator, siç ishte paraparë me dinamikën e realizimit të Programit të punës për vitin 2017. I recensionuar nga akademikët Z. Rrahmani e R. Ismajli, i aprovuar për shtyp nga Seksioni dorëshkrimi pritët të dorëzohet për shtyp.

Në planin e punës të Seksionit për vitin 2017 ishin paraparë dy botime që do të finalizoheshin në muajin tetor dhe nëntor:

1. Rexhep Ismajli, Studime për shqipen standarde në kontekste të reja (titull pune). - një dorëshkrim që do të ketë rreth 500 faqe dhe ku do të përfshihen diskutimet për hapësirat e përdorimit

të shqipes standarde dhe për varietetet e ndryshme të saj, për problemet që dalin në këtë fushë për studimin, por edhe për rregullimin e normave, për raportet midis gjuhës standarde të shkruar dhe të folur. Dorëshkrimi ishte paraparë të dorëzohej brenda muajit tetor 2017.

2. Sabri Hamiti, Lirika shqipe, interpretim dhe lexim i lirikës shqipe të tre shekujve të fundit. Trajtim i lirikës si përqendrim i artit letrar. Dramatizim i aktit krijues të kalimit të imagjinimit në ligjërim letrar individual. Përqendrim te lirikët dhe kryeveprat e tyre, të paraqitura në rrjedhë të kohës e në transformime të shkrimit poetik duke shprishur rregullat e duke synuar rregulla të reja. Dorëshkrimi do të ketë rreth 300 faqe dhe është paraparë të dorëzohet brenda muajit nëntor.

Dorëshkrimet nuk u dorëzuan për shkak të vonesave të botimeve të tjera që ishin paraparë para këtyre projekteve si pasojë e shkurtimeve të mjeteve të Akademisë.

3. Revista “Studime” – Numri 23 i revistës ishte përgatitur që në muajt e parë të vitit. E finalizuar dhe e gatshme për të shkruar në shtyp, ajo pret daljen që nga muaji maj. Arsyet e vonesës lidhen me shkurtimeve të buxhetit të Akademisë. Me qëllim që të mos mbetet e pasivizuar, derisa pritët shtypi, revista është publikuar në faqen e internetit të ASHAK. Gjatë kësaj kohe është zgjedhur redaksia e re e revistës që do të bëjë gati numrin 24.

TË TJERA

1. Ligjëratë e Rexhep Ismajlit në Akademinë Frënge. - Me ftesë të Académie Française des Inscriptions et Belles-Lettres, me të cilën ASHAK ka marrëveshje bashkëpunimi, më 5 maj 2017, në Grande sale des séances të Institut de France, në Paris, akademik Rexhep Ismajli mbajti ligjëratën "Dinamika e shqipes standarde nga vitet '90 dhe perspektivat e zhvillimeve të saj". Para ligjëratës u prit nga Sekretari permanent i kësaj akademie, Michel Zinc, anëtarët Charles de Lamberterie, Jean-Pierre Sodini dhe sekretari Hervé Danesi, me të cilët u bisedua për bashkëpunimin e mëtejshëm. Pas ligjëratës pati pyetje dhe interesim të shumë anëtarëve pjesëmarrës.

2. Ligjëratë inauguruese e Bahri Becit. – Me datë 27 qershor 2017, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, në mjediset e Akademisë, organizoi ligjëratën e anëtarit të jashtëm, akademik Bahri Becit, me temë: "Rreth historisë së formimit të dy dialekteve të shqipes"

3. Komemoracion për Robert Elsie. - Me rastin e ndarjes nga jeta të albanologut Robert Elsie, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, në mjediset e Akademisë, më 4 tetor 2017, u mbajt mbledhje përkujtimore, në të cilën folën Kryetari i ASHAK, akademik Hivzi Islami dhe akademik Rexhep Ismajli.

Sekretar i Seksionit

Akademik Eqrem Basha, d.v.

IV. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

PROJEKTE

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës. – Ka përfunduar përgatitja e dorëshkrimit të Fjalorit Enciklopedik të Kosovës, që është projekt i përbashkët afatgjatë i të gjithë seksioneve. Ka qenë e planifikuar që dorëshkrimi të dorëzohet për shtyp që në muajt shtator-tetor të vitit 2017. Mungesa e mjeteve materiale e ka shtyrë finalizimin e botimit për fillimin e vitit 2018.

2. Vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës (Tabloja fizike-hapësinore, demografike dhe funksionale) - Qendrat urbane.

Faza e parë e Projektit ka përfunduar dhe raporti përmbledhës është shqyrtuar në Seksion dhe është miratuar nga Kryesia e Akademisë. Bashkë me raport është dorëzuar dorëshkrimi me rreth 400 faqe.

3. Hasan Prishtina në prizmin e dokumenteve arkivore.

Ky projekt është në fazën e hulumtimeve arkivore neper arkivat vendore dhe ndërkombëtare. Deri më tani janë bërë hulumtime në disa arkiva si: Arkivi i Kosovës, Arkivi i Shtetit Shqiptar, Arkivi i Institutit të Historisë në Tiranë, Arkivi i Institutit të Historisë në Prishtinë. Akademik Rexhep Ismajli gjatë qëndrimit të tij në Vjenë ka hulumtuar një pjesë të dokumentacionit që gjendet në Arkivin e Vjenës dhe e ka dorëzuar për përkthim në gjuhën shqipe. Një pjesë e dokumentacionit të hulumtuar në Arkivin Nacional në Londër (The

National Archives) nga anëtari korrespondent Frashër Demaj, është deponuar në Arkivin e Akademisë. Gjatë vitit 2018 do të vazhdojë puna me hulumtime në arkivat e tjera që posedojnë fonde për veprimtarinë e Hasan Prishtinës.

4. Korpus i monumenteve epigrafike antike të Kosovës. Projekti është shqyrtuar në Seksionin Është thënë se raporti duhet të plotësohet dhe të paraqitet i plotë bashkë me dorëshkrim.

TUBIMET SHKENCORE

1. Rruga Drejt Integritetit Ekonomik Evropian e Kosovës. - Tryezë shkencore

Tryeza u mbajt më 29 nëntor 2017 në mjediset e Akademisë, nën organizimin e Këshillit organizues në përbërje prej: akademik Isa Mustafa, anëtare korrespondente Justina Shiroka-Pula dhe Prof. Dr. Valentin Toçi.

Fjalën e hapjes e mbajti akademik Jusuf Bajraktari, Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore.

Tryeza u zhvillua në dy sesione dhe me kumtesa u paraqitën dhjetë studiues të fushës përkatëse.

Gjithashtu pati edhe diskutime nga një numër i konsiderueshëm i pjesëmarrësve.

Tryeza përfundoi punimet me sukses. Kontributet autoriale të saj do të botohen në një vëllim të veçantë.

2. Sfidat e ndërtimit të shtetit të së drejtës - Tryezë shkencore.

Tryeza u organizua nga Këshilli organizues në përbërje prej anëtar korrespondent Arsim Bajrami, kryetar, akademik Jusuf Bajraktari, anëtar, akademik Anton Berishaj, anëtar, anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj, sekretare dhe anëtar korrespondent Frashër Demaj, anëtar dhe u mbajt më 8 dhjetor 2017, në mjediset e Akademisë.

Fjalën e hapjes e paraqiti akademik Jusuf Bajraktari, sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore. Pas paraqitjes së fjalës hyrëse me kumtesat e tyre u paraqitën tetë studiues nga fusha përkatëse, të cilët elaboruan problemet e ngritura në tryezë.

Tryeza u zhvillua në dy sesione dhe pas kumtesave u zhvillua një debat nga pjesëmarrësit në tryezë.

Tryeza përmbylli punimet me sukses. Kontributet autoriale do të botohen në një vëllim të veçantë.

BOTIMET

1. Emin Riza: "Arkitektura popullore e Gjakovës". - Libri është botuar dhe është një botim monografik, i pari i këtij lloji dhe si i tillë paraqet një kontribut me vlerë.

2. Revista "Studime shoqërore", nr. 4.- Revistë vjetore. Sivjet nuk ka mundur të botohet për shkak të mungesës së mjeteve financiare.

3. "Bajram Curri në dokumentet arkivore" i përgatitur nga J. Bajraktari është përfunduar dhe meqë ka një vëllim më të madh se sa është menduar, është ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë do të botohet në

gjashtëmujorin e parë të vitit 2018, ndërsa pjesa e dytë ë vitin vijues.

4. “Çështja shqiptare sipas burimeve britanike dhe austro-hungareze, në prag të LPB (1912-1914)” Periudha historike “Çështja shqiptare pas shpalljes së pavarësisë...” dhe copëtimi i trojeve kombëtare përkon me kohën e zhvillimeve të shumë ngjarjeve, përpjekjeve dhe kryengritjeve në Kosovë. Këto ngjarje janë pasqyruar në burimet diplomatike britanike dhe austro-hungareze, të vëzhguara nga diplomatë të qendrave të ndryshme evropiane. Siç është e njohur, diplomacia e këtyre dy fuqive të kohës ishte mjaft aktive në përcjelljen e ngjarjeve në hapësirat shqiptare. Në këtë projekt janë të angazhuar autorët: Frashër Demaj dhe Fehmi Rexhepi, mirëpo për shkak të vëllimit të madh të dokumenteve puna duhet të vazhdojë edhe vitin e ardhshëm.

Raportin e përgatiti akademik Jusuf Bajraktari, ish Sekretar i Seksionit.

Sekretare e Seksionit

Anëtare korrespondente Justina Pula, d.v.

V. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

PROJEKTE

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës. – Ka përfunduar përgatitja e dorëshkrimit të Fjalorit Enciklopedik të Kosovës, që është projekt i përbashkët afatgjatë i të gjithë seksioneve. Ka qenë e planifikuar që dorëshkrimi të

dorëzohet për shtyp që në muajt shtator-tetor të vitit 2017. Mungesa e mjeteve materiale e ka shtyrë finalizimin e botimit për fillimin e vitit 2018.

2. Kadastr i ndotësve të ujërave efluent në recipient dhe trajtimi i tyre (me biosorbent dhe osmozë reverse) - Ky projekt i takon kimisë së mjedisit dhe ka karakter hulumtues dhe aplikativ. Trajtimi i ujërave mund të ndahet në tri kategori kryesore: Pastrimi për nevoja shtëpiake, trajtimi për përdorime speciale industriale si dhe trajtimi i ujërave hedhurinë për t'i bërë ato të pranueshme për lirim në recipient apo ripërdorim. Duhet theksuar se pavarësisht trajtimit që i nënshtrohet uji, së pari duhet të krijohet kadastr i ndotësve të ujërave efluent. Trajtimi i ujërave hedhurinë të shkarkimeve industriale gjatë shekullit të kaluar është bërë me metoda kimike, fiziko-kimike dhe biologjike. Substancat e përdorura për këtë qëllim kanë liruar llaçe të cilat kanë paraqitur problem mjedisor për shkak të përmbajtjes së specieve metalike, herbicideve, pesticideve apo fenolëve.

Shkenca e mjedisit tani është e orientuar kah eliminimi i problemeve të lartpërmendura duke u bazuar në ekonomi të gjelbër dhe në kimi të gjelbër. Teknologjitë konvencionale për largimin e metaleve të rënda toksike, nuk janë komerciale dhe pos kësaj gjenerojnë llaçe toksike kimike, ndërsa hulumtimet kanë bërë biosorbimin si proces në hyrje dhe si një alternativë të fuqishme të

teknologjive konvencionale për mënjanimin ose nxjerrjen e joneve metalike nga tretësirat ujore. Projekti është i ndarë në dy pjesë:

-Kadastrit të ndotësve të ujërave hedhurinë;

-Trajtimi komparativ i ujërave hedhurinë me metoda klasike kimike dhe fiziko-kimike duke përdorur material dhe metoda vetanake si dhe përdorimi (për herë të parë të ne) i biosorbentëve.

Ky projekt është propozuar të jetë dyvjeçarë. Realizimi i tij ka filluar të realizohet në vitin 2016 dhe i njëjti ka vazhduar edhe gjatë vitit 2017.

Ky projekt është përfunduar sipas planifikimit dhe raporti përfundimtar është aprovuar në mbledhjen e Seksionit të Shkencave të Natyrës më 06 dhjetor të vitit 2017.

3. Parametrat e jashtëm projektues të klimës për disa qytete të Kosovës- Ky projekt ka karakter hulumtues dhe aplikativ dhe i njëjti bazohet në matjet e vazhdueshme që i kryen Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës për temperaturën e ajrit të jashtëm, lagështinë absolute dhe relative të ajrit, shtypjen e ajrit të jashtëm, intensitetin e rrezatimit diellor, etj. Bazuar në rezultatet e matjeve në pikat ku janë realizuar matjet, në mënyrë analitike përcaktohen parametrat e projektuar për të cilët duhet të sigurohet ngrohja e objekteve në stinën e dimrit si dhe ventilimi në stinën e verës. Për disa qytete të Republikës së Kosovës në kuadër të aktiviteteve të gjertanishme të grupit punues është arritur:

- Realizimi i vizitave të parapara të qendrave të vendit që posedojnë të dhënat e nevojshme për parametrat meteorologjik siç janë Prishtina, Prizreni, Peja dhe Ferizaj;

- Grumbullimi, përpunimi dhe analizimi i disa të dhënave - parametrave meteorologjikë, në formën elektronike për qytetet e Republikës së Kosovës ku janë bërë regjistrimet e parametrave;

- Modifikimi, sistemimi dhe pasqyrimi grafik i të dhënave mbi parametrat kryesorë të klimës për disa vite, siç janë:

- Temperatura mesatare ditore, mujore dhe vjetore,

- Lagështia relative ditore, mujore dhe vjetore e ajrit, dhe

- Shtypja atmosferike ditore, mujore dhe vjetore

- Rrezatimi diellor

- Shpejtësia e erës

- Gradë Ditët për Ngrohje dhe Gradë Ditët për Ftohje

- Shtypja e ngopjes

- Temperatura e pikës së vesës

- Etj.

Analiza dhe përcaktimi projektues i parametrave të klimës për këto qytetet të Kosovës paraqesin lehtësi për projektuesit e sistemeve termoteknike, për dizajnin e klimës së brendshme të ndërtesave, komfortin termik, efikasitetin e energjisë dhe janë dëshmi e një niveli teknik të një vendi. Rezultatet e këtyre analizave në të ardhmen mund të futen edhe në bankën e të dhënave hyrëse të

softuerëve aplikativ për termoteknikë. Në shtetet e Bashkimit Evropian, parametrat e cekur janë të normuara dhe janë shënime bazë në softuerët që përdoren për projektimin e sistemeve të ngrohjes, ventilimit dhe të klimatizimit. Ky projekt është paraparë në kohëzgjatje prej 2 vjet (2016-2017) me një ekip realizues kompetent për këtë lëmi dhe tani ndodhet në fazën përfundimtare të punimeve.

Ky projekt është përfunduar sipas planifikimit dhe raporti përfundimtar është aprovuar në mbledhjen e Seksionit të Shkencave të Natyrës më 06 dhjetor të vitit 2017.

BOTIME

1.Minir Dushi: “Xeheroret e nikelit dhe të kobaltit të vendit tonë”.

Ky studim merret me problematikën e xeherorëve okside-silikate të Ni-Co të cilat shfaqen, përkatësisht shfrytëzohen në vendin tonë. I njëjti është ndarë në tri pjesë: Gjeologjia-shfaqja dhe vendburimet e xeherorëve të Ni-Co; Xehetaria-shfrytëzimit i xeherorëve të Ni- Co dhe nikel kobaltit dhe Metalurgjia e ferro nikelit në Drenas.

Në pjesën e parë janë pasqyruar të dhëna të numërta nga punimet kërkimore gjeologe-zbuluese vjetore rajonale. Këto hulumtime janë kryer në zonat e masiveve periodike të Golashit, Dritanit (Dobroshevcit), Rahovecit dhe Gjakovës. Nga hulumtimet e deritanishme ka rezultuar se rezervat e këtyre xeherorëve arrijnë shifrën mbi 22 milion tonë.

Në pjesën e dytë studiohet xehetaria përkatësisht shfrytëzimi i xeherorëve të Ni-Co, siç janë minierat në qiell të hapur të Çikatovës dhe Kodrinës së Goleshit. Përveç minierave të cilat janë në punë prodhuese, është zbuluar edhe një numër i madh i vendeve që premtojnë se mund të zbulohen rezerva të reja të këtyre xeherorëve siç janë Llapushniku, Bushati, Ponosheci, Beci, Juniku, Hereçi, etj.

Duke e pasur në konsideratë se nikel i cili fitohet në metalurgjinë e Ferro nikelit në Drenas, ka një përdorim të gjerë për prodhimet industriale dhe proceset teknologjike, në pjesën e tretë është analizuar metalurgjia e ferro- nikelit në Drenas.

Kjo vepër është botuar sipas planifikimit në vitin 2017.

2.Valbon Bytyçi: Regjioni lindor i Kosovës (Veçoritë fiziko-gjeografike, resurset natyrore dhe problemet gjeomjedisore).

Ky studim përmban tri pjesë kryesore siç janë: Veçoritë fiziko-gjeografike, resurset natyrore dhe problemet gjeomjedisore.

Veçoritë fiziko-gjeografike- Regjioni Lindor i Kosovës shtrihet në pjesën lindore të Kosovës, duke zënë sipërfaqe prej rreth 57,6% të territorit të Republikës së Kosovës. Veçohet me klimë kontinentale të mesme, me dallime jo shumë të mëdha në mes lindjes e perëndimit, dhe në mes jugut e veriut.

Resurset natyrore Regjioni Lindor i Kosovës veçohet me pasuri minerale,

ndër të cilat dallohet Plumb-zinku në disa lokalitete, Nikeli, Mangani; si dhe pasuri jometalore të shpërndara në disa pjesë, ku veçohet magneziti, mergelët, bentoniti, kaolina, gëlqerorët; pasuri të madhe energjetike: linjiti, me toka pjellore me sipërfaqe të kufizuar, ujëra të ndryshme termominerale, resurse ujore të kufizuara, etj.

Problemet gjeomjedisore –Regjioni Lindor Kosovës njihet si regjion i pasur me resurse natyrore, sidomos resurse minerale dhe energjetike. Mirëpo shfrytëzimi i resurseve natyrore, në disa pjesë të lindjes së Kosovës është mjaft shqetësuese, duke ndryshuar edhe peizazhin natyror. Rezultatet e hulumtimit përfshijnë:

- Analizën e veçorive të përgjithshme fiziko-gjeografike të Regjionin.
- Identifikimin e resurseve natyrore
- Pasqyrimi i gjendjes së trashëgimisë natyrore dhe problemet që i kanosen,
- Evidentimin e problemeve gjeomjedisore të regjionit.

Kjo vepër është botuar sipas planifikimit në vitin 2017.

3.Revista “Kërkime” nr.22 është botuar gjatë vitit 2016.

Për vitin 2017 është planifikuar të përgatitet dhe të botohet revista shkencore “Kërkime” nr.23. Revista boton tekste dhe kontribute shkencore nga fusha e shkencave të natyrës dhe të shkencave të tjera fundamentale. Sikundër edhe deri tash, edhe në këtë numër të revistës do të botohen punime shkencore të anëtarëve të Seksionit të Shkencave të Natyrës të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, si

dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm, të tillë tekste që do t'i plotësojnë kriteret shkencore, pas vlerësimit profesional që do t'u bëhet nga redaksia e revistës. Redaksia e revistës Research-Kërkime deri tani i ka mbajtur disa mbledhje. Në to është diskutuar mbarëvajtja e punëve dhe hapat e nevojshëm, me qëllim që të mundësohet dalja sa më parë e revistës në gjuhën angleze. Në njëërën mbledhje të redaksisë së revistës në muajin shtator 2017 ka marr pjesë edhe prof Abdel Razik Sebak nga Universiteti i Montrealtit Kanada. Redaksia mendon se nevojitet plotësimi i këshillit të redaksisë me anëtarë reprezentativ të lëmenjve të ndryshme në të cilat nxjerr punime revista si dhe krijimi i një trupi këshillëdhënës ndërkombëtar ashtu si e kanë revistat tjera shkencore. Po ashtu, në koordinim me të gjitha institucionet relevante në vend, kërkohet që të gjendet zgjidhje për pajisjen e revistës me numrin ISSN. Në faqenueb të ASHAK-ut është bërë ftesa për dorëzim të dorëshkrimeve të punimeve nga ana e autorëve deri më datën 30 nëntor 2017. Botimi i këtij numri të revistës parashikohet në fillim të vitit 2018.

LIGJËRATA

Ligjërata të ndërsjella të akademikëve (ASHAK-ASHSH), nuk ka pasur.

PROMOVIME

Gjatë vitit 2017, përkatësisht më 31 maj në ambientet e ASHAK është bërë promovimi veprave të Seksionit të Shkencave të Natyrës:

1. Ruzhdi Pllana: Klima e Kosovës,

ASHAK-2015;

2. Ujitja në Kosovë-menaxhimi i ujërave për bujqësi të qëndrueshme, ASHAK-2015;

3. Latif Susuri: Fjalori i bujqësisë, ASHAK-2016;

4. Arsim Ejupi: Natyra e Luginës së Preshevës, ASHAK- 2016 ;

5. Revista “Kërkime” nr.22, ASHAK-2016;

6.Isuf Krasniqi dhe Bahri Prebreza: Zbrazjet atmosferike, ASHAK-2016;

7. Salih Gashi: Osmoza e kundërt, ASHAK-2016;

8. Valbon Bytyçi: Regjioni lindor i Kosovës, ASHAK-2017;

9. Minir Dushi: Xeheroret e nikelit dhe të kobaltit të vendit tonë, ASHAK-2017.

Raportin e përgatiti akademik Fejzullah Krasniqi, ish Sekretar i Seksionit.

Sekretari i Seksionit

Anëtar korrespondent Fetah Podvorica, d.v.

VI. SEKSIONI I ARTEVE

PROJEKTE

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës. – Ka përfunduar përgatitja e dorëshkrimit të Fjalorit Enciklopedik të Kosovës, që është projekt i përbashkët afatgjatë i të gjithë seksioneve. Ka qenë e planifikuar që dorëshkrimi të dorëzohet për shtyp që në muajt shtator-tetor të vitit 2017. Mungesa e mjeteve materiale e ka shtyrë finalizimin e botimit për fillimin e vitit 2018.

BOTIME

1. Abdurrahim Buza –Monografi me autor akademik Tahir Emra. Dorëshkrimi është dorëzuar për të vazhduar me procedurat e mëtejme, por për shkak të mungesës së mjeteve financiare shtyhet për botim.

TUBIME SHKENCORE

1. Tryezë muzikologjike kushtuar 1-vjetorit të Shenjtërimit të Nënës Terezë dhe Shugurimit të Katedralës katolike në Prishtinë mbi vepra të kompozitorëve tanë kushtuar Nënës Terezë.

Tryeza u mbajt, më 30 nëntor 2017, në mjediset e Akademisë.

Fjalën e hapjes e mbajti akademik Zeqirja Ballata, ndërsa më pas u paraqitën me kumtesa:

Monsignor Don Lush Gjergji-“Prirjet artistike të Nënës Shën Terezë Bojaxhiu”;

Zeqirja Ballata - “Këngët korale për Shën Terezën tonë”;

Indira Çipa - “Veprat kamerale për Nënë Shën Terezë”;

Kushtrim Jakupi - “Këngët solo /romancat për Shën Terezën tonë”;

Arnisa Rexhepi - “Këngët korale pionierësh kushtuar Nënës Shën Terezë”, dhe

Rreze Kryeziu Breznica - “Të korrat e kompozitorëve tanë për Shën Terezën”.

Tryeza përmbylli punimet me sukses.

KONCERTE

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, në kuadër të Protokollit të bashkëpunimit, organizoi Koncert të përbashkët veprash kamerale - muzikë dhome të akademikut Vasil S. Tole. Koncerti u mbajt më 18 maj 2017, në sallën e ASHAK. Të pranishëm, përveç anëtarëve të Akademisë, ishin përfaqësues nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe mysafirë të shumtë.

EKSPOZITA

1. Ekspozita personale e akademik Rexhep Ferri, me rastin e 80-vjetorit të lindjes. Ekspozita është mbajtur më 10 tetor në mjediset e Akademisë. Në të janë paraqitur vepra të shumta të akademik Ferrit, të realizuara në tapiceri dhe disa piktura të reja. Përveç anëtarëve të Akademisë morën pjesë edhe mysafirë të shumtë.

Fjalën e hapjes e mbajti sekretari i Seksionit të Arteve anëtar korrespondent Luan Mulliqi, i cili e vlerësoi lartë punën e akademik Ferrit. Në fund autori me fjalë të bukura e plot emocion, falënderoi Akademinë për organizimin e Ekspozitës dhe të gjithë të pranishmit në sallë.

2. Ekspozita e përbashkët me vepra të arteve pamore të anëtarëve të akademive, Tiranë – Prishtinë. Ka qenë e paraparë në Protokollin e bashkëpunimit ASHAK-ASHSH, 2015-2017 dhe ka qenë e planifikuar të mbahet në gjysmën e dytë të vitit

2017. Nga ana e ASHAK-ut janë bërë të gjitha përgatitjet: mbledhja e veprave artistike, kornizimi i disa prej tyre e deri te botimi i katalogut, por për shkak të ngecjeve nga ana e ASHSH-së, nuk ka mundur të realizohet. ASHAK-u, ka pasur komunikim të vazhdueshëm me ASHSH-në, por ata nuk kanë arritur të sigurojnë vendin për mbajtjen e ekspozitës. Sipas bisedave të fundit ka shpresë se ë shpejti mund të caktohen datat për mbajtjen e saj.

Sekretari i Seksionit

Anëtar korrespondent Luan Mulliqi, d.v.

VII. SHËRBIMI, PROFESIONAL, ADMINISTRATIV E TEKNIK

Shërbimi Administrativ, Profesional e Teknik (SHPAT) i ASHAK-ut, përgjegjës për ofrimin e shërbimeve profesionale, administrative e teknike u angazhua dhe punoi në realizimin e Programit të punës të Akademisë.

Departamenti për buxhet dhe financa – DBF

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2017, Departamenti për Buxhet dhe Financa, krahas shfrytëzimit të mundësive për ngritje profesionale përmes trajnimeve, punëtorive e seminareve të organizuara për sektorin e financave në Kosovë dhe më gjerë, ka përmbushur të gjitha objektivat dhe detyrat e dala nga aktivitetet e planifikuara me Programin e punës, të miratuar nga Menaxhmenti i lartë i Akademisë.

Buxheti i aprovuar sipas Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2017 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës ishte në vlerë totale prej 1,094,851.00 € (në kategorinë paga e mëditje 714,908.00 €, në kategorinë mallra e shërbime 324,943.00 €, në kategorinë shpenzime komunale 5,000.00 € dhe në kategorinë e shpenzimeve kapitale 50,000.00 €).

Buxheti i aprovuar sipas Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2017 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës ka pësuar ndryshime me Vendimin e Qeverisë nr.08/151 të datës 02.08.2017, ndryshim i cili ka reflektuar edhe në Ligjin e Rishikimit të Buxhetit për vitin 2017. ASHAK-ut i është përvetësuar vlera prej 45,000.00 € në kategorinë e shpenzimeve kapitale dhe si rezultat i këtyre ndryshimeve në bazë të Ligjit për rishikimin e buxhetit për vitin 2017, vlera totale e buxhetit ka rënë në shumën prej 1,049,851.00 €.

Në fund të vitit 2017 Qeveria e Republikës së Kosovës ka marr vendime për shkurtime buxhetore, Vendimi nr.10/19 i datës 15.12.2017 kursime 5,000.00€ në kategorinë e shpenzimeve kapitale dhe Vendimi për shtim të mjeteve financiare në vlerë prej 71,219.00 € për mbulimin e minuseve në kategorinë e paga e mëditje. Buxheti përfundimtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës për vitin 2017, pas të gjitha ndryshimeve të shkaktuara nga rishikimi dhe vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, ishte në vlerë

totale prej 1,116,070.00 €. (në kategorinë paga e mëditje 786,127.00 €, në kategorinë mallra e shërbime 324,943.00 € dhe në kategorinë shpenzime komunale 5,000.00 €).

Mjetet në dispozicion të pashfrytëzuara në total kapin shumën prej 17,489.33 €, prej tyre 15,528.80 € në kategorinë mallra e shërbime dhe 1,960.53 € në shpenzime komunale.

Përpos mjeteve nga Fondi i Buxhetit të Republikës së Kosovës, ASHAK-u ka pasur në dispozicion donacionin e bartur nga viti 2016, të përfituar nga Salbatring Internacional, në vlerë totale prej 11,630.12. Nga ky fond janë shpenzuar 2,993.13 € për pasurimin e bibliotekës me vepra shkencore. Në dispozicion gjithsej kanë mbetur edhe 8,636.99 €. Nga Buxheti i Akademisë, gjatë periudhës janar-dhjetor 2017, në të gjitha kategoritë ekonomike janë alokuar mjete në total prej 1,094.851.00 €. Megjithatë, as alokimi e as dinamika e shpenzimeve nuk janë bërë sipas planit fillestar të rrjedhjes së parasë, si pasojë e ndryshimeve të bëra përmes rishikimit, vendimeve të Qeverisë dhe shkurtimeve buxhetore.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2017, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës ka grumbulluar të hyra qeveritare, në vlerë totale prej 7,971.61€, nga shitja e botimeve të saj.

Shkalla e përgjithshme e realizimit të buxhetit të Akademisë në total për vitin 2017 është 98.43% (në kategorinë paga e mëditje realizuar 100%, në mallra dhe shërbime 95.22 % dhe në shpenzime komunale 60.79

%), ndërsa shkalla e realizmit të mjeteve të donacionit është 25.74%.

Departamenti i Përkrahjes Profesionale dhe i Teknologjisë së Informacionit e Komunikimeve – DPPTIK

Departamenti i Përkrahjes Profesionale dhe i Teknologjisë së Informacionit e Komunikimeve përgjegjës për ofrimin e shërbimeve profesionale të teknologjisë së informacionit e komunikimeve, dhe të veprimtarisë botuese, përpunoi rreth 600 tabakë shtypi (9600 faqe), dhe organizoi botimin e 16 titujve të librave, të 3 revistave shkencore me separatë dhe të Vjetarit 2016, me rreth 6370 kopje, si dhe përgatiti për shtyp 13 tituj të tjerë me rreth 7120 faqe, të gatshëm për t'u botuar në 2018-ën.

DPPTIK-u:

-Përllogarit tabakët e autorit dhe tabakët e shtypit për 32 tituj;

-Përkrahu profesionalisht punën e akademikëve dhe të Administratës. Në bashkërenditje me shërbimet e tjera të ASHAK-ut, përkrahu profesionalisht drejtpërsëdrejti 17 (shtatëmbëdhjetë) aktivitete akademike e shkencore (konferenca, tubime, tryeza shkencore, ekspozita, koncerte, nënshkrime marrëveshjesh, takime mes akademive, ndarje shpërblimesh, panairë librash, ligjërata, mbledhje komemorative etj.), si dhe mbarëvajtjen e Zgjedhjeve 2017;

-Përgatiti specifikimet teknike dhe inicioi 16 aktivitete prokurimi,

gjegjesisht 51% të të gjitha kërkesave të prokurimit të ASHAK-ut, dhe menaxhoi 14 kontrata.

-Përkrahu profesionalisht projektin Shqipja e shkruar e shek. XX, projektin e Vendbanimeve, si dhe projektin e Fjalorit enciklopedik;

-Përgatiti projekt propozimin Përgatitja e infrastrukturës për skanim dhe digjitalizim, në kuadër të të cilit projekt, u ble edhe skaneri profesional ultra i shpejtë për skanimin e materialeve të libërzuara;

-Me përpjekje të vazhdueshme për ndërtimin dhe mbindërtimin e kapaciteteve lokale profesionale zbatoi metodat e përkrahjes së drejtpërdrejtë dhe të bashkëpunimit të ndërsjellët dhe të baraspeshuar me Akademikët, dhe me departamentet e tjera, si edhe me Operatorët ekonomikë të jashtëm duke e përmirësuar dhe ngritur vazhd-ueshëm cilësinë e shërbimeve teknike profesionale dhe të shërbimeve të tjera të përkrahjes profesionale;

-Vazhdoi me organizimin dhe rregullimin e depos së Librit si dhe të materialit tjetër harxhues të nevojshëm për funksionimin normal të Administratës dhe Akademisë;

-Po ashtu e mbikëqyri dhe u përkujdes për funksionimin normal të shërbimeve të TIK-ut dhe Multimedieve, si dhe për funksionimin normal të faquesub duke e populluar atë me të dhënat e përditësuar. Organizoi dhe mbikëqyri edhe mirëmbajtjen dhe funksionimin normal të shërbimeve logjistike për Administratën dhe Akademinë;

-Vazhdoi të kontribuojë në standardizimin e dizajnit të Librit të ASHAK-ut, dhe përgatiti specifikimet teknike të produkteve të veçanta të nevojshme për punën e ASHAK-ut. DPPTIK-u shtyu aktivitetet në drejtim të përgatitjes profesionale të shkresave zyrtare duke ndihmuar me gjedhet përkatëse dhe me udhëzimet profesionale;

-Ndihmoi punën e QLE-së duke vazhduar me skanimin e mijëra faqeve të librave dhe revistave të vjetra të parastandardit të nevojshme për projektin Shqipja e shekullit XX, dhe u kujdes për pasurimin e fondit të librit të QLE-së;

-Mori pjesë në hartimin dhe përgatitjen e rregulloreve të nevojshme për punën e ASHAK-ut;

-Mori pjesë në të gjitha aktivitetet profesionale të Administratës dhe të ASHAK-ut: nëpër komisione profesionale, të rekrutimit, të pranimit të mallit, të përcaktimit të cilësisë etj.

Departamenti i Bibliotekës dhe Arkivit - DBA

Biblioteka

Gjatë vitit 2017 kanë vazhduar punët rreth mirëmbajtjes dhe riorganizimit të bibliotekës:

-Është aranzhuar fondi bibliotekar dhe ka përfunduar regjistrimi i fondit ekzistues dhe librave të blerë në ndërkohë. Ka vazhduar regjistrimi dhe rikuperimi i fondit të mbetur të librave dhe revistave;

-Ka vazhduar pranimi i revistave të cilat Akademia i merr për vite. Janë blerë kopjet e pesë gazetave ditore

(Bota Sot, Epoka e Re, Koha Ditore, Kosova Sot dhe Zëri). Janë regjistruar të gjitha shkrimet (përfshirë shkrime autoriale të anëtarëve të ASHAK-ut) që lidhen me ASHAK-un në shumicën e rasteve janë fotokopjuar);

-Janë lidhur gazetat Koha Ditore dhe Zëri të vitit 2016 dhe janë vendosur në rafte sipas serive përkatëse;

-Janë regjistruar dhe riorganizuar të gjithë periodikët dhe revistat -- kopjet e vjetra dhe të rejt;

Po ashtu botimet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës janë prezantuar në tri panaiere -- Panairi i Prishtinës, Panairi i Tiranës, dhe Panairi i Frankfurtit. Në dy të parat, botimet e ASHAK janë prezantuar nga personeli i Akademisë, ndërsa në atë të Frankfurtit nga Shoqata e Botuesve të Kosovës dhe Ministria e Kulturës:

1. Panairi "Prishtina 2017".- Nga data 6-11 qershor, ASHAK-u ka marrë pjesë në panairin tradicional të librit në Prishtinë, "Prishtina 2017." Edhe kësaj here ASHAK-u ka pasur prezantim të suksesshëm. Interesimi i vizitorëve ka qenë i madh dhe janë shitur rreth 380 botime si dhe janë dhuruar një numër i konsiderueshëm botimesh, kryesisht ato me kosto zero dhe katalogu i botimeve;

2. Panairi "Tirana 2017".- Nga data 15 deri 19 nëntor 2017, në Tiranë është mbajtur Panairi i 20-të ndërkombëtar i librit "Tirana 2017." ASHAK-u është paraqitur me botimet e veta në mesin e rreth 80 shtëpive botuese, institucioneve shkencore dhe arsimore nga Shqipëria, Kosova,

Maqedonia, dhe Mali i Zi, përfshirë qendrat kulturore të disa nga ambasadave vendeve të akredituara në Tiranë. ASHAK-u ka pasur prezantim të mirë. Janë shitur mbi 150 botime, veçanërisht të dy viteve të fundit.

Sikurse edhe në vitet e mëparshme, në këtë panair janë blerë një numër i konsiderueshëm i botimeve -- rreth 120 (kryesisht romane sipas kërkesës së Seksionit të Gjuhësisë dhe Letërsisë) dhe një numër revistash e botime të tjera, kryesisht të reja apo që i kanë munguar Bibliotekës së ASHAK-ut;

3. Panairi i Frankfurtit. - Nga data 11 deri 16 tetor është mbajtur Panairi Ndërkombëtar i Frankfurtit, më i madhi i këtij lloji në Evropë. ASHAK-u është paraqitur në këtë panair me 20 botimeve të reja. Sikurse në vitet e mëhershme, në pamundësi për të marrë pjesë është autorizuar Shoqata e Botuesve të Kosovës të prezantojë botimet e ASHAK-ut.

Gjatë vitit 2017, Biblioteka e ASHAK-ut është pasuruar me një numër të konsiderueshëm botimesh përmes këmbimit, dhurimit nga autorët, si dhe blerjes, gjithsej 714 libra të rinj si dhe një numër i konsiderueshëm revistash.

Komunikimi me biblioteka të akademive të ndryshme dhe me institucione kosovare dhe të vendeve të ndryshme të rajonit dhe më gjerë ka vazhduar, duke zgjeruar bashkëpunimin dhe këmbimin e botimeve. Disa nga botimet e Akademisë u janë dërguar akademive të shkencave dhe

të arteve të Shqipërisë, Maqedonisë, Sllovenisë, Malit të Zi, Kroacisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Bullgarisë, si dhe Seksionit të Gjuhës dhe të Kulturës Shqipe të Universitetit të Pragës. Po ashtu ASHAK ka pranuar një numër të konsiderueshëm të botimeve nga disa prej institucioneve të sipërpërmendura dhe të tjera.

Në përputhje me Rregulloren mbi Veprimtarinë Botuese të ASHAK, dhe sipas kërkesave të bërë nga drejtoritë për arsim të disa nga komunave të Kosovës dhe të bibliotekave, institucioneve shkencore e kulturore, janë dhuruar një numër i konsiderueshëm i botimeve të ASHAK-ut. (Lista e botimeve të dhuruara dhe të shituara është në Aneksin më poshtë).

Ka vazhduar dërgimi i botimeve të ASHAK-ut, Bibliotekës së Kongresit Amerikan.

Me qëllim të gjetjes së formës së përshtatshme dhe të përbalueshme nga ASHAK (kostoja financiare dhe stafi në dispozicion) janë zhvilluar dy takime me përfaqësuesen e institutit IZUM nga Sllovenia për aplikimin e programit COBISS në ASHAK. Përfaqësuesja e IZUM-it i ka ofruar ASHAK-ut licencën falas dhe trajnim (po ashtu falas) për një zyrtar të ASHAK si pjesë e një programi që IZUM e zhvillon Shqipëri. Kurset trajnuese (në Tiranë) pritet të fillojnë në janar të vitit 2018 dhe i mbetet Kryesisë së ASHAK të miratojë dërgimin e një zyrtari të ASHAK.

Personali i DBA ka marrë pjesë në disa trajnime dhe seminare të fushave të

ndryshme që lidhen me edukimin e personelit. Përfaqësues të DBA-së kanë marrë në aktivitetet mbajtur në kuadër të manifestimeve "Java e së Bibliotekës," organizuar nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës.

Arkivi

Në mungesë të personelit të kualifikuar nuk ka pasur aktivitete që lidhen drejtpërsëdrejti me arkivim. Megjithatë ka filluar deponimi i materialit arkivor në sallën e dedikuar për Arkiv, përmes një procedure të pranim-dorëzimit ndërmjet DBA-së

dhe departamenteve përkatëse.

Në mungesë të stafit, zyrtarja e DBA-së Rejhane Islami është angazhuar më punë shtese (Zyrtare e logjistikës dhe Zyrtare e personelit). Stafi i DBA-së është angazhuar edhe në aktivitete të tjera të organizuara nga ASHAK (konferenca, tryeza shkencore, ekspozita, koncerte, etj.)

Sekretare e Akademisë

Lendita Pula, d.v.

RAPORTI I PERFORMANCËS FINANCIARE PËR VITIN 2017

Mjetet e ndara dhe të aprovuara sipas Ligjit të Buxhetit Nr.05/L-125 për vitin 2017, për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, kanë qenë në vlerë totale prej **1,094,851.00 €** në të gjitha kategoritë ekonomike. Buxheti sipas Ligjit për vitin 2017, Projektligjit për plotësim ndryshime të Ligjit me nr.05/L-125 dhe vendimeve të Qeverisë, pasqyrohet në tabelat e mëposhtme:

I. Buxheti sipas Ligjit të Buxhetit nr. 05/L-125 është i pasqyruar si në vijim:

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investime kapitale	Gjithsej
714,908.00	324,943.00	5,000.00	50,000.00	1,094,851.00

II. Buxheti sipas Projektligjit për plotësim e ndryshim të Ligjit nr. 05/L-125, është i pasqyruar si në vijim:

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investime kapitale	Gjithsej
714,908.00	324,943.00	5,000.00	5,000.00	1,049,851.00

Buxheti i aprovuar sipas Ligjit të Buxhetit Nr.05/L-125 të Republikës së Kosovës për vitin 2017 ka pësuar ndryshime sipas Vendimit të Qeverisë me nr.08/151 të datës 02.08.2017 dhe Projektligjit për plotësim e ndryshim të Ligjit nr.05/L-125 për Buxhetin e vitit 2017, duke u zvogëluar për vlerën 45,000.00 € në kategorinë e shpenzimeve kapitale.

III. Buxheti përfundimtar i alokuar është i pasqyruar si në vijim:

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investime kapitale	Gjithsej
786,127.00	324,943.00	5,000.00	0.00	1,116,070.00

Buxheti përfundimtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës për vitin 2017, pas të gjitha ndryshimeve të shkaktuara nga Projektligji për plotësim e ndryshim të Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e 2017 dhe Vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ishte në vlerë totale prej 1,116,070.00 €, nga të cilat në kategorinë paga dhe mëditje ishin 786,127.00 €, në kategorinë mallra dhe shërbime 324,943.00 €, në kategorinë shpenzime komunale 5,000.00 € (Vendimi nr.10/19 i datës 15.12.2017, kursime në vlerën 5,000.00€ në kategorinë e shpenzimeve kapitale, Vendimi nr.1/151 i datës 22.12.2017 shtim të mjeteve në vlerë prej 71,219.00 € për mbulimin e minuseve në kategorinë e paga dhe mëditje).

BUXHETI I APROVUAR PËR 2017
ALOKIMI DHE REALIZIMI PËR PERIU DHËN
JANAR - DHJETOR

Kategoritë ekonomike	Buxheti i aprovuar me ligj (A)	Buxheti me Rishikim (B)	Buxheti Final (C)	Alokimi Janar – Dhjetor (C)	Realizimi Janar – Dhjetor (D)	Realizimi buxhetit % (D/C)
Paga dhe mëditje	714,908.00	714,908.00	786,127.00	786,127.00	714,908.00	100%
Mallra dhe shërbime	324,943.00	324,943.00	324,943.00	324,943.00	309,414.20	95.22%
Shpenzime komunale	5,000.00	5,000.00	5,000.00	5,000.00	3,039.47	60.79%
Shpenzime kapitale	50,000.00	5,000.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej	1,094,851.00	1,049,851.00	1,116,070.00	1,116,070.00	1,098,580.67	98.43%

Vlera fillestare sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2017 ka qenë 1,094,851.00€. Ndryshimet e bëra në ndarjet fillestare buxhetore krahasuar me ato finale, janë pasojë e Projektligjit për plotësim e ndryshim të Ligjit nr. 05/L-125 të buxhetit për vitin 2017, si dhe e Vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Alokimet e mjeteve nga buxheti i konsoliduar i Kosovës sipas Planit të rrjedhës së parasë për periudhën
Janar – Dhjetor 2017

Mjetet e alokuara në periudhën janar – dhjetor kanë qenë në vlerë prej **1,116,070.00 €**.

Realizimi i buxhetit për periudhën Janar – Dhjetor 2017

Realizimi i buxhetit në bazë të alokimit vjetor ka qenë **1,098,580.67 €**, shprehur në përqindje 98.43 % i buxhetit të alokuar.

Realizimi i buxhetit pasqyrohet si në vijim:

Kategoritë ekonomike	Alokimi Janar – Dhjetor (A)	Realizimi Janar – Dhjetor (B)	Mjetet e pashfrytëzuar a në dispozicion (C)	% (B/A)
Paga dhe mëditje	786,127.00	786,127.00	0.00	100%
Mallra dhe shërbime	324,943.00	309,414.20	15,528.80	95.22%
Shpenzime komunale	5,000.00	3,039.47	1,960.53	60.79%
Shpenzimet kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00%
Gjithsej	1,116,070.00	1,098,580.67	17,489.33	98.43 %

Paga dhe mëditje

Mjetet e alokuara për paga dhe mëditje për vitin 2017 janë në vlerë prej **786,127.00 €**, ndërsa numri i aprovuar për personelin e ASHAK-ut është 55.

Alokimi

Kategoria ekonomike	janar - shtator	tetor	nëntor	dhjetor	Gjithsej	%
Paga dhe mëditje	588,562.87	65,854.71	65,854.71	65,854.71	786,127.00	100%

Realizimi

Muaji	Numri i punëtorëve	Buxheti	Alokimi (A)	Realizimi (B)	Ndryshimi (A-B)
Janar	55	64,566.19	64,566.19	64,566.19	0.00
Shkurt	55	66,894.63	66,894.63	66,894.63	0.00
Mars	55	64,954.14	64,954.14	64,954.14	0.00
Prill	55	65,001.48	65,001.48	65,001.48	0.00
Maj	55	65,003.62	65,003.62	65,003.62	0.00
Qershor	55	64,578.68	64,578.68	64,578.68	0.00
Korrik	55	65,854.71	65,854.71	65,854.71	0.00
Gusht	55	65,854.71	65,854.71	65,854.71	0.00
Shtator	55	65,854.71	65,854.71	65,854.71	0.00
Tetor	55	65,854.71	65,854.71	65,854.71	0.00
Nëntor	55	65,854.71	65,854.71	65,854.71	0.00
Dhjetor	55	65,854.71	65,854.71	65,854.71	0.00
Gjithsej	55	786,127.00	786,127.00	786,127.00	0.00

Mallra dhe shërbime

Mjetet e alokuar për mallra dhe shërbime për vitin 2017 janë në vlerë prej 324,943.00 €. Alokimi i mjeteve për mallra dhe shërbime për periudhën janar-dhjetor 2017 përbën 100 % të buxhetit të aprovuar.

Alokimi

Kategoria ekonomike	Janar -shtator	tetor	nëntor	dhjetor	Gjithsej	%
Mallra dhe Shërbime	296,776.00	13,470.00	9.540.00	5,160.00	324,943.00	100%

Realizimi

Nr. r.	Muaji	Buxheti	Alokimi (A)	Realizimi (B)	Ndryshimi (A-B)
1	Janar	48,220.00	48,220.00	17,449.76	30,770.24
2	Shkurt	83,620.00	83,620.00	31,445.29	52,174.71
3	Mars	34,010.00	34,010.00	40,698.51	(6,688.51)
4	Prill	30,823.00	30,823.00	14,477.94	16,345.06
5	Maj	30,250.00	30,250.00	40,797.12	(10,547.12)
6	Qershor	20,720.00	20,720.00	33,267.95	(12,547.95)
7	Korrik	18,160.00	18,160.00	18,521.02	-361.02
8	Gusht	10,020.00	10,020.00	4,175.87	5,844.13
9	Shtator	20,950.00	20,950.00	18,701.22	2,248.78
10	Tetor	13,470.00	13,470.00	23,284.28	(9,814.28)
11	Nëntor	9,540.00	9,540.00	38,073.13	(28,533.13)
12	Dhjetor	5,160.00	5,160.00	28,522.11	-23,362.11
	Total	324,943.00	324,943.00	309,414.20	15,528.80

Shpenzimet për shërbimet komunale

Buxheti për shpenzime komunale për vitin 2017 është 5,000.00€. Alokimi i mjeteve për shpenzime komunale për periudhën janar-dhjetor 2017 përbën 100 % të buxhetit të aprovuar.

Alokimi

Kategoria ekonomike	janar-shtator	tetor	nëntor	dhjetor	Gjithsej	%
Shpenzime komunale	3,970.00	500.00	400.00	130.00	5,000.00	100%

Realizimi ¹

Nr.	Muaji	Buxheti	Alokimi (A)	Realizimi (B)	Ndryshimi (A-B)
1	Janar	0.00	0.00	0.00	166.37
2	Shkurt	700.00	700.00	533.63	500.00
3	Mars	500.00	500.00	0.00	110.55
4	Prill	350.00	350.00	239.45	307.36
5	Maj	550.00	550.00	242.64	500.00
6	Qershor	500.00	500.00	0.00	233.97
7	Korrik	470.00	470.00	236.03	500.00
8	Gusht	500.00	500.00	0.00	(95.07)
9	Shtator	400.00	400.00	495.07	500.00
10	Tetor	500.00	500.00	0.00	(332.84)
11	Nëntor	400.00	400.00	732.84	(429.81)
12	Dhjetor	130.00	130.00	559.81	166.37
	Gjithsej	5,000.00	5,000.00	3,039.47	1,960.53

Donacionet – Grantet e donatorëve

Emri i donatorëve	Totali i grantit	Alokimi	Realizimi	Mjetet e lira	%
Salbating International	7,630.12	7,630.12	2,993.13	4,636.99	39.23%
Salbating International	4,000.00	4,000.00	0.00	4,000.00	0.00 %
Gjithsej	11,630.12	11,630.12	2,993.13	8,636.99	25.74 %

Përpos mjeteve nga Fondi i Buxhetit të Republikës së Kosovës, ASHAK ka pasur donacionin e bartur nga viti 2016, të pranuar nga Salbating Internacional, në vlerë totale prej 11,630.12 €, fond i cili për vitin 2017 ka qenë i ndarë në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për blerjen e librave në vlerë prej 7,630.12 € dhe në kategorinë e subvencioneve për ndarjen e shpërblimit mbështetës në vlerë prej 4,000.00 €. Nga ky fond janë shpenzuar 2,993.13 € për blerjen e librave

¹ Shpenzimet komunale nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës janë bërë vetëm në kodin e telefonisë fikse, shpenzimet tjera komunale i mbulon Ministria e Administratës Publike.

- pasurimin e bibliotekës me vepra shkencore sipas marrëveshjes me donatorin, nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Në dispozicion gjithsej janë edhe 8,636.99 €, prej tyre 4,636.99 € në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, dhe 4,000.00 € në kategorinë e subvencioneve për ndarjen e shpërblimit mbështetës.

ASHAK ka realizuar edhe të hyra jo tatimore nga shitja e botimeve në vlerë prej 7,971.61 €, të cilat janë depozituar drejtpërsëdrejti në llogarinë e Vetme të Thesarit.

Fal përkushtimit maksimal profesional të Departamentit për Buxhet dhe Financa (DBF), në bashkëpunim me departamentete e tjera të ASHAK-ut, Institucioni ynë ka arritur të realizojë buxhetin në nivel prej 98.43%.

PROGRAMI I PUNËS SË ASHAK-ut PËR VITIN 2018



I. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË PROJEKTE

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës. – Nga perspektiva kur po hartohet ky Program i punës për vitin 2018 dhe nga rezultatet e zhvillimeve të deritashme, mund të konsiderohet se projekti i Fjalori Enciklopedik i Kosovës, i përbashkët i të gjithë seksioneve të ASHAK-ut, do të jetë finalizuar dhe do të ketë dalë nga shtypi para përfundimit të vitit 2017. Gjatë 2018-ës mund të parashihen programe promovuese, kontakte me lexues dhe institucione apo aktivitete të tjera të ngjashme. Njëkohësisht do të fillojë funksionalizimi i një redaksie e cila do të mbajë vazhdimësinë e plotësimit të zërave të Fjalorit.

2. Këshilli Ndërakademik për Gjuhën Shqipe. – Puna e Këshillit, që ishte edhe pjesë e Protokollin të Bashkëpunimit midis ASHAK dhe ASHSH për vitet 2016/2017, ka vazhduar të ecë me ritme të ngadalësuar, ndoshta dhe ka stagnuar. Përkundër interesit tonë që aktiviteti të vazhdohet, sepse dukej se kanë mbetur shumë çështje për t'u diskutuar, nuk ka pasur ndonjë lëvizje të dukshme përpara. Është përmendur mungesa e kompensimit të punës së anëtarëve të grupeve, që mund të ishte shtysë e intensifikimit të veprimtarisë. Këshilli është duke e përmbyllur aktivitetin e vet dhe pritët përgatitja e materialeve për botim, të cilat mund të finalizohen gjatë vitit 2018.

3. Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX. – Projekti kishte paraparë nga fundi i vitit 2016 dhe gjatë vitit 2017 të hartohet fjalësi dhe të bëhej

gati për botim (që ka mundësi të përfundojë brenda vitit 2017). Skanimi, digjitalizimi i materialeve dhe puna rreth Korpusit ka kërkuar angazhime të gjera, me specialistë të fushave si dhe kompletimin e kushteve teknike. Vështirësitë rreth ngritjes së kapaciteteve dhe aftësimit teknik e profesional të Qendrës Leksikografike Enciklopedike, para së gjithash sigurimi i skanerëve me performansa të sofistikuar, ende nuk janë kapërcyer. Në këto rrethana, megjithatë, është përgatitur dhe tashmë është botuar Fjalësi shqip i lematizuar i Fjalorit serbokroatisht – shqip të S. Dobroshit të vitit 1953. Ka gjasa që për vitin 2018 Të sigurohen skanerët profesionalë dhe të sofistikuar, ndaj pritët intensifikimi i punës së këtij projekti afatgjatë.

4. Vepra e plotë e Norbert Joklit. – Gjatë vitit 2017 doli vëllimi i dytë i veprës së albanologut të shquar austriak Norbert Jokl, Studime krahasuese për gjuhën shqipe / Historisch-Vergleichende untersuchungen über das Albanische, përgatitur nga akademik Rexhep Ismajli dhe prof. dr. Heiner Eichner, i paparaparë me këtë program afatgjatë të Seksionit. Për vitin 2018 parashihet të botohet vëllimi i tretë Hulumtime linguistike – kulturo-historike në fushë të shqipes, i cili ka mjaft vështirësi rreth përgatitjes për shkak se fillimisht është menduar të përdoret një përkthim ekzistues në dorëshkrim, i cili ka mungesë pjesësh, ndaj është i domosdoshëm krahasimi me origjinalin dhe plotësimi, mbase dhe ripërkthimi. Andaj botimi i paraparë më herët, do të përcillet në vitin 2018.

Projekti do të vazhdojë me mbledhjen, sistemimin, përkthimin dhe botimin e kontributeve të tjera Joklit me qëllim që vepra të dalë sa më e plotë, për çka kemi edhe ndihmën e Akademisë austriake.

PROJEKTE TË REJA

1.Korpusi i shqipes së folur në Kosovë. Krijimi i një korpusi të folur të shqipes në Kosovë, që nënkupton mbledhjen e materialeve gjuhësore të folura nëpër të gjitha viset e Kosovës, do t'u shërbente studiuesve në fushë të gjuhësisë në radhë të parë, por edhe në fusha të tjera si antropologjia e sociologjia. Krahas materialit të regjistruar korpusi do të përfshijë të dhënat (brendafolëse) të respondentëve: moshë, gjinia, shkollimi, profesioni, njohja e gjuhëve të tjera, lëvizja nga vendbanimi dhe kontaktet me të folmet e tjera. Ky korpus shërben për matje kuantitative në fushën e fonetikës e të fonologjisë, të morfologjisë e të sintaksës si dhe të leksikut e të sociolinguistikës. Anketuesit do t'i marrin të dhënat në terren, do t'i regjistrojnë individët veç e veç, do t'i identifikojnë folësit dhe pastaj, me metodat sociolinguistike e dialektologjike, do të intervistojnë respondentë të ndryshëm për ta regjistruar gjuhën dhe kulturën brenda komunitetit. Materialet e mbledhura do të klasifikohen sipas zonave, statuseve shoqërore, moshës, shkollimit, gjinisë dhe mund të transkribohen për lehtësim studimi. Materiali i plotë do të mbetet bazë shënimesh për studime të ardhshme të gjuhës shqipe. Projekti ka dy faza:

regjistrimi dhe arkivimi digjital i materialit, faza e parë, transkriptimi (i pjesshëm) dhe paraqitja, faza e dytë. Do të fillojë më 3 janar 2018 dhe do të përfundojë fazën e parë më 25 dhjetor 2018. Bartës të projektit janë Bardh Rugova, Rexhep Ismajli, Mehmet Halimi. Është dorëzuar propozimi i detajuar.

2.Fjalor enciklopedik i gjuhësisë (titull pune). - Krijimi i një Fjalori enciklopedik të gjuhësisë, duke e pasur në rend të parë gjuhësinë shqiptare, do të ndihmonte për normëzimin e terminologjisë së gjuhësisë në gjuhën shqipe. Rëndësia e një projekti të tillë do të ishte, para së gjithash, shpjegimi dhe interpretimi i termave të gjuhësisë. Duke i pasur brenda vetes termat e fushave të ndryshme të gjuhësisë, Fjalori do të shërbente si mjet i rëndësishëm për studentët, studiuesit dhe të interesuarit e tjerë. Redaksia krijon regjistrin e zërave dhe i përzgjedh autorët sipas fushave të caktuara. Caktohen fusha të ndryshme të gjuhësisë (a. fonetikë, b. studime sociolinguistike dhe funksionale, c. gramatikë). Fjalorët e termave të secilës fushë veç e veç publikohen, pasi të kenë përfunduar. Pas përfundimit të të gjitha fushave, publikohet Fjalori i përbashkët enciklopedik i gjuhësisë, të cilit i shtohen sferat e gjuhësisë së aplikuar dhe të fushave të tjera që nuk janë të përfshira në projektet fillestare. Projekti ka disa faza: Fjalorët e fushave një nga një deri në krijimin e një fjalori të përbashkët të të gjitha fushave. Bartës të projektit do të jenë Rexhep Ismajli dhe Bardh Rugova. Data e fillimit të Projektit: 3 janar 2018; përfundimi i

Fjalorit të fonetikës: 30 qershor 2018; përfundimi i Fjalorit të studimeve sociolinguistike dhe funksionale: 25 dhjetor 2018; përfundimi i Fjalorit të gramatikës: 30 qershor 2019. Është dorëzuar propozimin e detajuar.

TUBIME SHKENCORE

1. Romani shqiptar, fillimi i shekullit XXI, Konferencë shkencore dyditore. SGJL edhe më parë kishte propozuar të vinte në programin e punës romanin shqiptar. Por kësaj here synohet të vështrohet fillimi i shekullit XXI, pra romani i rreth dy dekadave të fundit, duke synuar një bosht rekapitules të periudhës më dinamike të zhvillimit të tij. Diskutimi gjithsesi do të përfshijë autorët e rinj të paraqitur në këta vite të fundit, por edhe prurjet e autorëve tashmë të njohur para kësaj periudhe, tendencat dhe orientimet e tyre. Konferenca do të mbledhë kritikë, studiues e dijetarë të letërsisë, për trajtim të shumanshëm të zhanrit të romanit shqiptar. Pos interpretimit e vlerësimit të veprave të veçanta, kërkimi mund të rrokë shndërrimet e zhanrit të romanit në këtë kohë; tematikat e stilin; trashëgimin e thyerjet; universalitetin e autenticitetin; receptimin e romanit në ambientin e komunikimit bashkëkohor. Më në fund, mund të shtrohet pyetja: a po bëhet romani zhanër zotërues në letërsinë bashkëkohore shqipe? Konferenca do të organizohet në pjesën e dytë të 2018-ës dhe do të propozohet të hyjë në Protokollin për bashkëpunim midis ASHAK dhe ASHSH, që do të nënshkruhet në pjesën e dytë të 2017-ës.

BOTIME

1. Kujtim Shala, Identiteti i pa/zbuluar (Letërsi e identitet). – Është një studim mbi raportet e letërsisë me identitetin, të letërsisë si shenjë identitare dhe të letërsisë si fushë specifike që determinon identitetet. Dorëshkrimi kap problemin kompleks të identitetit teorikisht, pastaj e provon atë te letërsia shqipe e te autorë e vepra të veçanta, gjithë për të provuar raportin e ndërliqshëm, identitet-letërsi. Përpos pjesës teorike, e cila e shtron raportin identitet-letërsi si në raport universal, pjesët e tjera të e kanë objekt letërsinë shqipe, nga filli, dhe problemin e përvijon të lidhur me gjuhën, etninë e kombin, për t'u kthyer aty ku fillon gjithçka, te personi. Kështu, një problem universal provohet në një kulturë konkrete dhe në një fushë të ndërliqshme të saj, si letërsia shqipe. Problemi i hapur kështu merr përgjigje në variantet dhe nuk e ka në përgjigje universale, sepse të gjithë problemet universale mbeten pa një përgjigje finale. Prandaj, përgjigjet tona lidhen me veprën e Barletit, Bogdanit, të De Radës e Naimit, Fishtës, Koliqit, Poradecit, Kutelit, Migjenit, Pashkut e Kadaresë, Rahmanit, Hamitit etj. Dorëshkrimi ka rreth 300 faqe dhe si i plotë do të botohet për herë të parë.

2. Irena Sawicka, Karolina Dargiel, Struktura e rrokjes shqipe. – Prof. dr. I. Sawicka është studiuese e shquar e gjuhës shqipe dhe e gjuhëve të tjera të Ballkanit, autore e monografive të rëndësishme për studimet ballkanike, e studimeve për shqipen, sllaviste me renome ndërkombëtare, e njohur sidomos për monografitë dhe studimet

e veçanta në fushën e fonetikës. Karolina Dargiel është bashkëpunëtore e profesor Sawicka-s, studiuese e re në fushën e fonetikës dhe në fushën e shqipes. Në këtë dorëshkrim prej rreth 150 faqesh, dy autoret kanë marrë në shqyrtim një çështje me rëndësi për studimet e fonetikës së shqipes – atë të rrokjes. Është hera e parë që për këtë problematikë të kemi një studim të gjerë monografik me vështirime komplekse në aspekte të ndryshme dhe me shqyrtime nëpër rrjetin e begatshëm teorik e konkret të shqipes. I tërë studimi është mbështetur në hulumtime mbi materiale të vjela në terren në bazë të dokumentacionit ekzistues tingullor apo të shkruar, apo me vjelje vetanake. Janë bërë dhe matje spektrografike. Libri është shkruar shqip, qartë dhe me një gjuhë të kursyer. Me një redaktim gjuhësor, dorëshkrimi është gati për shtyp. Botimi i kësaj vepre e begaton ndjeshëm fondin e studimeve fonetike të shqipes.

3. Wilfried Fiedler, Vergleichende Grammatik der Balkansprachen. (Morphosyntaktisch-typologische vergleich des Albanischen mit den anderen Balkansprachen). Teil I: Das Verbalsystem [Gramatikë e krahasuar e gjuhëve Ballkanike (Krahasim morfo-sintaksor-tipologjik i shqipes me gjuhët e tjera të Ballkanit). Pjesa I: Sistemi foljor]. - Dorëshkrim i autorit të dy monografive të mëdha të botuara te ne, të dyja të vlerësuara si vepra me rëndësi të autorit sot nga më të rëndësishmit në albanistikë. Sipas vlerësimit të akademik R. Ismajlit, e tërë vepra është ndërtuar me konceptimin e qartë teorik për sistemin foljor në të cilin veçohen

shtyllat e kohës, të mënyrës, të aspektit, të genus verbi-t, të distancës, të para në një tërësi me format dhe funksionet dhe të paraqitura me materiale ekzemplifikuese nga të gjitha gjuhët e Ballkanit. Njohja e të gjitha këtyre gjuhëve ia ka bërë atij të mundur të sjellë një korpus kështu të gjerë, të konsultojë bibliografi të begatshme dhe të bëjë krahasime të dobishme, prej të cilave mund të nxirren përfundime me peshë për konceptimin e përgjithshëm të „gjuhësisë ballkanike“. Pikënisje është gjithnjë sistemi i shqipes, gjithsesi shumë i begatshëm. Dorëshkrimi është shkruar gjermanisht. Kjo vepër do të ketë rëndësi të madhe për studimet ballkanistike, në të vërtetë do të shërbejë si një vepër bazë e referencës në këto studime. Vepra do të shoqërohet me parathënie shqip dhe gjermanisht.

4. Norbert Jokl, Hulumtime linguistike-kulturohistorike në fushë të shqipes. - E botuar më 1923, kryevepra e albanologut austriak Norbert Jokl është me rëndësi të dorës së parë për studimet etimologjike dhe për shumë çështje të tjera të domosdoshme për studimin e historisë së gjuhës shqipe. Përkthimi në shqip nga Anton Krajni është realizuar në vitet '50 të shekullit XX, në gegërishten e atëhershme letrare. Në tekstin e përkthyer shpesh ka mungesa pjesësh, prandaj është dashur të bëhen krahasimet me originalin. Në këtë botim, pranë tekstit shqip, do të jepet edhe teksti gjermanisht i skanuar, në mënyrë që specialistët të mund t'i referohen burimit.

5. Tregime të zgjedhura të shkrimtarëve akademikë (I-IV). - Vite më parë SGJL

kishte realizuar botimin “Poetët akademikë”, në të cilin ishin prezantuar 6 autorë – poetë, anëtarë të ASHAK-ut, me vëllime poezish të zgjedhura të secilit prej tyre. Kësaj radhe synohet të realizohet një botim me katër vëllime me tregime të katër autorëve tregimtarë veç e veç, anëtarë të ASHAK-ut: Anton Pashku, Eqrem Basha, Mehmet Kraja dhe Zejnullah Rrahmani. Përzgjedhja e tregimeve do të bëhet nga vetë autorët (në rastin e Anton Pashkut caktohet përzgjedhësi) ndërsa secili prej vëllimeve me tregime do të shoqërohet me parathënie dhe shënime të tjera biografike e bibliografike. Do të kemi kështu një paraqitje të zgjedhur të prozës tregimtare shqiptare, përmes emrave të autorëve akademikë.

6.Revista “Studime” nr. 25. – Numri i ri i revistës “Studime”, që e boton Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë dhe që tashmë ka një redaksi të re, të prirë nga akademik Zejnullah Rrahmani, do të realizohet si zakonisht në fund të vitit 2018 dhe do të sjellë kontributet e zakonshme, studime e artikuj nga fusha e gjuhësisë dhe e letërsisë, në shqip dhe në gjuhë të tjera të botës, recensione, kronika dhe paraqitje botimesh të reja. Varësisht nga materialet e konferencave ose tryezave shkencore, revista mund t’i përfshijë edhe kumtesat e paraqitura në to, nëse ndonjëri nga këta aktivitete nuk kërkon botim të veçantë.

Sekretari i Seksionit

Akademik Eqrem Basha, d.v.

II. SEKSIONI I SHKENCAVE

SHOQËRORE

PROJEKTE

1.Fjalori Enciklopedik i Kosovës. – Nga perspektiva kur po hartohet ky Program i punës për vitin 2018 dhe nga rezultatet e zhvillimeve të deritashme, mund të konsiderohet se projekti i Fjalori Enciklopedik i Kosovës, i përbashkët i të gjithë seksioneve të ASHAK-ut, do të jetë finalizuar dhe do të ketë dalë nga shtypi para përfundimit të vitit 2017. Gjatë 2018-ës mund të parashihen programe promovuese, kontakte me lexues dhe institucione apo aktivitete të tjera të ngjashme. Njëkohësisht do të fillojë funksionalizimi i një redaksie e cila do të mbajë vazhdimësinë e plotësimit të zërave të Fjalorit.

2.Vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës - Tabloja fizike-hapësinore, demografike dhe funksionale.- Projekt afatmesëm.

Puna në këtë projekt ka filluar në vitin 2017 dhe vazhdon edhe në vitin 2017. Në fazën e parë të punës është duke u bërë mbledhja e të dhënave dhe përpilimi i data bazës shkencore-enciklopedike të vendbanimeve tona, ku është angazhuar një numër ë i madh i ekspertëve nga shkencat gjeohapësinore, pastaj nga sociologë, urbanistë, planerë, ekonomistë, demografë, historianë, etnologë, planerë, administratorë komunalë etj. dhe atë kryesisht kuadro me grada shkencore që punojnë dhe veprojnë në institucione profesionale-shkencore, pastaj në komuna dhe vendbanime, gjithnjë nën udhëheqjen e një anëtarë të grupit të punës në projekt. Grupi i

punës tashmë është ngritur dhe janë angazhuar rreth 40 profesionistë për punë në terren dhe për përpilimin e teksteve.

Është hartuar tashmë modeli në formë të udhëzimit-pyetësorit, si një nga instrumentet kryesore të hulumtimeve në terren për sigurimin e të dhënave burimore dhe origjinale shkencore-enciklopedike mbi vendbanimet e Kosovës në përgjithësi. Kjo punë merr mjaft kohë dhe është e kushtueshme. Punëtorja e parë (Workshop) është mbajtur me bashkëpunëtorë më 6 maj 2017, ku janë dhënë shpjegimet e duhura nga Grupi i punës dhe janë diskutuar të gjitha çështjet relevante të udhëzimeve për punë në terren. Të dhënat e mbledhura përmes udhëzimit - pyetësorit do të shfrytëzohen vetëm për qëllime shkencore. Një pjesë e mjeteve do të sigurohet nga donacionet.

Në botimet që do të dalin nga ky projekt do të përfshihen të dhënat sa më të plota, themelore dhe të përgjithshme për evolucionin sasior dhe cilësor të vendbanimeve dhe të popullsisë, të ekonomive familjare dhe të aspekteve të ndryshme të jetës ekonomike dhe dimensionin funksional të vendbanimeve në përgjithësi në tërë kompleksitetin e tyre.

Përveç të dhënave nga hulumtimet në terren, për tablonë retrospektive historike dhe perspektivën e zhvillimit të vendbanimeve, do të punohet dhe në mbledhjen e të dhënave nga dokumentacioni dhe arkivat, çfarë janë defterët osmanë (regjistrimet kadastrale), relacionet e ndryshme, regjistrimet zyrtare të popullsisë midis

dy luftërave botërore dhe veçanërisht pas Luftës së II Botërore, statistika vitale-demografike (evidencat e zyrave të oficiarisë dhe të bashkësive fetare), planet e zhvillimit të komunave dhe vendbanimeve dhe faktet nga literatura shkencore-profesionale në dispozicion (historike, gjeohapësinore, ekonomike, demografike, gjeopolitike, kulturore etj.).

Arsyetimi i hollësishëm për këtë projekt është dhënë në vitin 2017 kur ka hyrë në programin e punës të Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe të Kuvendit të Akademisë për vitet në vijim.

3. Hasan Prishtina në prizmin e dokumenteve arkivore. –Projekt afatmesëm.

Ky projekt ka hyrë në Programin e Punës së Seksionit për vitin 2017 dhe me atë rast është dhënë arsyetimi i hollësishëm. Deri më tani bartësit e projektit kanë hulumtuar materialet arkivore në Arkivin Shtetëror të Tiranës dhe në Arkivin e Vjenës. Vetëm nga Arkivi i Tiranës janë sjellë rreth 1000 dokumente. Edhe këtë vit do të vazhdojë puna me hulumtimin dhe përzgjedhjen e dokumenteve që bëjnë fjalë për aktivitetin politik, rolin që luajti Hasan Prishtina në kryengritjet antiosmane dhe në përpjekjet për shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë e të konsolidimit të shtetit shqiptar. Këto dokumente paraqesin vlera të një rëndësie të dorës së parë jo vetëm për ndriçimin e të kaluarës së kësaj figure historike por edhe për njohjen më të themeltë të proceseve shoqërore, historike e politike të periudhës 1908-1933. Gjatë këtij viti do të bëhen hulumtime edhe në arkivat tjera të

qendrave diplomatike. Projekti do të jetë pjesë e programit të punës për vitin 2018.

4. Korpus i monumenteve epigrafike antike të Kosovës.

Projekti është afatmesëm. Arsyeimi është dhënë kur ka hyrë në programin ne punës të Seksionit për vitin 2017. Projekti ka dy faza. Faza e parë përfshinë evidentimin, fotografimin dhe vizatimin e materialit epigrafik. Ndërsa në fazën e dytë do të bëhet studimi i detajuar i materialit epigrafik të evidentuar gjatë fazës së parë. Realizimi i këtij korpusi do të vendosë bazat fundamentale, mbi të cilat më pas do të mund të bëhen studime më specifike mbi jetën politike, ekonomike, kulturore e religjioze në Dardani gjatë antikitetit.

TUBIME SHKENCORE

1. Sfidat e arsimit në Kosovë, reformat e domosdoshme në pajtueshmëri me kërkesat e tregut të punës. -Konferencë shkencore ndërkombëtare.

Bartës të aktivitetit: akademik Isa Mustafa dhe anëtare korrespondente Justina Pula.

Hyrje

Kosova është duke ecur shumë ngadalë në përballimin e ndryshimeve të cilat i sjell tranzicioni. Nevojat për ndryshime, edhe në qasje, edhe në praktikë, janë më se të dukshme. Edukimi për nevojat e ekonomisë në të gjitha vendet e regjionit dhe më gjerë tani më ka një përvojë të konsiderueshme. Ndërkaq, në Kosovë kjo praktikë më shumë ka mbetur si përpjekje sesa e arritur reale. Kosova është shtet i ri, i cili sigurisht se do të ballafaqohet me sfida të reja në

fushën e edukimit. E tëra kjo është si rezultat i zhvillimit të ulët ekonomik dhe papunësisë së theksuar. Kosova është një ndër vendet më të varfra të Evropës, me rreth 30 për qind të popullatës që jetojnë në varfëri, ndërkohë që 10 për qind e popullatës jetojnë nën kufirin e varfërisë përkatësisht në varfëri ekstreme dhe ka, afërsisht, shkallën më të lartë të papunësisë në Evropën Juglindore.

Sistemi i edukimit deri tash është treguar jo shumë i aftë që të krijojë burime njerëzore të nevojshme, për të cilat ka kërkesa tregu i punës-biznesi i sotëm. Nëse i referohemi papunësisë, ajo është e theksuar veçmas te grupmoshat e reja (16-24 vjet) dhe sidomos te gjinia femërore. Numri i njerëzve të regjistruar si të papunë (me afat më të gjatë të pritjes) te grup moshat e reja sillet diku më shumë se 250.000 njerëz, që janë kryesisht të pakualifikuar, ose nuk i përgjigjen kërkesave të tregut, ndërkaq është pjesa tjetër me më shumë se 60.000 punëkërkues, të cilët kanë kualifikim ose gjysmë kualifikime, si dhe shkathësitë të cilat i posedojnë për punë të caktuara. Gjithashtu, kemi edhe rreth 20.000 deri në 25.000 njerëz që diplomojnë në sistemin e edukimit para universitar dhe nga të cilët ekonomia mund të absorbojë vetëm 8.000 deri në 10.000 veta. Një nga shkaqet e kësaj papunësi të theksuar, pos nivelit të zhvillimit ekonomik, duhet të jetë edhe ngecja në ofertën dhe praktikën që e jep sistemi i edukimit në Kosovë për nevojat e ekonomisë dhe nevojat e tjera.

Kjo pasqyrë e shkurtër e relacionit

midis edukimit dhe punësimit dhe aftësisë absorbuese të bizneseve, tregon se, megjithatë, sistemi i edukimit nuk prodhon dituri të mjaftueshme për tregun e punës, dituri të cilat u mundësojnë njerëzve që janë në pritje për punë, si dhe atyre të porsa diplomuar, të gjejnë vende pune ose të krijojnë vende të punës për vete dhe për të tjerët. Pra, nuk krijohen dituri të mjaftueshme ndërmarrëse, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në hapjen e vendeve të reja të punës dhe në zvogëlimin e papunësisë, me këtë edhe të varfërisë.

Qëllimet e përgjithshme të konferencës

Qëllimi i kësaj konference të ASHAK është që të nxisë proceset për reformim të nevojshëm të sistemit të edukimit, me qëllim të krijimit të një programi të bashkëpunimit të qëndrueshëm midis universiteteve (publike dhe private) me ndërmarrjet. Kjo konferencë do të ndikojë, ose ka për qëllim gjithashtu të sensibilizojë institucionet e shtetit, universitet dhe ndërmarrjet për ta ngritur bashkëpunimin institucional.

Ky bashkëpunim midis bizneseve dhe universiteteve ka për qëllim të nxisë reformat në sistemin e edukimit, duke ngritur aftësitë dhe shkathtësitë kryerëse të të porsa diplomuarve, si dhe për të përmirësuar mësimdhënien dhe metodat e të mësuarit.

Gjithashtu, konferenca ka qëllim të krijojë një bazë dhe një praktikë të mirë të bashkëpunimit në procesin e identifikimit dhe kuptimit më të mirë të nevojave të kompanive-tregut. Kjo nënkupton pjesëmarrjen dhe

kontributin aktiv të bizneseve në përmirësimin e kurikulave të institucioneve arsimore, sipas kërkesave të tregut të punës.

Shumë studentë sot i kanë mundësitë e kufizuara për trajnime (stërviqe dhe aplikim të dijes teorike në praktikë) dhe për forcim të diturive në praktikë. Kjo në të vërtetë paraqet një pasiguri për karrierën dhe të ardhmen e tyre, për shkak se procesi i edukimit të tyre nuk është i lidhur me përvojat në biznese. Kjo konferencë duhet të zërthejë nevojën e hapjes së universiteteve për një bashkëpunim më të ngushtë me biznese. Pra, të krijohet sistemi i edukimit të gjeneratave të reja nëpërmjet Edukimit & Biznesit. Në këtë rrafsh, universitetet duhet të marrin orientim sipas principeve-kërkesave të biznesit dhe kështu të gjitha universitetet në Kosovë (private dhe publike) ta zhvillojnë logjikën dhe praktikën e “universiteteve ndërmarrëse”.

Qëllimi i konferencës është që të ngritët vetëdija se mungesa, dobësia e edukimit, ka ndikim dramatik negativ për fëmijët dhe të ardhmen e tyre. Gjendja në të cilën shteti nuk mund të ofrojë zhvillimin e aftësive, shkathtësive dhe diturisë të gjeneratave, do të thotë se është gjendje e pamundësisë që gjeneratat e reja, të cilat janë në proces të edukimit, të shfrytëzohen në mënyrë efektive. Pra, duhet thënë se përkushtimi i zgjidhjes së problemeve në sektorin e edukimit në Kosovë, si një vend më i pazhvilluar në rajon, është parakusht jashtëzakonisht i rëndësishëm për ekonominë. Prandaj, edhe ASHAK do t'i

kushtojë kujdes këtij problemi të ndjeshëm për shoqërinë dhe shtetin e Kosovës.

Qëllimet specifike të konferencës

Qëllimet specifike të kësaj konference janë të përmbledhura në këto fusha:

- Vendosja e lidhjeve universitet-biznese në baza formale, duke krijuar mundësinë e pjesëmarrjes së bizneseve në mënyrë aktive në ndërtimin e kurikulave, pjesëmarrja në komisione të ndryshme të fakulteteve, aty ku krijohet bërthama e asaj që u ofrohet studentëve.

- Të kontribuojë në përmirësimin e mësimdhënies dhe metodave të nxënies së mësimi, duke zhvilluar dhe duke përdorur raste studimore nga praktikrat më të mira të bizneseve vendore dhe ndërkombëtare.

- Të kontribuojë në aftësimin e profesorëve, menaxherëve të bizneseve, që t'i identifikojnë nevojat e fakulteteve dhe të bizneseve për aftësi dhe dituri të cilat i kërkon tregu i punës.

- Të kontribuojë në identifikimin e praktikave më të mira të krijimit të mundësive për universitete dhe për biznese, për zhvillimin plotësues (trajtime, workshope, seminare) dhe forma të ndryshme për ngritje të kapaciteteve të njerëzve të papunë, të cilët janë në shekullin e punës, pra të kontribuojë në sensibilizimin e nevojës për orientimin e universiteteve kah ndërmarrësia.

- Të sensibilizohet nevoja për ngritjen e llogaridhënies për menaxhim dhe cilësi të sistemit të edukimit në Kosovë, qoftë institucion publik, qoftë institucion privat.

- Të sensibilizohen institucionet e

shtetit për nevojën që arsimi të shpallet prioritet i shtetit.

Në këto objektiva specifike do të shtrohen materialet dhe prezantimet e kësaj konference të ASHAK-ut.

Temat për trajtim:

I. Reforma në sistemin e arsimit për t'iu përshtatur kërkesave të tregut të punës.

II. Format e reja të financimit të sistemit të edukimit në Kosovë, me theks të posaçëm financimi i sistemit të arsimit të lartë duke promovuar punën shkencore hulumtuese.

Në Konferencën një ditore parashihet të marrin pjesë me kumtesa rreth 30 pjesëmarrës, prej tyre 4 ndërkombëtar dhe 4 regional. Për pjesëmarrësit ndërkombëtar dhe regional do të mbulohen shpenzimet e akomodimit dhe të qëndrimit për 2-3 ditë.

2. Teatri si temë e mendimit filozofik-Raportet midis teatrit bashkëkohor dhe teatrit modern evropian -Konferencë shkencore ndërkombëtare.

Bartës i aktivitetit: anëtar korrespondent Muhamedin Kullashi.

Qëllimi i kësaj konference është të merren në shqyrtim disa aspekte të problemeve që kanë të bëjnë me teatrin e sotëm evropian, duke marrë parasysh debatet që janë zhvilluar e po zhvillohen brenda rrymave të mendimit kritik për teatrin. Këto debate kanë të bëjnë me transformimet e thella që ka përjetuar akti i krijimit teator në epokën bashkëkohore përkatësisht teksti teator, raportet midis aktorit dhe personazheve të veprës teatore si dhe ato të mizanskenës. Kësisoj brenda njëres nga këto rryma (e përfaqësuar

nga Peter Szondi, Adorno, Bakhtin, Lehman etj.) forma e dramës dhe shfaqja teatrore kanë pësuar ndryshime të tilla në kohën moderne(fundi i shekullit të XIX), në veprat e Ibseni-it, Stindberg-ut, Cehovit e sidomos Pirandelos, fjala vjen) sa mund të flitet për fundin e dramës në periudhën bashkëkohore me veprat e Becket-it, Ionesco-s e Meyerholdit. Ky fund shpjegohet me « tretjen » e fabulës, me dekonstruktimin e ngjarjes e aksionit, me zhbërjen e kuptimit të tyre.

Ndryshe nga kjo rrymë, një tjetër qasje, sa i takon raporteve midis teatrit bashkëkohor dhe atij modern, zhvillon interpretime të tjera, fjala vjen, të dramës. Kështu Jean-Pierre Sarrazac, elaboron teorinë për dramën moderne në veprën Poetika e dramës moderne (2012), duke cekur se kjo paraqet një situatë komplekse e jo një histori lineare ku ngjarjet lidhen sipas një kauzaliteti racional. Sarrazac dhe disa autor të tjerë do ta vejnë theksin te diversiteti i konfigurimeve brenda tekstit teatror, procedime të tjera nga ato që janë zhvilluar në tekstet e klasicizmit (me Shkespeare, Corneille, Racine, Molière a Diderot), procedime që do të nxisin paradigma të tjera estetike, fjala vjen në dramën moderne e të tjera në atë bashkëkohore. Në vend të një konceptioni për artin teatror bashkëkohor, ku koha e sotme shihet si shkëputje e plotë sa nga teatri tradicional aq edhe nga mundësitë e reja të teatrit bashkëkohor. Për këtë rrymë, në shekullin e XX, me Craig dhe Artaud, fjala vjen, teatri çlirohet nga forma e tij kanonike, merr fund raporti

i subordinimit të mizanskenës ndaj pjesëve të tjera përbërëse të poemës dramatike, nisë koha e lidhjeve të reja midis tekstit dhe skenës. Sipas përfaqësuesve të kësaj rryme, konceptioni unitar i teatrit, qoftë kur mbështetet te teksti apo te organizimi i skenës, ia lë vendin gradualisht një « polifonie apo madje një gare midis arteve të përafërta (përdorimi i muzikës apo i videove në teatër, fjala vjen) » që ndikon në paraqitjen e formave të tjera të veprës teatrore. Kësisoj shfaqja teatrore del si « lojë midis praktikave që nuk mund të reduktohen njëra te tjetra e megjithatë dalin të bashkëlidhura ndonëse shfaqet edhe përplasje midis tyre. Bernard Dort në veprën « Shikuesi në dialog » (1995) zhvillon interpretimin se shikuesi është gjyqtar dhe qëllim i pjesës teatrore. Në fakt, fjala teatër, etimologjikisht do të thotë « vend nga i cili shikohet », ngase folja greke theaomai të shikosh të sodisësh. Brenda etimologjisë së fjalës është ruajtur lidhja midis filozofisë dhe teatrit.

Në dallim nga rryma e cila zhvillon teorinë për fundin e dramës ose për kohën « post-dramatike », rryma tjetër orvatet të vejë në pah në ç 'mënyrë transformimet që u shfaqën në kapërcyell të shekullit të XX, në veprat e Strindberg e Pirandelo) - si fjala vjen fragmentimi i fabulës, dekonstruktimi i dialogut dhe personazhit – vazhdojnë të veprojnë te disa krijues teatror të sotëm (Fosse, Koltès etj.).

Ndryshe nga paradigma e Peter Szondi, për «dramën brenda jetës», Sarrazac zhvillon teorinë për paradigmën në krijimtarinë teatrore e emërtuar si «

dramë e jetës ». Drama brenda jetës ka të bëjë me një formë dramatike e cila mbështet te kalimi nga lumturia te fatkeqësia apo anasjelltas, me një përplasje dramatike midis personazheve që ka « një fillim, mjedis dhe mbarim », pra një zhvillim njëherësh «organik, kronologjik dhe logjik, të aksionit, të asaj që të moçmit e quanin «muthos». Ndërkaq, paradigma tjetër e dramës së jetës, nuk kufizohet te ajo që Sofokli quante një «ditë fatale», ngase i ikën unitetit të kohës, vendit e madje edhe të aksionit. Kjo paradigmë përsiatë për dramën që kapërthen të tërë jetën, ndriçon rolin që ka retrospekcioni në shpjegimin e një situate e merr parasysh edhe procedime të tjera në ndërtimin e shfaqjes teatrale.

Ndryshe nga Adorno, i cili mendonte se drama sot është e pafuqishme në shpjegimin e «fuqive anonime që qeverisin botën», Viktor Klotz në veprën *Forma e mbyllur dhe forma e hapur brenda teatrit evropian* (2005), duke vënë në pah se ajo që është dramatike në teatrin modern shfaqet kryesisht përmes skenave agonistike midis personazheve, te disa autorë bashkëkohor, përfshirë edhe ata të teatrit të absurdit, dramatikja merr trajta të tjera. Sarrazac, ndërkaq, mendon se dramatikja në veprat bashkëkohore ka të bëjë me një «ngjarje specifike e primordiale: me ndeshjen katastrofike me tjetrin - qoftë kjo edhe me tjetrin brenda vetes».

Disa nga këto çështjet që trajtohen në debatet e sotme për teatrin mund të jenë temë e konferencës

I. Në këtë konferencë njëditore do të

mund të ftoheshin studiues nga vendi, rajoni (Tirana e Zagrebi, bie fjala) dhe nga disa qendra tjera (Parisi e Berlini).

II. Buxheti për konferencë : shpenzimet e akomodimi dhe të qëndrimit për dy ditë për katër pjesëmarrës.

3. Pavarësia e Kosovës dhe sfidat e shtet ndërtimit.-Simpozium shkencor ndërkombëtar.

Bartës të aktivitetit: akademik Jusuf Bajraktari dhe anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj.

Viti 2018 është vit jubilar përkatësisht 10-vjetori i Pavarësisë së Kosovës dhe fillimi i njohjes ndërkombëtare të saj. Me këtë rast parashihet që në muajin shkurt të vitit 2018 të organizohet Simpoziumi shkencor ndërkombëtar me temën e sipërpërmendur. Në këtë aktivitet shkencor do të trajtohen tema nga aspekte të ndryshme dhe nga këndvështrimi historik, juridik, politik, ekonomik e social për periudhën 10-vjeçare për Kosovën. Simpoziumi do t'i kontribuojë ndriçimit të çështjeve me rëndësi themelore për këtë jubile.

Simpoziumi parashihet të jetë njëditor. Në të do të marrin pjesë rreth 20 studiues shqiptarë dhe të huaj. Rreth 8 studiues-ekspert të njohur ndërkombëtarë pritet që me kumtesat e tyre të ndriçojnë aspekte të ndryshme të themelimit, të forcimit dhe të zhvillimit të Republikës së Kosovës. Për studiuesit e huaj duhet të sigurohet akomodimi dhe qëndrimi dy ditor në Prishtinë.

Disa nga emrat e studiuesve ndërkombëtarë duhen të jenë:

Sir Michael Wood, KCMG, anëtar i Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të drejtën ndërkombëtare.

Harold Hongju Koh, Sterling, Profesor i të drejtës ndërkombëtare në Yale Law School.

Mark Weller, Kryesues i studimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës kushtetuese ndërkombëtare në University of Cambridge.

Paul Williams, Këshilltar i Delegacionit të Kosovës në Konferencën e Rambujesë.

Pas miratimit të Programit në Kuvend të ASHAK-ut do të ngrihet Këshilli Organizues, i cili do të merret detajisht me përgatitjen e tezave të mundshme që do të jenë objekt i trajtimit në simpozium; për caktimin e agjendës detale; listën e autorëve të propozuar për të kontribuar në këtë eveniment.

Simpoziumi do të zhvillojë punimet në: Paneli I – Rugëtimi historik i Kosovës (1912-2008); Paneli II – Qeverisja: Të arritura dhe pengesat; dhe Paneli III – Resurset dhe strategjitë e zhvillimit.

BOTIME

1. Ekrem Murtezai.- Filozofia e lashtë greke dhe romake.

Dorëshkrimi në fjalë përbëhet nga afro 30 tabakë autori dhe do të jetë i vetmi i këtij lloji në trevën e Kosovës. Dorëshkrimi mbështetet në literaturën në gjuhën gjermane, angleze, ruse, kroate dhe serbe. Përmbajtja e dorëshkrimit përfshin një hyrje të shkurtër në filozofi, mitologji, shkenca të veçanta, dhe "Shtatë të urtit grek". Pastaj, pason filozofia greke nga miletasit Talesi, Anaksimandri, dhe Anaksimeni, më pas Pitagora dhe pitagorianët (Filolai, Arhita etj), si dhe çështja e lidhjes pitagoriane. Vend të veçantë zënë shkolla e Elesë dhe

filozofia e përfaqësuesve të saj: Ksenofoni, Parmenidi, Zenoni dhe Melisi.

Një kaptinë e veçantë ka të bëjë me Heraklitin, me materializmin dhe dialektikën abstrakte të tij. Në dorëshkrim bëhet fjalë edhe për Epedoklen dhe Anaksagoren, si dhe për atomistët Leukipi dhe Demokriti. Pas këtyre filozofëve dhe çështjeve filozofike bëhet fjalë për Sokratin dhe shkollat sokratike; Platoni, dhe platonistët. Aristoteli zë një vend qendror në dorëshkrim. Bëhet fjalë edhe për Akademinë dhe akademistët, si dhe për Liceun e Aristotelit dhe nxënësit e tij, për materializmin e Epikurit dhe ithtarëve të tij. Në pjesën mbi helenizmin bëhet fjalë gjerësisht për skepticizmin dhe përfaqësuesit e tij.

Në pjesën e fundit të dorëshkrimit bëhet fjalë për filozofinë e lashtë romake - dhe përfaqësuesit e saj: Lukreci, Seneka dhe Mark Antoni. Dorëshkrimi mbërrin deri te Shën Augustini në shekullin V të epokës së re.

2. Leksikon i vendbanimeve të Kosovës-Qendrat urbane.- Vëllimi I. Grup autorësh.

Në literaturën shkencore dhe profesionale në Kosovë deri në ditët tona ka munguar një botim kompleks i natyrës enciklopedike-shkencore për qytetet e Kosovës. Nga projekti afatmesëm "Vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës - Tabloja fizike-hapësinore, demografike dhe funksionale" do të del vëllimi i parë i botimit të leksikonit për qendrat urbane të Kosovës. Puna është

përqendruar kryesisht të mbledhja e të dhënave dhe trajtimi i metropolit republikan industrialo-urban, Prishtina (elementet fizike, rrjedhat historike, gjendja aktuale: evolucioni popullativ dhe komponentët bazë demografike (rrita përmes imigrimit intensiv e të pakontrolluar), funksionet sekondarë, terciare dhe kuartare; ndërtimi “i egër”); të gjashtë qendrat mezo-regionale dhe dimensionin fizionomik dhe funksional të tyre (Prizreni, Peja, Gjakova, Mitrovica, Ferizaj, Gjiłani (urbanizimi primar dhe sekondar); si dhe të urbanitetit e vogla: vendbanimet e urbanizuara dhe suburbane (selitë komunale dhe vendbanimet pranë qytetësë si “dormitorij” për popullsinë e punësuar; pasojat e luftës së fundit).

Në këtë vëllim do të përfshihen të dhënat sa më të plota, themelore dhe të përgjithshme, për evolucionin sasior dhe cilësor të vendbanimeve dhe të popullsisë urbane, të ekonomive familjare dhe të aspekteve të ndryshme të jetës ekonomike, si dhe dimensionin fizik, fizionomik, demografik dhe funksional të qendrave urbane në përgjithësi në tërë kompleksitetin e tyre, duke ndjekur një qasje dhe metodologji bashkëkohore profesionale-shkencore.

Të dhënat për qendrat urbane do të mbledhen nga burime të ndryshme (hulumtimet në terren, dokumentacioni dhe arkivat, regjistrimet kadastrale osmane, relacionet e ndryshme, regjistrimet zyrtare të popullsisë, statistika vitale-demografike, planet e zhvillimit të komunave dhe vendbanimeve urbane dhe faktet nga literatura shkencore-

profesionale në dispozicion etj.) studimi i të cilave do të mundësojë pasqyrimin e këtyre dimensioneve:

I. Dimensionin fizik: (pozita gjeografike, shtrirja zonale dhe hipsometrike, format morfologjike, rrethanat hidrologjike e klimatike dhe resurset e tjera natyrore etj.).

II. Dimensionin popullativ: (komponentët vitalo-demografikë - nataliteti, mortaliteti, shtimi natyror; martesat); të dhënat për strukturat e popullsisë (sipas moshës, gjinisë, përkatësisë etnike, fetare, gjuhësore, përbërjes arsimore, socioekonomike, për strukturën e ekonomive familjare); të dhënat për migrimet (emigrimi, imigrimi, saldoja migruese; drejtimet e migrimeve, koha, shkaqet, pasojat, niveli i shkollimit dhe i punësimit, adaptimi dhe integrimi i migrantëve të jashtëm, lidhja me familjen dhe vendlindjen, remitancat etj.).

III. Dimensionin funksional (Sektori i veprimtarive prodhuese - primare dhe sekondare) dhe i veprimtarive joprodhuese ose i funksioneve jobazike (terciare-shërbyese dhe kuartare, çfarë janë administrata publike, arsimit, shëndetësia, komunalet, institucionet kulturore dhe politike, gjykatat, policia, shërbimet sociale e afariste dhe funksionet e tjera të infrastrukturës shoqërore dhe publike).

IV. Gjendja në rrafshin e banimit (fondi i banesave, ndërtimi sipas vitit, ndërtimet pa leje, materiali i ndërtimit, instalimet, pajimet bashkëkohore për amvisni, aparatet, ujësjellësi, hidroforët, orënditë etj.).

Realizimi i botimit do të plotësojë mungesën e informatave dhe

njohurive sistematike për karakteristikat gjeohapësinore, veçoritë sociale, demografike dhe funksionale të qyteteve. Në përgatitjen e botimit tashmë janë angazhuar një numër i madh i bashkëpunëtorëve. Të dhënat janë duke u mbledhur për qendrat e mëdha regjionale, që i përkasin kategorisë më të lartë funksionale, dhe për selitë komunale si bërthama urbane e të urbanizuara. Mbi bazë të tyre do të përpilohet botimi mbi krijimin, dinamikën e jetës dhe të rrjedhave zhvillimore të vendbanimeve urbane të Kosovës, e kaluara dhe e tashmja e tyre, sikundër janë struktura e popullimit nga etapa themelore, rrjedhat imigruese të pakontrolluara, duke u krijuar një shpërpjesëtim i madh midis rritjes demografike dhe dimensionit funksional, çfarë janë kapacitetet e përgjithshme kualitative të qytetit –punësimi, infrastruktura përkatëse funksionale, fondi i bane-save, hapësira shkollore, shërbimet shëndetësore dhe institucionet e tjera, pastaj rritja e dukurive negative, siç janë imigrimi masiv i pakontrolluar, ndërtimi i “egër” dhe uzurpimet, degradimi i mjedisit, “terrori urban” dhe lëndimi i rëndë i kulturës urbane, veçanërisht në Prishtinë dhe gjashtë qendrat mezorajonale.

Me daljen në dritë të këtij botimi do të pasurohet fondi i të dhënave për gjeoshkencat, dijet sociale, pushtetin lokal dhe opinionin profesional e të gjerë etj., pastaj do të krijohet databaza e të dhënave shkencore që do të shërbejë për hulumtimet e mëvonshme, të hollësishme të vendbanimeve urbane, për tipet,

funksionet, sistemin, rrjetin, zgjerimin hapësinor-fizik dhe rritën demografike të tyre etj., sikundër dhe për qëllime aplikative drejtpërdrejtë apo të tërthortë: për planifikimin hapësinor, urbanistik dhe shoqëror, pastaj për motivet dhe potencialet turistike, për statistikën dhe administratën, për shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore dhe humane, si dhe shpërndarjen më të harmonizuar të objekteve të infrastrukturës shoqërore dhe publike etj., në veçanti për ndërmarrjen e masave për parandalimin e rrjedhave të pavolitshme sociale, demografike, arkitektonike, infrastrukturore në aglomerimet urbane etj.

Pjesa tekstuale e botimit të plotë të natyrës enciklopedike-shkencore për qendrat urbane dhe të urbanizuara do të plotësohet me material ilustrues, çfarë janë hartat tematike, fotografitë, planet dhe skicat e ndryshme të cilat i japin karakter më përmbajtjesor dhe e bëjnë më të kuptueshme materien e trajtuar brenda publikimit. Botimi i tillë si vepër kolektive do të jetë pa dyshim një trashëgimi e madhe për shkencën dhe kulturën tonë.

Botimi do të ketë rreth 30 tabakë shtypi. Një pjesë e mjeteve do të sigurohet nga donacionet e ligjshme.

3. Gjyljeta Mushkolaj, Dizajni kushtetues i qeverisjes lokale, e drejta e komunave në liri të asociimit dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendim-marrje.

Në çdo vend, qeverisja ka natyrë juridike të veçantë, që varet nga rrethanat politike, struktura e vendit, zhvillimi historik dhe kombëtar,

rrethanat gjeografike, si dhe nga parimet që dominojnë në shoqëri, e që janë të përcaktuara nga ai që ka kontroll mbi pushtetin.

Kosova, gjithashtu i ka veçoritë e saj, që ndikojnë të ketë sistem të veçantë juridik dhe strukturë unike të organizimit. Megjithatë, është një karakteristikë tjetër që e bën Kosovën më të veçantë, e kjo është rruga drejt shpalljes së pavarësisë, procesi i kushtetutë-bërjes dhe shtet-ndërtimit, ku dizajni kushtetues i vetëqeverisjes lokale ishte dhe vazhdon të jetë i rëndësishëm qendror.

Reforma e pushtetit lokal, në tridhjetë vitet e fundit është bërë një ndër shtyllat kryesore të zhvillimit demokratik në mbarë botën. Kjo, është gjithashtu një kusht i rëndësishëm që e parashikojnë organizatat më të fuqishme ndërqeveritare për t'i pranuar shtetet në gjirin e vet dhe për tu njohur atyre të drejtën që të përfitojnë nga ky anëtarësim. Në dhjetë vitet e fundit, kjo është bërë sidomos kërkesë e fuqishme e Unionit Evropian dhe e Këshillit të Evropës, kërkesë kjo që është shndërruar në një presion të vërtetë për ndryshime të thella kushtetuese dhe ligjore, forcim të pluralizmit partiak, zhvillim të së drejtës së qytetarëve në organizim kolektiv dhe inkurajim të grupeve efektive të interesit publik. Ndryshimet e këtyra, kanë për qëllim që t'u japin qytetarëve dhe përfaqësuesve të tyre të zgjedhur, më shumë pushtet në marrjen e vendimeve të rëndësishme për jetën e tyre. Kjo gjë është e lidhur me politikën pluraliste dhe pushtetin përfaqësues, por gjithashtu e mbështetë demokratizimin duke u

dhënë qytetarëve më shumë influencë në formulimin dhe në implementimin e politikave. Përkrahësit e reformave të këtyra besojnë se vendimet e marra me pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve u mundësojnë qytetarëve që të jenë më mirë të informuar, dhe se vendimet e këtyra më shumë do t'i kënaqin interesat e grupeve më të ndryshme të shoqërisë, krahasuar me vendimet e marra vetëm nga pushteti qendror. Koncepti i fuqizimit të pushteteve lokale, nënkupton se seleksionimi i përfaqësuesve nga juridiksionet më të vogla lokale u bën të mundur zyrtarëve të zgjedhur që më mirë t'i njohin nevojat dhe dëshirat e votuesve të tyre.

Duke i marrë parasysh argumentet e shtruar më lartë, si dhe duke u nisur nga fakti, se struktura e sistemit të qeverisjes në Kosovë në kohë të fundit është bërë objekt i shqyrtimeve, diskutimeve dhe studimeve të institucioneve të shumta, madje ishte edhe kusht dhe element themelor për zgjidhje të statusit të Kosovës dhe ndërtimit të sistemit të ri kushtetues, me këtë publikim, do të bëjmë përpjekje që të japim kontributin tonë akademik, në identifikimin e parametrave që do të na japin mundësi që të bëjmë vlerësimin e modalitetit të përzgjedhur nëpërmjet të procesit negociator të reformës së pushtetit lokal në Kosovë. Këtë qëllim do të përpiqemi ta arrijmë nëpërmjet të studimit të marrëdhënies midis pushtetit qendror dhe pushtetit lokal, si dhe të rëndësishës së pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje në mënyrë krahasimtare.

Është me rëndësi të theksohet qartë, se me këtë publikim nuk pretendohet që të

bëhet vlerësimi i vet modalitetit të përzgjedhur në procesin negociator për statusin final të Kosovës, pjesë qenësore e të cilit është i ashtuquajtur proces i decentralizimit, me të cilin, në fakt janë duke u ndërtuar raportet midis nivelit qendror dhe lokal të pushtetit shtetëror në Kosovë. Kjo për arsye se siç do të analizohet në këtë punim, është e pamundur të bëjmë ndonjë vlerësim me themel vetëm duke i analizuar tekstet kushtetuese dhe ligjore, por edhe të dokumenteve të miratuara nga procesi i bisedimeve midis Kosovës dhe Serbisë lidhur me themelimin e Asociacionit të Komunave të populluara me shumicë serbe në Kosovë. Marrëdhëniet, midis niveleve të pushtetit shtetëror, respektivisht të pushtetit qendror dhe lokal janë marrëdhënie dinamike, e jo statike. Gjithashtu, nocionet që zënë vend në tekstet e dokumenteve që e përcaktojnë statusin e Kosovës, si nocioni “shtet unitar”, ose termi “partneritet i komunave”, e “lidhje horizontale”, nuk janë nocione që vetvetiu e përcaktojnë marrëdhënien e vërtetë midis “pushtetit qendror” dhe “pushtetit lokal”. Ekzistojnë një varg parametrash të tjerë, si kushtetues dhe “krah-as-kushtetues” që ndikojnë në ato marrëdhënie. Gjithashtu, vetëm tekstet e dokumenteve si kushtetuese, por edhe ligjore nuk janë vendimtare. Marrëdhëniet midis pushtetit qendror dhe atij lokal, janë marrëdhënie shumë dinamike që pandërprerë e zhvillojnë dhe ka mundësi që edhe ta ndryshojnë formën e pushtetit shtetëror në Kosovë. Nga arsyet që u theksuan, me këtë punim, nëpërmjet të studimit dhe

analizës së sistemeve të pushtetit shtetëror që sot ekzistojnë në botë, do të mundohemi që të japim kontributin tonë në hapjen e shtigjeve të reja për analizimin e marrëdhënieve midis pushtetit qendror dhe lokal, gjë e cila do të na jep mundësi që të analizojmë edhe situatën tonë të ardhshme. Kjo, jo vetëm për arsye se, siç u theksua, nuk mund të bëhet vetëm me studimin statik të dokumenteve, por edhe sikur kjo gjë të ishte e mundur, punimi është përmbyll në periudhën kur procesi për themelimin e asociacionit të komunave të populluara me shumicë etnike serbe është në zhvillim e sipër.

I gjithë punimi do të shtrihet në themelet intelektuale të literaturës që e zhvillon konceptin e përfitimit të pjesëmarrjes së publikut në vendim-marrje, e që i ka rrënjët në literaturën e demokracisë “deliberative”. Demokracia deliberative shfaqet në fillim të viteve 1990 si një sfidë ndaj modeleve liberale të vendosura që e konsideronin politikën si një bashkim preferencash të përcaktuara kryesisht në një fushë private (J. Cohen, 1989).

4. Revista “Studime shoqërore”, nr. 5.- Revistë vjetore që do të botohet gjatë vitit 2018. Në të do të botohen studime dhe artikuj shkencorë, tekste ligjëratash inauguruese, vështrime, recensione e kritika, etj. nga disiplinat e shkencave shoqërore.

Sekretari i Seksionit
Akademik Jusuf Bajraktari, d.v.

III. SEKSIONI I SHKENCAVE TË

NATYRËS

PROJEKTE

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës. – Nga perspektiva kur po hartohet ky Program i punës për vitin 2018 dhe nga rezultatet e zhvillimeve të deritashme, mund të konsiderohet se projekti i Fjalori Enciklopedik i Kosovës, i përbashkët i të gjithë seksioneve të ASHAK-ut, do të jetë finalizuar dhe do të ketë dalë nga shtypi para përfundimit të vitit 2017. Gjatë 2018-ës mund të parashihen programe promovuese, kontakte me lexues dhe institucione apo aktivitete të tjera të ngjashme. Njëkohësisht do të fillojë funksionalizimi i një redaksie e cila do të mbajë vazhdimësinë e plotësimit të zërave të Fjalorit.

TUBIME SHKENCORE

2. Materialet kompozite.- Tryezë shkencore. Bartës i aktivitetit anëtar korrespondent Fetah Podvorica.

Seksioni i Shkencave të Natyrës për vitin 2018 propozon mbajtjen e një tryeze shkencore me titull “Materialet Kompozite”.

Materialet kompozite kanë veti fiziko-kimike më të mira se komponentet përbërëse. Ato kanë fortësi më të madhe, peshë specifike më të vogël, përçueshmëri elektrike dhe termike më të mirë, rezistencë më të madhe ndaj faktorëve të jashtëm në mjedis etj. Në këtë kuadër bëjnë pjesë: qelqi, fibrat si dhe nanotubat e karbonit, grafeni, metalet, qeramika, polimerët, etj. Materialet kompozite përdoren në shumë degë të industrisë si: nanoteknologji, mikroelettronikë,

ndërtimtari, biomjekësi, aeronautikë, transport detar, përgatitje të veshmbathjeve, të membranave, etj.

Qëllimi i tryezës shkencore, e cila propozohet të mbahet në muajin prill të vitit 2018, është vërja në pah e rëndësisë shumë të madhe të përdorimit të materialeve kompozite në jetën e përditshme si dhe nxitja e bashkëpunimit, me qëllim të këmbimit të përvojave të ekspertëve të këtyre lëmenjve lidhur me prodhimin dhe përdorimin e këtyre materialeve.

Në këtë tryezë shkencore do të diskutohet, ndër të tjera, për: llojet e ndryshme të materialeve kompozite, struktura dhe vetitë e tyre; përfitimi i materialeve kompozite; zbatimi i tyre në degë të ndryshme të teknologjisë dhe industrisë.; ndikimi i materialeve kompozite në mjedis, riciklimi i tyre etj. Në tryezën një ditore parashihet të marrin pjesë me kumtesa rreth 20 pjesëmarrës, prej tyre 5 nga jashtë Kosova. Për pjesëmarrësit nga jashtë do të mbulohen shpenzimet e akomodimit dhe të qëndrimit për 2 ditë.

BOTIME

1.Fejzullah Krasniqi dhe Rexhep Selimaj, Komforti termik.

Qëllimi i hartimit të kësaj vepre është analiza e detajuar e komfortit termik të njeriut për parametrat klimatik të ajrit të jashtëm në Republikën e Kosovës. Komforti termik ka rol të rëndësishëm për mirëqenien dhe shëndetin e njeriut. Roli i tij në industri është për shtimin e jetëgjatësisë së prodhimeve. Krijimi i kushteve të komfortit termik është i rëndësishëm për ambiente si:

zyra, dyqane, supermarkete, teatër, kinema, salla mbledhjesh, salla filmi, objekte banesore, shkolla, spitale, në industrinë e tekstilit, industrinë e duhanit, të letrës, në shtypshkronja, muze, etj. Kushtet e komfortit termik arrihen me aplikimin e sistemeve adekuatë të ngrohjes dhe të klimatizimit të ajrit.

Parimet e komfortit termik nxjerrin disa kërkesa ndaj ajrit të lagësht i cili paraprakisht për këtë qëllim edhe duhet të përpunohet. Kështu, do të analizohen parametrat kryesor të komfortit termik, siç janë: temperatura, lagështia, shpejtësia e rrymimit të ajrit, temperatura në sipërfaqe të brendshme të mureve rrethuese, etj. Meqë parametrat e komfortit termik varen edhe nga konstruksioni ndërtimor i ndërtesës, krahas me analizën e parametrave të ajrit të jashtëm del edhe nevoja e analizës së konstruksioneve rrethuese të ndërtesës.

Nëpërmjet të bilancit energjetik të këmbimi i nxehtësisë ndërmjet trupit të njeriut dhe rrethinës do përcaktohet domeni i mirëqenies termike në varësi të aktivitetit, veshjes, temperaturës së ajrit të ambientit, etj.

Komforti termik do të analizohet bazuar edhe në standardet ndërkombëtare për këtë fushë. Kjo vepër mendohet të përmbledhet në rreth 450 faqe.

2. Revista "Resarch-Kërkime" nr. 24. Aktualisht është në proces përgatitja e numrit 23 në vitin 2017 të kësaj reviste, përkatësisht Redaksia është në pritje të prurjeve të reja që deri më tani janë të pakta. Kjo revistë tani ka Redaksi të re

në të cilën është përfshirë edhe një anëtar i jashtëm nga Kanadaja ndërsa numri 24 i saj mendohet të botohet kah fundi i vitit 2018. Punimet në revistën "Resarch-Kërkime" do të botohen në gjuhën angleze me një rezymë në gjuhën shqipe. Në këtë revistë botohen punimet origjinale shkencore të cilat i përkasin Seksionit të Shkencave të Natyrës.

Sekretari i Seksionit

Akademik Fejzullah Krasniqi, d.v.

IV. SEKSIONI I ARTEVE

PROJEKTE

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës. Nga perspektiva kur po hartohet ky Program i punës për vitin 2018 dhe nga rezultatet e zhvillimeve të deritashme, mund të konsiderohet se projekti i Fjalori Enciklopedik i Kosovës, i përbashkët i të gjithë seksioneve të ASHAK-ut, do të jetë finalizuar dhe do të ketë dalë nga shtypi para përfundimit të vitit 2017. Gjatë 2018-ës mund të parashihen programe promovuese, kontakte me lexues dhe institucione apo aktivitete të tjera të ngjashme. Njëkohësisht do të fillojë funksionalizimi i një redaksie e cila do të mbajë vazhdimësinë e plotësisht të zërave të Fjalorit.

AKTIVITETE SHKENCORE DHE

ARTISTIKE

1. Tryezë shkencore dhe ekspozitë personale e akademik Muslim Mulliqi. Tryeza shkencore dhe ekspozita parashihet të organizohet brenda një dite. Në orët e paradites do të mbahet tryeza dhe në mbrëmje do të hapet

ekspozita. Në këtë aktivitet një ditor parashihet të marrin pjesë me kumtesa rreth pesë studiues të artit të cilët do të flasin për jetën dhe krijimtarinë e tij. Tre pjesëmarrës mund të jenë nga jashtë vendi dhe për ta duhet të sigurohet akomodimi dhe qëndrimi për dy ditë.

Në Ekspozitë do të përfshihen rreth 30 punime të fazave të ndryshme të krijimtarisë së akademik Mulliqit. Kurator i Ekspozitës propozohet Gëzim Qëndro.

Për Ekspozitën do të përgatitet katalogu si parapërgatitje për fillimin e hartimit të botimit Muslim Mulliqi-monografi.

2.Ekspozita personale e akademik Tahir Emra, me rastin e 80-vjetorit të lindjes. Ekspozita do të organizohet me rastin e 80-vjetorit të lindjes së akademik Emrës. Në të do të përfshihen rreth 60 punime të cikleve të ndryshme të krijimtarisë së autorit. Për ekspozitën do të përgatitet edhe botimi i katalogut. Kurator i Ekspozitës propozohet Kujtim Buza.

3.Ekspozitë e përbashkët e artistëve akademikë në Vjenë. Në të do të përfshihen nga pesë vepra të piktorëve dhe skulptorëve të Akademisë. Parashihet që në Vjenë të marrin pjesë tre anëtarë të Seksionit. Për ekspozitën do të përgatitet edhe botimi i katalogut. Për shkak të kostos financiare për ekspozitën në fjalë do të kërkohen mjete nga donacionet.

pjesëmarrës, prej tyre rreth 6 nga Shqipëria, për të cilët duhet të sigurohet akomodimi dhe qëndrimi për dy ditë.

Sekretari i Seksionit

Anëtar korrespondent Luan Mulliqi, d.v.

KONCERTE

1.Koncert për piano i akademik Rauf Dhomit me veprat, duke filluar nga sonata, scherco, fugar, aria, etj. Parashihet të marrin pjesë rreth 15

**PROCESVERBALET E KUVENDIT TË AKADEMISË SË
SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS**



PROCESVERBAL

Nga mbledhja XCI e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 16 mars 2017, ora 11:00, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Ali Aliu, Anton K. Berishaj, Ekrem Murtezai, Eqrem Basha, Feriz Krasniqi, Fejzullah Krasniqi, Hivzi Islami, Isuf Krasniqi, Jusuf Bajraktari, Mehmet Kraja, Minir Dushi, Nexhat Daci, Rauf Dhomi, Rexhep Ferri, Rexhep Ismajli, Sabri Hamiti, Tahir Emra, Zejnullah Rrahmani dhe anëtarët korrespondentë: Arsim Bajrami, Arsim Morina, Bardh Rugova, Edi Shukriu, Fetah Podvorica, Frashër Demaj, Gjyljeta Mushkolaj, Justina Pula, Kujtim Shala, Luan Mulliqi, Mehmet Halimi, Muhamedin Kullashi, Myzafer Limani, Qamil Haxhibeqiri dhe Salih Gashi.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi kryetari Hivzi Islami. i cili fillimisht njoftoi Kuvendin se në sallë janë të pranishëm 33 anëtarë të Akademisë, kuorum ka dhe se Kuvendi mund të vazhdojë punën.

Kuvendi njëzëri miratoi këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes XC të Kuvendit;
2. Miratimi i Raportit të punës të ASHAK për vitin 2016;
3. Miratimi i Raportit financiar të ASHAK për vitin 2016;

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë së Akademisë;

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për veprimtarinë botuese;

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për honorarët e veprimtarisë botuese;

7. Çështje vijuese.

Pas miratimit të rendit të ditës Kryetari në fjalën hyrëse tha: “Kolege dhe kolegë të nderuar, mirë se vini në Mbledhjen e XCI të Kuvendit të Akademisë, me rendin e ditës që e keni marrë me kohë.

Në këtë mbledhje do të shqyrtohet puna e të gjitha organeve të Akademisë: e Kuvendit, e Kryesisë, e seksioneve dhe puna e Shërbimit administrativ, profesional dhe teknik. Në mbledhje, shqyrtohet edhe Raporti Financiar për vitin 2016. Materialet e duhura për punën e të gjitha këtyre instancave, që i keni para vete, janë të përgatitura nga Shërbimi Profesional, administrativ dhe teknik i Akademisë. Besoj se i keni lexuar.

Programet e punës së Kryesisë janë shqyrtuar dhe miratuar nga Kryesia, ndërsa të seksioneve nga seksionet dhe Kryesia e Akademisë. Prandaj, jemi të njohur me punën e tyre. Megjithatë, jemi këtu për t’i shqyrtuar raportet e të gjitha instancave të Akademisë.

Këtë vit jemi vonuar pak me mbledhjen e Kuvendit për arsye se në fund të vitit të kaluar i kishim zgjedhjet dhe angazhimi rreth tyre na detyroi që të shtyheshin tri rregulloret, që i kemi sot në rend të ditës për t’i diskutuar dhe aprovuar. Zakonisht këto mbledhje

mbahen deri në gjysmën e muajit shkurt.

Për herë të parë në këtë organ më të lartë të Akademisë, në Kuvend, sot marrin pjesë anëtarët e rinj. Një mirëseardhje e veçantë për ta.

Në vitin 2016 Akademia mbajti 4 mbledhje të Kuvendit, tri të karakterit të punës dhe mbledhja e katërt ishte zgjedhore, ndërsa Kryesia mbajti gjithsej 15 mbledhje të rregullta, por edhe disa mbledhje *ad hoc*; u mbajtën dhe shumë mbledhje të seksioneve dhe të trupave të tjera, të komisioneve, të këshillave organizuese të tubimeve shkencore dhe artistike, të redaksisë qendrore të FEK, të redaksive të revistave etj., ndërsa Shërbimi Administrativ, Profesional dhe Teknik, me departamentet e veta, i ka mbajtur takimet e tij shumë shpesh: punët operative i detyrojnë.

Përveç programeve të punës të realizuara, në vitin 2016 patëm edhe disa angazhime shtesë. Në gjysmën e parë të këtij viti Komisioni përkatës, Kryesia dhe Kuvendi punuan dhe e aprovuan Statutin dhe Rregulloren për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të Akademisë, konform Ligjit të ri për Akademinë, i cili kishte hyrë në fuqi në janar të këtij viti.

Vitin e kaluar i kishim zgjedhjet e rregullta për pranimin e anëtarë të rinj të Akademisë, për avancimin e anëtarëve korrespondentë dhe zgjedhjen e anëtarëve të jashtëm. Këtë kapitull e përmbyllëm me sukses në mbështetje të Ligjit, Statutit dhe Rregulloreve për zgjedhjen e anëtarëve të rinj dhe të kritereve profesionale-

shkencore. U pranuan 8 anëtarë të rinj, 3 u avancuan në anëtarë të rregullt - akademikë dhe u zgjodhën 4 anëtarë të jashtëm. Konkurrenca ishte e madhe: nga 53 propozime sa i kishim, 14 prej tyre u mënjantuan për arsye ligjore dhe procedurale; mbetën 39 kandidatë, prej të cilëve në procedurat e votimit në seksione nuk kaluan 31 kandidatë.

Evidente janë efektet e Ligjit për Akademinë që vuri kufirin e hyrjes në Akademi deri në moshën 65 vjeçare: midis kandidatëve që erdhën në mbledhjen e Kuvendit Zgjedhor dhe pastaj dhe u votuan, në tri seksione janë kandidatë të rinj me moshë të re, nën 65 vjet dhe pjesa dërmuese nën 50 vjet, me ç'rast mosha mesatare u zvogëlua dukshëm.

Përveç përtëritjes, u mbuluan disa fusha të pambuluara apo u forcuan disa fusha, hynë njerëz me një bagazh shkencor dhe u zgjodhën anëtarë të jashtëm me mjaft autoritet në mjediset e tyre, qoftë anëtarë të akademive të vendeve të tyre, që kontribuan edhe për Kosovën, qoftë anëtarë të akademive dhe të institucioneve ndërkombëtare. I gjithë procesi i votimit kaloi shumë mirë, duke u respektuar në plotëni normat ligjore dhe vullneti i votuesve.

Në vitin 2016 kishte disa shkurtime buxhetore nga ana e Qeverisë, jo vetëm për Akademinë, por për të gjitha zërat buxhetorë të Kosovës. Përkundër kësaj mund të konstatojmë se viti 2016 ishte një vit i sukseseve të Akademisë. Ajo brenda mundësive financiare dhe kadrovike arriti t'i realizoj objektivat e veta, të parapara me programin e

punës, të miratuar në vitin paraprak.

Patëm disa botime shkencore-profesionale dhe artistike nga fusha të ndryshme. U mbajt Konferenca shkencore “Ndre Mjeda - 150 vjetori i lindjes” dhe tryezat shkencore “Esad Mekuli në 100-vjetorin e lindjes”, “Trashëgimia kulturore e Kosovës sot”, “100-vjet nga vrasja e Isa Boletinit”, tryeza shkencore “Për migrimet” dhe aktivitete tjera shkencore dhe artistike, si ekspozita inauguruese e skulptorit tonë Luan Mulliqi dhe koncerti i përbashkët i veprave kamerale – muzikë dhome në kuadër të bashkëpunimit me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë etj. Në Tiranë dhe Gjirokastër nën siglën e dy akademive tona u shënua 80-vjetori lindjes së shkrimtarit Ismail Kadare, anëtar i jashtëm i ASHAK, ku morën pjesë përfaqësues të Akademisë sonë. I kemi në materiale të gjitha aktivitetet e realizuara, në pasqyrën sipas seksioneve, me arsyetimet përkatëse; do të botohen në Vjetarin për vitin 2016. Të botimet duhet theksuar se kishim një vonesë nga tetori i vitit 2016 për arsye të përzgjedhjes së shtypshkronjës: tri herë u detyruam ta shpallim tenderin, i cili na mori kohë, kur edhe na zuri përmbyllja e zotimit të mjeteve. U mblodhën disa dorëshkrime, që mbetën pa u botuar; botimi i tyre u bë pas vitit të ri dhe të tjerat janë në proces. Por edhe vonesa e dorëzimit të dorëshkrimeve nga ana e autorëve ishte një problem plotësues; shumica e autorëve dorëshkrimet dhe obligimet e tjera të parapara me programin e punës (tryezat, konferencat) po i lënë në fund

të vitit kur po bëhet tepër vonë.

Informatat për bashkëpunimin ndërkombëtar i keni në materiale. Nënshkrimi i Marrëveshjes së bashkëpunimit midis Akademisë sonë dhe Akademisë Frenge të Mbishkrimeve dhe të Letërsisë (Académie des Inscriptions et Belles Lettres) ishte një nga aktivitetet më të rëndësishme. Në vizitë pune në Akademinë tonë ishin edhe përfaqësuesit e Akademisë Austriake të Shkencave, të Akademisë Maqedonase të Shkencave dhe të Arteve, të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë etj. Anëtarët tonë morën pjesë në disa takime, të organizuara nga ALLEA dhe akademitë e tjera në rajon dhe në Evropë.

Akademia ka marrë pjesë në panairët e rregullta të librit në Prishtinë dhe në Tiranë, ku janë shitur shumë botime tona, si dhe përmes Shoqatës së Botuesve të Kosovës mori pjesë në panairin ndërkombëtar të librit "Salon du livre de Paris" në Paris, i mbështetur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve e Republikës së Kosovës.

Vitin e kaluar për herë të tretë e ndamë çmimin “Shpërblimi Mbështetës 2016” për kandidatët e rinj që kanë arritur suksese në fushën e shkencave dhe të arteve, të financuar nga donatorët.

Gjithashtu edhe Shërbimi administrativ, profesional e teknik i ASHAK, përgjegjës për ofrimin e shërbimeve administrative, profesionale e teknike, i ka kryer detyrat e veta në realizimin e Programit të punës të Akademisë dhe të aktiviteteve tjera të saj. Ky Shërbim ka

arritur ta përmirësojë dhe ta ngrejë cilësinë e shërbimeve administrative, profesionale e teknike me kosto shumë të ulët.

Edhe vitin që shkoi patëm disa humbje: u ndanë nga jeta akademik Latif Susuri dhe dy anëtarë të jashtëm, Maestro Gjelo Gjokaj dhe prof. Zef Mirdita, të cilët i nderuam me respektin më të madh. Këtë vit qofshim të gjithë shëndosh e mirë!

Në fund të kësaj fjale, më duhet t'u them se në fund të qershorit ose në fillim të korrikut të këtij viti e miratojmë Programin e punës për vitin 2018. Përgatituni nga sot për programin për këtë vit.

Edhe këtë vit, 2017, edhe më shumë në vitet në vijim reduktimet financiare do të vazhdojnë, planifikimi i mjeteve gjithashtu, sipas periudhave tremujore, që do të thotë se në qoftë se mjetet e angazhuara për tremujorin përkatës nuk shfrytëzohen – ato i kthehen Ministrisë së Financave me automatizëm. Prandaj, na duhet një menaxhim më i mirë, një azhurnim, racionalitet dhe prioritet në aktivitetin tonë shkencor, artistik dhe profesional. Nuk duhet t'i lëmë anash edhe burimet e tjera, çfarë janë donacionet, të lejuara me ligjin për Akademinë dhe ligjet e Kosovës.

Çdo propozim të arsyetohet me një specifikim të përafërt financiar:

-Konferencat shkencore – numri i të ftuarve, i bujtjeve;

-Tryezat njëditore: sa veta marrin pjesë;

-Përvjetorët;

-Ekspozitat;

-Koncertet (sa interpretë, mysafirë nga jashtë);

-Botimet: vëllimi (numri i tabakëve) - për qershorin e ardhshëm duhet të jetë gati çdo dorëshkrim në mënyrë që të hyjë në Programin e punës; e kemi në Rregullore, që do ta miratojmë sot.

-Projektet të jenë funksionale, dobipëruese për shkencën, profesionin dhe shoqërinë, praktikën shoqërore, të zbatueshme, nëse janë të porositur nga dikush etj.

Nëse ka dikush diçka le të urdhëroj, nëse jo mund të kalojmë te shqyrtimi i pikave të rendit të ditës. Nuk ka, ju faleminderit!“

Ad. 1.-

Procesverbali i mbledhjes XC, të Kuvendit të Akademisë u miratua me disa plotësime të vogla.

Ad. 2.-

Kuvendi shqyrtoi Raportin e punës sipas radhës: Kuvendi, Kryesia, seksionet dhe Shërbimi profesional, administrativ dhe teknik i ASHAK.

Raporti i punës për vitin 2016 u miratua njëzëri dhe është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Raporti do të botohet në revistën Vjetari 2017.

Ad. 3.-

Kuvendi shqyrtoi edhe Raportin financiar për vitin 2016. M. Kraja shtoi pyetjen se pse Raporti kësaj radhe ndryshon nga ai i vitit të kaluar? L. Pula sqaroi se kodet në raport janë të përcaktuara nga Ministria e Financave, ndërsa kësaj radhe është bërë një

zbërthim më i detajuar, vetëm për shkak që shënimet të jenë më të qarta dhe sa më transparente. N. Daci në diskutimin e tij propozoi që në të ardhmen të ndahen më shumë mjete për pajisje të teknologjisë informative, ashtu që kabinetet të jenë më të pajisura.

Pas diskutimeve Kuvendi njëzëri miratoi Raportin financiar për vitin 2016, i cili po ashtu është pjesë përbërëse e këtij procesverballi dhe do të botohet në revistën Vjetari 2017.

Ad. 4.-

Më pas filloi shqyrtimi i draftit të Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e

anëtarëve të Kryesisë së Akademisë. Në diskutimet e tyre L. Mulliqi, A. Bajrami, M. Kraja, R. Dhomi paraqitën disa vërejtje dhe sugjerime për Statutin dhe rregulloret e miratuara më parë. N. Daci në diskutimin e tij tha se çështja e Statutit dhe Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë, nuk janë në rendin e ditës të kësaj mbledhjeje, prandaj nuk ka vend sot për diskutim. Edhe Z. Rrahmani, propozoi që Kuvendi t'i përmbahet rendit të ditës dhe të vazhdohet me shqyrtimin e rregulloreve.

Pas diskutimeve Kryetari Islami vazhdoi mbledhjen sipas rendit të ditës. Ai sqaroi se gjatë afatit shtatë ditor nga të gjithë anëtarët e Akademisë vetëm tre prej tyre: Mehmet Kraja, Rauf Dhomi dhe Fetah Podvorica kanë paraqitur disa vërejtje dhe sugjerime me shkrim, për plotësimin e drafteve të rregulloreve të reja. Grupi punues

është mbledhur dhe i ka shqyrtuar të gjitha shkresat. Propozimi i R. Dhomit nuk është inkorporuar meqë bie ndesh me Ligjin dhe Statutin e Akademisë, ndërsa propozimi i F. Podvoricës është marrë parasysh dhe është implementuar. Vërejtje dhe sugjerime më së shumti ka paraqitur M. Kraja dhe shumica prej tyre janë inkorporuar në draftet e rregulloreve përkatëse. Rregulloret u janë lënë në dispozicion për një javë të gjithë anëtarëve të Akademisë. Po ashtu materialet e Kuvendit u janë ndarë 15 ditë përpara të gjithë anëtarëve të Akademisë. Kohë për t'i lexuar dhe shqyrtuar ka pasur mjaftueshëm. Ai më pas tha se sot jemi këtu për t'i shqyrtuar draftet që i kemi përpara, shkojmë nën për nën dhe ku ka ndërhyrje diskutojmë.

Pas diskutimeve filloi shqyrtimi i Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e

anëtarëve të Kryesisë së Akademisë, nën për nën.

Rregullorja u miratua me 32 vota për dhe një kundër (R. Dhomi).

Ad. 5.-

Në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës Kuvendi shqyrtoi nën për nën draftin e Rregullores për veprimtarinë botuese. Rregullorja u miratua unanimsisht, me disa plotësime të vogla, të natyrës teknike.

Ad. 6.-

Sipas radhës u shqyrtua nën për nën dhe Rregullorja për honorarët e veprimtarisë

Botuese. Rregullorja u miratua unanimsisht.

Ad. 7.-

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës M. Dushi propozoi që të mbahet një mbledhje e jashtëzakonshme e Kuvendit në të cilën do të diskutohet në një pikë të veçantë të rendit të ditës për realizimin e programeve të punës shkencore dhe artistike të ASHAK-ut në periudhën e kaluar, sfidat, vlerat dhe kundërvlerat e shfaqura për gjatë këtij rrugëtimi.

Kryetari Islami tha se kërkesa e akademik Dushit për mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit duhet të shtrohet në procedurë të veçantë në përputhje me Ligjin dhe Statutin e Akademisë.

Mbledhja u mbyll në orën 13:30

Procesmbajtëse

Lendita Pula

Kryetari i Akademisë

Akademik Hivzi Islami

PROCESVERBAL

Nga mbledhja XCII e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 29 qershor 2017, ora 11:00, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Ali Aliu, Anton K. Berishaj, Ekrem Murtezai, Eqrem Basha, Feriz Krasniqi, Fejzullah Krasniqi, Hivzi Islami, Isa Mustafa, Isuf Krasniqi, Jusuf Bajraktari, Mehmet Kraja, Nexhat Daci, Rauf Dhomi, Rexhep Ismajli, Sabri Hamiti,

Tahir Emra, Zeqirja Ballata, Zejnullah Rrahmani dhe anëtarët korrëspondentë: Arsim Bajrami, Bardh Rugova, Edi Shukriu, Fetah Podvorica, Frashër Demaj, Gjyljeta Mushkolaj, Justina Pula, Kujtim Shala, Luan Mulliqi, Mehmet Halimi, Muhamedin Kullashi, Myzafere Limani, Qamil Haxhibeqiri, Salih Gashi dhe Xhevdet Xhafa.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi kryetari Hivzi Islami. I cili fillimisht njoftoi Kuvendin se në sallë janë të pranishëm 33 anëtarë të Akademisë, kuorum ka dhe se Kuvendi mund të vazhdojë punën.

Kuvendi njëzëri miratoi këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes XCI të Kuvendit;
2. Miratimi i Programit të punës së Akademisë për vitin 2018;
3. Njoftim për buxhetin dhe planin financiar të ASHAK, bazuar në Qarkoren buxhetore 2018/1;
4. Çështje vijuese.

Pas miratimit të rendit të ditës Kryetari Islami në fjalën hyrëse tha: "Para se të kalojmë te pikat e rendit të ditës, ju lus shumë që t'i përmbahemi rendit të ditës. Në mbledhjen e fundit, ju kujtohet dolëm nga rendi i ditës. Ndonëse si pikë qendrore i kishim miratimin e Programit të punës për vitin 2016 dhe pika tjera, gati e

braktisëm rendin e ditës, duke e mos thënë askush asnjë fjalë të vetme për Programin e vitit paraprak, përveç meje si i detyruar të jepja një pasqyrë të shkurtër të punës. Disa kolegë, duke dalë nga rendi i ditës, u kapën për interesa të ngushta, personale, meskine, duke zbrazur mllafe e mllafe, pa asnjë arsye.

Nuk ka anëtarë të Akademisë, të gjallë (para anëtarëve të rinj ishim 29 dhe të vdekur 28 veta), që në situata të caktuara nuk u është cenuar ndonjë interes personal ose kanë pretenduar se u janë bërë disa të padrejta - në botime, projekte, avancime, në honorarë etj., por kështu si në mbledhjen e kaluar nuk ka pasur reagime kaq të ulëta, kaq egoiste. Ka pasur anëtarë të vjetër me moshë, por edhe anëtarë në pozita të larta shoqërore që diçka nuk u është plotësuar, por ku u është dhënë arsyetimi, janë fashitur emocionet dhe janë pajtuar.

Të kërkohet që një pjesë e normave ligjore të Akademisë të abrogohen ende pa u miratuar (tri rregullore prisnin diskutimin dhe aprovimin) dhe dokumentet e tjera bazike, çfarë janë Ligji dhe Statuti, ende të njomë, të ndryshohen, është diçka e paparë. Dëshiroj që diçka e tillë të mos përsëritet. Dashakeqësitë, frus-trimet anash, mjaft dashakeqësi vijnë nga jashtë, të mos i ushqejmë ato dhe ne nga brenda. Para një jave (23 qershor, në orët e mbrëmjes, në Portalin lajmi.net u lansua gënjeshtër se auditori po thotë se "Akademikët i servisuani makinat jashtëligjshëm"! E

morën edhe portalet e tjera. Reaguam shpejt dhe e demantuam. Bëhet fjalë për Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, që ka shkurtesën e njëjtë - ASHAK. Pa e lexuar tekstin na akuzojnë, sepse veprojnë me ngarkesa ndaj Akademisë.

Ky institucion është i të gjithëve, në si udhëheqje natyrisht që e kemi përgjegjësinë më të madhe, por institucioni është i të gjithëve. Akademia edhe në situata dramatike në historinë e saj, ka arritur ta ruaj individualitetin dhe pavarësinë. Është investuar shumë në autonominë e kësaj themelate, që është një pasuri e madhe, por janë ruajtur edhe raportet ndërkolegjiale brenda nesh, që është gjithashtu një pasuri tjetër e madhe - në komisione e grupe punuese, në redaksi, në seksione, në Kryesi, në Kuvend, me gjithë mospajtimet për çështje të ndryshme. Dhe duhet të mos pajtohemi për çështje të karakterit të punës, të perspektivës së këtij institucioni, sepse mospajtimi këtu del pozitiv, por interesat e ngushta meskine duhet të mbesin jashtë; përgojimi i kësaj shtëpie në qarqe të ndryshme, i shtëpisë së dytë, bukën e së cilës e hamë, nuk është i moralshëm".

Ad. 1.-

Procesverbali i mbledhjes XCI, të Kuvendit të Akademisë u miratua pa vërejtje.

Ad. 2.-

Para fillimit të shqyrtimit të Programit të punës së ASHAK për vitin 2018, Kryetari Islami tha se:

"Përgatitjet për programet e punës së Seksioneve për vitin e ardhshëm kanë nisur herët: për projekte në kohëzgjatje të ndryshme, për tryeza e konferenca shkencore, për botime, për iniciativa të reja, por të realizueshme në rrethana tona financiare, kadrovike etj. Nga seksionet, të cilat janë takuar disa herë, janë marrë propozimet. Kryesia i ka diskutuar dhe i sjell në Kuvend për t'i shqyrtuar dhe miratuar. Ka ndërhyrë vetëm në disa pika të aktiviteteve për arsye kryesisht financiare, duke i respektuar disa prioritetet, por pa prekur në esencë.

Programi i punës për vitin 2018, mund të thuhet se është relativisht i pasur dhe i llojlojshëm sa i përket fushave. Seksioni i Shkencave të Natyrës është diçka i varfër - nuk e di pse; arsyetimet në Kryesi nuk ishin fort bindëse. Seksionet janë bartëse të organizimit të punës kërkimore-shkencore dhe artistike; ato duhet të jenë gjithnjë aktive, t'i marrin përsipër detyrat, aktivitetet dhe përgjegjësitë që u takojnë sipas Statutit dhe Ligjit. Sekretarët duhet gjithnjë të prijnë, të mos humbet kohë kot në Kryesi dhe në Kuvend. Dilet me kërkesë për mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit, ku në pjesën e parë thuhet se Akademia ka punuar mirë, ka shënuar shumë suksese në punë, me tubime, botime e projekte, aktivitete artistike etj., ndërsa në pjesën e dytë thuhet se duhet të mbahet një Kuvend i jashtëzakonshëm për t'u vlerësuar kjo punë në mënyrë kritike. Kjo është alogjike, sepse pjesa e parë bie ndesh me pjesën e dytë. Lexojeni tekstin në procesverbal. Kuvendi i jashtëzakonshëm mbahet

vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe me procedurë të veçantë, kur e kërkojnë së paku dy seksione. Gjatë vitit 2016, i mbajtëm tri kuvende të punës, asnjë fjalë nuk e thanë këta që kërkojnë mbledhje të jashtëzakonshme. Akademia në historinë e saj ka mbajtur vetëm një Kuvend të jashtëzakonshëm, në vitin 1994 kur na kanë nxjerrë me dhunë nga ndërtesa. Prof. G. Zajmi ishte kryetar. Të ngritesh në përfundim të mbledhjes e ta keqpërdorësh pikën vijuese nuk është e lejueshme, kur gjysma e anëtarëve dalin jashtë, gjysma tjetër pret në këmbë, lexohen tekste disa minuta, askush nuk e dëgjon, por të le sherrin se duhet ta futësh në procesverbal, sepse ngjarja ka ndodhur.

Duhet ta kemi të qartë edhe një fakt: të gjitha format e aktiviteteve të Akademisë, të përfunduara, duke e marrë legjitimitetin nga Seksionet deri te Kuvendet, nuk kanë më pse të diskutohen apo të rivlerësohen. Diskutimet bëhen në kohën kur shqyrtohen në këto instanca dhe në anën tjetër, problemet e seksioneve nuk kanë pse të barten në Kuvend, të zgjidhen atje ku kanë lindur. Në Seksione, shpeshherë po dominon oportunizmi, si një sëmundje e moçme - barten problemet në Kryesi dhe në Kuvend pa asnjë nevojë.

Akademia po rritet dhe zgjerohet në pikëpamje kadrovike, veprimtaria dhe llojlojshmëria gjithashtu, prandaj po shtohen nevojat për mjete. Vëllimi i mjeteve për veprimtari nuk po rritet, përkundrazi po reduktohet. Vetëm vjet

i patëm dy reduktime financiare - me vendim qeveritar - për të gjitha zërat financiarë të Kosovës, por me rebalans na u lejuan edhe mjaft mjete në sajë të ndërhyrjes së Kryeministrit dhe Ministrit të Financave. Gjithë veprimtaria e Akademisë është reduktuar në 320.000 euro, pjesa tjetër shkon kryesisht në shpërblime dhe paga. Kaq është pozicioni Shërbime dhe mallra.

Me gjendje jo të volitshme do të hymë edhe vitin e ardhshëm. Kemi bërë kërkesë për mjete shtesë ka sa kohë, dhe jemi në pritje që me rishikim të buxhetit, të plotësohen kërkesat tona. Jemi në pritje. Prandaj, viti 2018 do të jetë një vit jo i lehtë financiar. Akademisë do t'i duhet një menaxhim shumë më i mirë, një racionalitet dhe një prioritet në aktivitetin tonë shkencor, artistik dhe profesional. I kemi disa kriteret për përcaktimin e listës prioritare të veprimtarisë sonë, të cilat duket se do të jemi të shtrënguar t'i aplikojmë vitin e ardhshëm. Ndoshta edhe në këto 6 muajt e këtij viti. Në këtë situatë jo të volitshme financiare duhet t'i kthehemi edhe donacioneve, veçanërisht te projektet. I kemi lënë anash. Dikur, në kohë më të rënda, kemi gjetur donatorë. Po presim vetëm nga Buxheti i Kosovës. Ka sot shumë kompani, firma, agjenci, ministri, individë të fuqishëm financiarisht, në Kosovë dhe jashtë saj, në diasporë që mund të na ndihmojnë, por duhet të kërkojmë mjete për projekte në kohëzgjatje të ndryshme, për botime ekskluzive, me rëndësi të madhe shkencore dhe shoqërore, për realizime kulmore artistike etj., me

arsyetime përkatëse. Donacionet janë të ligjshme.

Është kurajues fakti se shumica e anëtarëve të rinj janë treguar aktivë, duke propozuar tema konkrete shkencore-hulumtuese, për organizimin e tubimeve shkencore, botimeve etj. Nuk e di sa u është dhënë hapësirë në seksione. Te kriteret për përcaktimin e listës prioritare të veprimtarisë sonë, askund nuk thuhet se prioritet kanë anëtarët e vjetër, ndërsa anëtarët e rinj duhet të presin, siç ka ndodhur në disa raste tash; të gjithë janë të barabartë. Është gabim të interpretohen ashtu kriteret. Anëtarët e rinj mund diku edhe të presin, por ata duhet të mbështeten.

Krejt në fund, shumë herë e kemi përsëritur një fakt: autoriteti i Akademisë varet nga ne, nga puna dhe angazhimi ynë dhe këmbëngulësia që të mbrohet dinjiteti dhe pavarësia e kësaj themelate. Zyrat i kemi paguhemi mirë për rrethanat tona. Imazhi ynë, i mirë apo i keq, është në duart tona. Imazhi është para së gjithash puna. Nuk jemi këtu vetëm për interesa personale. Ne jemi njerëz të botës akademike dhe intelektuale, me një status të veçantë shkencor, krijues dhe shoqëror, të lirë dhe autonomë dhe mund të marrim pjesë në aktivitete të ndryshme shkencore e artistike, profesionale e shoqërore jashtë Akademisë. Akademia nuk ka platformë si partitë politike që t'i përmbahet asaj, por ne jemi të pavarur në pikëpamjet tona jashtë saj, në tubime shkencore, në jetën shoqërore, mund t'i shfaqim mendimet, të

prononcohemi me argumente, përgjegjësitë janë individuale; ky është një imazh i mirë për Akademinë. Punët në Seksione dhe në Akademi duhet të kryhen, por edhe Akademinë duhet ta mbrojnë kudo që jemi. Ju faleminderit!"

Më pas filloi shqyrtimi i Programit të punës me radhë sipas seksioneve. Kryetari Islami tha se sekretarët e seksioneve dhe sekretari shkencor nëse kërkohet mund të shtojnë apo të arsyetojnë diçka, në çdo moment gjatë diskutimit. M. Kraja në diskutimin e tij kërkoi disa sqarime rreth programit të punës së SSHSH dhe paraqiti disa sugjerime për përmirësime të natyrës teknike. Sa i përket organizimit të konferencës shkencore: Teatri si temë e mendimit filozofik -Raportet midis teatrit bashkëkohor dhe teatrit modern evropian dhe simpoziumit shkencor: Pavarësia e Kosovës dhe sfidat e shtet ndërtimit, M. Kraja propozoi që të dy këto aktivitete të organizohen në nivel të Akademisë e jo vetëm të seksionit të SHSH.

J. Bajraktari më pas ofroi sqarimet e kërkuara për programin e punës së SSHSH, ndërsa për aktivitetet shkencore tha se ato janë propozuar nga SSHSH, por kur të fillojnë përgatitjet (ngritja e këshillit organizativ) mund të ketë përfshirje edhe të seksioneve të tjera.

Diskutuan H. Islami, N. Daci, R. Ismajli dhe pas diskutimeve Kuvendi miratoi njëzëri Programin e punës për vitin 2018, i cili është bashkëlidhur procesverbalit.

Ad. 3.-

Kuvendi u njoftua për buxhetin dhe planin financiar të ASHAK, bazuar në Qarkoren buxhetore 2018/1;

L. Pula sqaroi se Qarkorja në fjalë është shqyrtuar dhe miratuar nga Kryesia e Akademisë dhe se me Statutin e ri të Akademisë ajo duhet të miratohet edhe në Kuvend.

M. Kraja kërkoi sqarime për pjesën e kategorisë shpenzime kapitale, përkatësisht për mjetet e ndara në vlerë prej 255,000.006. L. Pula sqaroi se mjetet janë ndarë sipas kërkesës së ASHAK, një pjesë e tyre janë të dedikuara për blerjen e pajisjeve të sofistikuara të TI, dhe pjesa tjetër për ndërhyrje në mjediset ku do të vendosen pajisjet dhe pjesët përcjellëse të tyre. Ajo tha se brenda dy ditëve do t'iu dërgojë të gjithë anëtarëve të Akademisë nëpër kabinete, të gjitha dokumentet që lidhen me projektin në fjalë.

Kuvendi njëzëri miratoi buxhetin dhe planin financiar të ASHAK, bazuar në Qarkoren buxhetore 2018/1.

Mbledhja u mbyll në orën 12:40

Procesmbajtëse

Lendita Pula

Kryetari i Akademisë

Akademik Hivzi Islami

PROCESVERBAL

Nga mbledhja XCIII e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 21 dhjetor

2017, ora 11:00, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Ali Aliu, Anton K. Berishaj, Ekrem Murtezai, Eqrem Basha, Feriz Krasniqi, Fejzullah Krasniqi, Hivzi Islami, Isa Mustafa, Isuf Krasniqi, Jusuf Bajraktari, Minir Dushi, Nexhat Daci, Rauf Dhomi, Rexhep Ferri, Rexhep Ismajli, Sabri Hamiti, Tahir Emra, Zeqirja Ballata, Zejnullah Rrahmani dhe anëtarët korrespondentë: Arsim Bajrami, Arsim Morina, Bardh Rugova, Edi Shukriu, Fetah Podvorica, Frashër Demaj, Gjyljeta Mushkolaj, Justina Pula, Kujtim Shala, Luan Mulliqi, Mehmet Halimi, Muhamedin Kullashi, Myzafer Limani, Qamil Haxhibeqiri, Salih Gashi dhe Xhevdet Xhafa.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi kryetari Hivzi Islami i cili pasi u uroi mirëseardhje të gjithë anëtarëve të Akademisë njoftoi Kuvendin se nga 38 anëtarë sa ka Akademia, në sallë janë të pranishëm 35 anëtarë, kuorum ka dhe se Kuvendi mund të vazhdojë me punë. Ai propozoi që bazuar në Statutin e Akademisë, neni 29, të mos përfshihen në kuorum akademikët Idriz Ajeti dhe Rexhep Qosja. Propozimi u miratua unanimisht.

Më pas Kryetari Islami njoftoi Kuvendin se bazuar në aktet normative të ASHAK-ut, kandidatë të zgjedhur konsiderohen ata që fitojnë shumicën e votave të anëtarëve të rregullt dhe të anëtarëve korrespondentë të Akademisë, që do të thotë 19 vota.

Kuvendi njëzëri miratoi këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes XCII të Kuvendit të Akademisë;
2. Caktimi i Komisionit të zgjedhjeve për zgjedhjen e Kryesisë së Akademisë;
3. Votimi për zgjedhjen e Kryesisë së Akademisë dhe shpallja e rezultateve të votimit;
4. Miratimi i zgjedhjes së sekretarëve të seksioneve të Akademisë;
5. Miratimi i Rregullores për përdorimin e mjeteve financiare të donacionit për stimulimin e zhvillimit të punës shkencore-kërkimore të të rinjve nga lëmi i shkencave të natyrës, të ASHAK;
6. Miratimi i Rregullores për blerjen e veprave artistike, të ASHAK;
7. Çështje vijuese.

Ad. 1.-

Procesverbali i mbledhjes XCII, të Kuvendit të Akademisë u miratua pa vërejtje.

Ad. 2.-

Kryetari Islami propozoi përbërjen e Komisionit të zgjedhjeve për zgjedhjen e Kryesisë së Akademisë: Feriz Krasniqi, kryetar, dhe Zeqirja Ballata, Zejnullah Rrahmani dhe Edi Shukriu, anëtarë. Propozimi u miratua njëzëri nga Kuvendi.

Ai më pas njoftoi Kuvendin se zgjedhjet për Kryesinë e Akademisë kanë filluar me kohë dhe në përputhje me aktet

normative të Akademisë. Janë mbajtur mbledhjet I dhe II të seksioneve dhe nga ato kanë dalë propozimet:

Për Kryetar e kanë fituar të drejtën e kandidimit dy kandidatë: Nexhat Daci i kandiduar në tri seksione dhe Sabri Hamiti i kandiduar në një seksion, por në ndërkohë Sabri Hamiti është tërhequr për arsye personale, prandaj në garë mbetet vetëm Nexhat Daci.

Për Nënkyetar e ka fituar të drejtën e kandidimit akademik Jusuf Bajraktari, i kandiduar në tri seksione;

Për Sekretar shkencor e kanë fituar të drejtën e kandidimit dy kandidatë: Fejzullah Krasniqi i kandiduar në një seksion dhe Myzafere Limani e kandiduar në dy seksione.

Ad. 3.-

Komisioni i zgjedhjeve i përgatiti dhe i shpërndau fletëvotimet për zgjedhjen e Kryetarit, Nënkyetarit dhe të Sekretarit shkencor të Akademisë. Pas votimit me vota të fshehta, Komisioni i votimeve u tërhoq, i numëroi votat dhe konstatoi se votimi ka dhënë këto rezultate:

1. Për zgjedhjen e Kryetarit të Akademisë: votuan 35 anëtarë të ASHAK-ut. U gjetën 23 fletëvotime të vlefshme dhe 12 të pavlefshme.

Kandidati Nexhat Daci mori 23 vota dhe u zgjodh Kryetar i Akademisë, për mandatin e përcaktuar me Statut.

2. Për zgjedhjen e Nënkyetarit të Akademisë: votuan 35 anëtarë të ASHAK-ut. U gjetën 21 fletëvotime të vlefshme dhe 14 të pavlefshme.

Kandidati Jusuf Bajraktari mori 21 vota

dhe u zgjodh Nënkyetar i Akademisë, për mandatin e përcaktuar me Statut.

3. Për pozitën e Sekretarit shkencor të Akademisë u votua dy herë.

Në votimin e parë:

Votuan 35 anëtarë të ASHAK-ut. U gjetën 31 fletëvotime të vlefshme dhe 4 të pavlefshme.

Kandidati Fejzullah Krasniqi mori 14 vota

Kandidatja Myzafere Limani mori 17 vota.

Më pas sipas Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë së Akademisë, neni 12, paragrafi 3, votimi u përsërit për dy kandidatët që herën e parë fituan numrin më të madh të votave (M. Limani dhe F. Krasniqi).

Në votimin e dytë:

Votuan 35 anëtarë të ASHAK-ut. U gjetën 29 fletëvotime të vlefshme dhe 6 të pavlefshme.

Kandidatja Myzafere Limani mori 19 vota.

Kandidati Fejzullah Krasniqi mori 10 vota

Kandidatja Myzafere Limani u zgjodh Sekretare shkencore e Akademisë, për mandatin e përcaktuar me Statut.

Ad. 4.-

Në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës Kuvendi miratoi zgjedhjen e sekretarëve të seksioneve të Akademisë:

1. Akademik Eqrem Basha, Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë;

2. Anëtare korrespondente Justina

Pula, Sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore;

3. Anëtar korrespondent Fetah Podvorica, Sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës;

4. Anëtar korrespondent Luan Mulliqi, Sekretar i Seksionit të Arteve.

Pas zgjedhjes së Kryesisë së re kryetari Islami tha:

“Të nderuar kolegë,

Vox populli, vox dei – Fjala e popullit, fjala e zotit! Më lejoni të konstatoj se Kuvendi i rregullt i Akademisë zgjodhi sot Kryesinë e re. Votimi ishte i fshehtë, foli vullneti i anëtarëve, gjithçka në përputhje me Ligjin, Statutin dhe Rregulloren për zgjedhjen e Kryesisë së Akademisë, dhe doli ky rezultat. Në emër të Kryesisë së deritanishme dhe të gjithë anëtarëve, uroj që Kryesia e re ta ushtrojë me sukses funksionin e saj në mandatin ligjor dhe statutar, së bashku me të gjithë ne, sepse krejt kemi angazhime në kuadër të ndarjes së punëve, nga Seksioni deri në Kuvend. Është një Kryesi me eksperiencë të gjatë akademike, shkencore, organizative dhe menaxheriale.

Kryesia e re e gjen një gjendje që e dini, sepse jeni pjesë e saj: me pavarësi dhe autonomi të plotë, me infrastrukturë complete ligjore, me raporte të mira ndërkolegjiale, të përtëritur me anëtarë të rinj, me një përmirësim të përbërjes gjinore, me hapje dhe integrim ndërkombëtar akademik dhe shkencor (ALLEA, Procesi i Berlinit, tash u bëmë edhe anëtar të Unionit Ndërkombëtar Akademik, me traditë

njëshekullore), me marrëveshje bashkëpunimi me shumë akademi në rajon dhe në Evropë. E gjeni pastaj këtë themelatë dhe me disa probleme financiare për aktivitetin e saj (kështu është puna me shkurtimin e të gjitha zërave buxhetorë në Republikë), përkundër përmirësimit sa i përket pagave dhe shpërblimeve, të cilat janë të mira, më të mira në rajon. Duhet të punohet në sigurimin e mjeteve për produktion – për botime, projekte, ekspozita, koncerte dhe nga donacionet. Me pranimet e fundit në Akademi, në tri seksionet (Gjuhësia e Letërsia, Shkencat Shoqërore dhe Shkencat e Natyrës) u krijua mundësia për një perspektivë solide. Artet duhet të reflektojnë për vetveten: e kanë situatën keq, vetë e kanë krijuar!

Unë jam gjatë në organet drejtuese, kështu u zhvilluan punët dhe më ra të bashkëpunojë me të gjithë kolegët dhe të njihesha me të gjitha punët profesionale, shkencore, administrative. Dëshiroj t'i falënderoj të gjithë kolegët me të cilët më ra të bashkëpunoja, edhe me shumë prej tyre që nuk janë më në mesin tonë. Veçanërisht i falënderoj post mortem prof. Besim Bokshin dhe prof. Pajazit Nushin, me të cilët gjatë punova dhe ishte një kënaqësi të punoja me ta. Ju falënderoj të gjithëve!

Ky institucion nuk mund të funksionojë pa angazhimin e të gjithë anëtarëve të tij dhe asnjë minutë pa administratën. Administrata është shtylla e domosdoshme: është investuar shumë në ngritjen e saj – në shtyllat kryesore: Sekretarja, Financat, Mbikëqyrja

Profesionale, Biblioteka. Është e vogël, por efikase, është edhe më e vogël kur e sheh se rreth gjysma nuk kanë kapacitete të punojnë – të tillët as që i duhen Akademisë. Ne shpeshherë kur nuk i kryejmë punët e tona, profesionale-shkencore dhe artistike – krejt fajet ia hedhim administratës, me mllafe, me nervozë. Jo, jo, aty ka mjaft dobësi, por jo aq sa akuzohen kur vetë ne nuk i kryejmë punët, veçanërisht seksionet dhe sekretarët e seksioneve – ai oportunizmi në seksione është një sëmundje e gjatë dhe po del e pashërueshme. E falënderoj shumë administratën, me pritjen që të jetë edhe më efikase dhe më pragmatike. Administrata është për ne, ne nuk jemi për administratën, pa ne ajo nuk do të ekzistonte; ky fakt duhet të dihet.

Imazhi i kësaj shtëpie është në duart tona, varet nga ne, nga puna jonë. Imazhin e prishim vetëm ne nga brenda, nëse nuk punojmë, nëse nuk e mbrojmë institucionin kudo që jemi, nëse flasim kundër tij dhe kolegëve nëpër kafene, në qarqe mediatike, te grupet e interesit që janë ose antiakademi dhe antikulturë ose nuk e kuptojnë natyrën e punëve të institucionit, dhe flasin keq për Akademinë vetëm e vetëm pse nuk kanë hyrë këtu; ky është fronti më i madh, por disa prej tyre ushqehen nga brenda Akademisë. Kjo dhembë shumë.

Ne i japim llogari vetvetes dhe këtij Kuvendi, jo mediave e portaleve kanceroze dhe grupeve të interesit. Për çështje të mëdha i përgjigjemi shtetit. Ju faleminderit dhe suksese!

E do dikush fjalën, Kryetar? Urdhëro!”

Nexhat Daci pas zgjedhjes Kryetar i Akademisë fillimisht i falënderoi të gjithë anëtarët e Akademisë. Ai tha se para 15 vjetëve nga pozita e Kryetarit të ASHAK ka kaluar në Parlamentin e Kosovës dhe se tradita e fituar dhe e kultivuar në ASHAK ka pasur rëndësi për punën e tij më tutje. Ai falënderoi akademikët Besim Bokshi, Hivzi Islami, Rexhep Ismajli që me punën e tyre e kanë ruajtur traditën. Kjo traditë, vazhdoi ai ka ndikuar që ASHAK të depërtojë edhe në qarqet ndërkombëtare pa kërkuar lëmoshë. Ai falënderoi akademik Rexhep Ismajlin për kontributin dhe angazhimin në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe Hivzi Islamin për përkushtimin që ASHAK të bëhet pjesë e procesit të Berlinit dhe të Danubit. Në fund ai i uroi edhe të zgjedhurit e tjerë të Kryesisë.

Ad. 5.-

Kuvendi shqyrtoi Rregulloren për përdorimin e mjeteve financiare të donacionit për stimulimin e zhvillimit të punës shkencore-kërkimore të të rinjve nga lëmi i shkencave të natyrës, të ASHAK. Kryetari Islami njoftoi se drafti i Rregullores është hartuar në koordinim me Sekretarin e Seksionit të Shkencave të Natyrës dhe është shqyrtuar edhe në Kryesinë e Akademisë.

Kuvendi pa asnjë votë kundër miratoi Rregulloren në fjalë.

Ad. 6.-

U shqyrtua edhe Rregullorja për blerjen e veprave artistike, të ASHAK. Kryetari

Islami po ashtu tha se edhe kjo Rregullore është hartuar në koordinim me Sekretarin e Seksionit të Arteve dhe është shqyrtuar në Kryesi.

Rregullorja u miratua pa asnjë votë kundër.

Mbledhja u mbyll në orën 12:20

Procesmbajtëse

Lendita Pula

Kryetari i Akademisë

Akademik Hivzi Islami

KRONIKA E VITIT 2017

KRONIKA/ 2017

(Aktivitete shkencore, ekspozita, vizita, përvjetorë, ligjërata, përrurime...)

MBAHET CEREMONIA INAUGURUESE PËR ANËTARËT E RINJ TË ASHAK-ut

Më 11 janar 2017, në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës u mbajt Ceremonia inauguruese për anëtarët e rinj të ASHAK-ut. Me këtë rast Kryetari i Akademisë, akademik Hivzi Islami mbajti një fjalë rasti dhe ndër të tjera tha:

“Kolege dhe kolegë të nderuar,

I nderuar Kryeministër,

Zonja dhe zotërinj,

Mirë se vini në seancën ceremoniale të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës ku do t’u dorëzohen Fletëdëshmitë anëtarëve të rinj, korrespondentë dhe të rregullt të kësaj themelate!

Nuk ka dyshim se sot është një ditë e shënuar për ju anëtarë të rinj dhe

anëtarë të avancuar, por edhe për Akademinë dhe gjithë shoqërinë e dijës. Deri para 4 viteve ne i drejtoheshim kolektivit tonë vetëm me kolegë dhe zotëri, pas pranimi të një femre në Akademi i drejtoheshim me kolege ose zonjë, pra në njëjës. Sot kam kënaqësinë që, falë reflektimit të seksioneve dhe Kuvendit zgjedhor, t’u drejtohem me kolege dhe kolegë – në shumës dhe zonja dhe zotërinj gjithashtu në shumës. Për herë të parë në mesin tonë i kemi 4 femra gjithsej, që përbëjnë 11% e të të gjithë anëtarëve dhe 37% të të gjithë anëtarëve të rinj, të zgjedhura me kriteret shkencore dhe ligjore. Një lajm dhe një imazh i mirë për Akademinë dhe Kosovën. Kemi çka t’i raportojmë edhe Federatës së Akademive Nacionale të Evropës - ALLEA-s (All



European Academies), ndonëse as akademitë evropiane nuk janë më mirë se ne.

Këto zgjedhje ishin të suksesshme: u pranuan 8 anëtarë të rinj, 3 u avancuan në anëtarë të rregullt - akademikë dhe u zgjodhën 4 anëtarë të jashtëm. Lajmi tjetër i mirë është se efektet e Ligjit për Akademinë që vëri kufirin e hyrjes në Akademi deri në moshën 65 vjeçare, janë evidente: midis kandidatëve që erdhën në mbledhjen e Kuvendit Zgjedhor dhe pastaj dhe u votuan, në tri seksione janë kandidatë të rinj me moshë të re, nën 65 vjet dhe pjesa dërmuese nën 50 vjet: 2 kandidatë i kanë nga 42 vjet, një 43, një 48, i pesti i ka 53 vjet dhe dy kandidatë të tjerë midis 62-63 vjet - këtë situatë nuk e kemi pasur më herët. Moshë mesatare para zgjedhjeve ishte rreth 73 vjet, me këta kandidatë të rinj ajo bie në afër 67 vjet. Është një përtëritje e dukshme, më e madhja në gjithë historinë e Akademisë sonë.

Zgjedhjet janë një kaptinë komplekse, e ndjeshme dhe e koklavitur si procedurë, por janë shumë demokratike. Procesin e zgjedhjeve e hapëm më 2 shtator 2016, gati 4 muaj para votimit në Kuvend, krejt në mbështetje të çdo germe të Ligjit, të Statutit dhe të Rregullores për zgjedhje. E përmbyllëm procesin me sukses, duke i respektuar rigorozisht kriteret ligjore dhe profesionale-shkencore: u bë përtëritja, u mbuluan disa fusha të pambuluara ose u forcuan disa fusha, hynë njerëz me një bagazh shkencor; u zgjodhën anëtarë të jashtëm me shumë autoritet në mjediset e tyre, qoftë anëtarë të akademive të vendeve

të tyre, që kontribuuan edhe për Kosovën, qoftë anëtarë të akademive botërore, çfarë është rasti me neurokirurgun me famë botërore, prof. Mentor Petrelën, i cili në falënderimin e tij, pas njoftimit zyrtar se është zgjedhur anëtar i jashtëm i Akademisë sonë, shkroi: "Jam thellësisht i prekur nga vendimi që ju përcillni në këtë kalim vitesh. Ndjem i privilegjuar dhe pa fjalë"!

Kolege dhe kolegë, ka pasur një prurje të madhe me propozimet nga jashtë dhe më pak nga brenda. Prandaj, ju dolët nga një konkurrencë e fortë: nga 53 propozime sa arrin në Akademi, 14 prej tyre u mënjanuan për arsye ligjore dhe procedurale; mbetën 39 kandidatë, prej të cilëve në procedurat e votimit në seksione nuk kaluan 31 kandidatë. Sigurisht që brenda këtyre që ranë ka pasur që e kanë merituar të vinin në Kuvendin zgjedhor. Megjithatë, secili prej votuesve dike e preferon e dike jo, por nëse seksionet si bërthama kryesore profesionale, shkencore-hulumtuese dhe artistike e kishin vendosur se ke e preferonin, atëherë ishte tejet e natyrshme që Kuvendi t'i mbështeste propozimet e tyre. Dhe me votën e lirë, i mbështeti shumicën dërmuese prej tyre.

Ju anëtarët e rinj, do e shihni se çdo gjë nisët në Seksione: idetë për projekte, për botime shkencore e artistike, propozimet për tryeza, konferenca e simpoziume shkencore, ekspozita, koncerte, për kërkesa të ndryshme; aty nxitet, zhvillohet dhe planifikohet puna krijuese, shkencore dhe artistike. Sekretarët e seksioneve e drejtojnë Seksionin. Punohet në tema të

ndryshme sipas programeve të seksioneve dhe të organeve të tjera të Akademisë, gjithnjë në të mirë të shkencës, të objektivitetit shkencor, të kulturës dhe të zhvillimit të përgjithshëm të Kosovës. Debat i për temën të ndryshme duhet të jetë objektiv ynë. "Shkenca është gjithmonë debat dhe jo e vërtetë absolute dhe studiuesi nuk mund të pohojë se ai ka monopolin mbi të vërtetën", thotë studiuesi i njohur, anëtar i Akademisë Austriake të Shkencave dhe anëtar i jashtëm i Akademisë sonë, prof. Oliver Schmitt. Është e vërtetë se pritjet e opinionit të gjerë nga Akademia janë të mëdha, por kjo themelatë në asnjë rast nuk mund të involvohet në debatet dhe ngjarjet e politikës së ditës, sikundër që kurrë nuk do ta ndjek modelin e Akademisë Serbe, këtë që e preferon një pjesë e mirë e opinionit tonë, të përfunduar dhe të politizuar skajshmërisht. Akademia nuk është parti apo grupacion politik që të prononcohet dhe të marrë qëndrime për çdo problem të ditës ose të marrë anë në luftën e paskrupullt për pushtet të grupacioneve politike. Akademia nuk është kujdestare për gjithçka dhe fajtorë për çdo gjë!

Funksionimi i institucionit tonë është specifik, prandaj vështirë dhe kuptohet puna e tij. Perceptimet e gabuara nga jashtë dhe prejudikimet ndaj Akademisë vështirë ndryshohen në klimën e përgjithshme të interesave të ndryshme të individëve të frustruar, të grupeve dhe qarqeve të ndryshme të shoqërisë, përfshirë dhe shoqërinë civile. Nuk ka dyshim se këtu

mbisundojnë në radhë të parë mosinformimi (sepse nuk donë të informohen), por edhe nihilizmi dhe dashakeqësia ndaj Akademisë. Pasqyrimet e tilla i ndryshojmë vetëm me punë, por edhe me një lloj propagande në favor të punës sonë.

Akademia me ligj është institucion këshillues dhe sugjerues për zhvillimin e

shkencës e të artit dhe për zhvillimet tjera me interes të përgjithshëm për Kosovën, por ajo për dekada shumë pak ose aspak nuk është konsultuar për çështje të rëndësishme për vendin. As për universitetet e reja (6 sa janë bërë), as për gjendjen në UP – 4 rektorë janë gjallë në Akademi, asnjë bisedë as me ta! Megjithatë, Akademia nuk ka qëndruar anash ndaj zhvillimeve në shkencë, në krijimtari dhe në shoqëri: Këshillin Kombëtar të Shkencës e kanë udhëhequr njerëzit e Akademisë: dokumenti është bërë para disa viteve, por nuk e ka implementuar askush nga qeveritarët, as dikasteri përkatës!

Me iniciativat e veta Akademia është prononcuar për atë që ka qenë e informuar dhe ka dhënë opinionet e saj për çështje me interes të përgjithshëm përmes organizimit të tryezave dhe konferencave shkencore, botimit të studimeve, prononcimeve për çështje serioze të zhvillimeve në shoqëri (si p. sh. për statusin politiko-juridik të Kosovës, për bisedat e Vjenës 2005-2007, për Veriun e vendit, për Kushtetutën, për Luginën e Preshevës, për Planin e Ahtisarit, për decentralizimin dhe rikomponimin e ri territorial të Kosovës, pastaj për trashëgiminë kulturore, për Regjistrimin

e popullsisë, për bisedat e Brukselit 2013-2016, për Universitetin e Prishtinës etj. Për hyrjen e Kosovës në UNESCO i ka informuar me të dhëna dhe argumente të gjitha vendet anëtare dhe të gjitha akademitë e botës; letra jonë ka hyrë në agjendën e Bordit Ekzekutiv të UNESCO-s. SANU-së, që e kundërshtoi hyrjen tonë në UNESCO, askush nuk i ka dhënë përgjigje si Akademia jonë; këtë e di ish-ambasadori ynë në Paris, prof. Kullashi, që ka punuar ditë e natë për këtë çështje. Brenda mundësive financiare dhe kadrovike, Akademia po zhvillon një bashkëpunim të frytshëm shkencor dhe artistik rajonal, evropian dhe ndërkombëtar, duke afirmuar edhe Kosovën dhe kulturën shqiptare në rajon, në Evropë dhe në botë; ajo ka marrëveshje aktive bashkëpunimi me shumë akademi në rajon dhe në Evropë. Dëshiroj të nënvizoj faktin se me rastin e pranimit të anëtarëve të rinj kurrë nuk ka pasur presion nga askush, mendoj nga udhëheqës, nga politikanë – votoje këtë apo mos e voto këtë apo atë, siç ndodhë në shumë institucione tjera. Pa dyshim që do të kishte pasur presione po t'i kishte pranuar Akademia, por ajo nuk i ka pranuar kurrë – Vetë jemi sovran. Autonomia dhe pavarësia janë një ndër pasuritë më të mëdha që kemi; jemi e vetmja oazë institucionale e pavarur në Kosovë. Gjithkund politika, partitë, grupet e interesit përpiqen të ndikojnë në zgjedhje të niveleve të ndryshme: në Akademi jo, në asnjë mënyrë – Më herët ka pasur përpjekje për ndërhyrje në autonominë dhe individualitetin e Akademisë përmes një Ligji antiakademi dhe antikulturë, por

arritëm ta zmbarsim atë. Prandaj, me votimin që bëmë dhe rezultatin që doli në zgjedhjet e fundit e ngritëm imazhin në nivelin çfarë i takon një themelate, siç është Akademia.

Në votime erdhën të gjithë anëtarët e Akademisë, të rregullt dhe korrespondentë – që rrallë ndodhë. Sikur të gjithë e parandjen një përgjegjësi – se duhet marrë pjesë në seancën zgjedhore për ta hedhur votën e tyre. Ishte vullneti i anëtarëve se ke do ta votonin, por prezenca e tyre në proces tregoi shkallë të lartë të ndërgjegjes ndaj institucionit dhe kandidatëve.

Të nderuara kolege dhe të nderuar kolegë, Ju nuk vini në një mjedis të panjohur; gati të gjithë në forma të ndryshme keni bashkëpunuar edhe më parë me Akademinë në projekte, në botime të veçanta, në revista, në tryeza e debate shkencore dhe artistike, por ajo që e bën të ndjeheni mirë është fakti se vini nga bota akademike, nëpër të cilën kanë kaluar gati të gjithë këta anëtarë këtu, përfshirë edhe ata të cilët nuk janë në mesin tonë. Përveç disa kandidatëve që kanë ardhur nga institutet shkencore dhe bota letrare e artistike, të gjithë të tjerët kanë ardhur nga Universiteti i Prishtinës.

Anëtarë të rinj, edhe njëherë urime dhe suksese!

Ju faleminderit!"

Më pas Kryetari Islami u ndau fletëdëshmitë anëtarëve të avancuar dhe anëtarëve të rinj korrespondentë të Akademisë.

Në emër të anëtarëve të rinj korrespondentë u falënderua prof. dr. Myzafer Limani.



KONFERENCË JUBILARE-SHKENCORE "ME RASTIN E 100-VJETORIT TË LINDJES SË AKADEMIK IDRIZ AJETIT"

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë, organizuan Konferencën jubilarë-shkencore "Me rastin e 100-vjetorit të lindjes së akademik Idriz Ajetit". Konferenca u mbajt më 27 janar 2017, në mjediset e ASHAK-ut. Konferencën e shpalli të hapur akademik Hivzi Islami i cili në fjalën e hyrjes tha:

"Shumë i nderuar Akademik Idriz Ajeti, e nderuar zonja Hajrie dhe familja Ajeti, I nderuar Kryeministër i Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa, I nderuar Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Muzafer Korkuti, Të nderuar miq, Ambasador i Republikës së Shqipërisë, Rektor i UP-së, Drejtor i Institutit Albanologjik, Albanologë të huaj dhe studiues të gjuhës dhe të kulturës shqiptare, Kolegë, zonja, zotërinj, Media të respektuara, Të gjitha kohët e shkuara për shqiptarët ishin të rënda, ndërsa për

intelektualët dhe krijuesit e tyre në gjithë hapësirën gjeoetnike edhe më të ndera. Por dijetarët dhe intelektualët tanë ishin njerëz të tjerë, të veçantë, kontributdhënës, të dinjitetshëm ndaj vetvetes dhe të tjerëve. I donim, i respektonim, mësonim nga veprat e tyre, i konsideronim model të njerëzve të ditur, sepse ishin vërtetë të mëdhenj, nder për kulturën dhe kombin tonë. Profesor Idriz Ajeti është njëri ndër ta, me një të veçantë fatlume për të dhe për ne që pati shëndet të plotë dhe jetë të gjatë, duke shkelur pikërisht sot, më 27 janar, në të njëqindat. Urime profesor dhe rrofshi sa malet! Kur përmendet emri profesor, në mjedisin tonë akademik, kulturor e shoqëror të gjithë e dinë se bëhet fjalë për profesor Idriz Ajetin, sikur në Tiranë që dikur me emrin profesor njihej Profesor Eqrem Çabej. Historia e gjuhësisë, e shkencave albanologjike dhe e kulturës shqiptare nuk mund të merret me mend pa profesor Idriz Ajetin. Prof. Ajeti, me atë lagje të vogël, por të fortë intelektualësh, dijetarësh dhe patriotësh të Kosovës, çfarë ishin Esad

Mekuli, Mark Krasniqi, Ali Hadri, Anton Çeta, Gazmend Zajmi, Dervish Rozhaja, Fehmi Agani e shumë të tjerë, të mbështetur nga faktori politik kosovar i kohës, me punë, mund e sakrificë të mëdha, i ngritën institucionet arsimore e shkencore dhe i mbajtën gjallë veprimtaritë kulturore e shoqërore të Kosovës dhe qenien kombëtare, gjithnjë brenda synimit kolektiv për emancipim dhe përparim të kombit shqiptar. Prof. Idrizi, si doktor i parë i shkencave në Kosovë dhe si intelektual i radhëve të para, kudo që gjendej dhe vepronte, impononte dhe pushtonte me butësinë, qetësinë, shëmbëllesën e mirësisë, optimizmin dhe pamjen prej intelektual.

Profesor Idrizi Ajeti ka një rrugë të ngjeshur jetësore, shkencore dhe intelektuale.

Jetoi, veproi dhe krijoi, thënë kushtimisht, në tri regjime, si tri epoka, në të cilat kombi dhe kultura shqiptare përjetuan zhvillime dramatike: ngritje dhe rënie, prosperitet dhe ngufatje. Ai e përjetoi rrugëtimin e rëndë të Kosovës dhe të shkencave albanologjike në gjithë kompleksitetin e tyre, duke qenë edhe dëshmitar edhe pjesëmarrës, me të gjitha ballafaqimet. I lindur në Tupallë të Medvegjës para një shekulli, ndërsa i shkolluar në Shkup, Zagreb, Pisa, Padova dhe Beograd, i takon gjithë trungut gjeoetnik, gjithë kombit shqiptar dhe tërë kulturës së tij.

Nga fillimet e shkollimit të tij, në vitet e 30-ta e të 40-ta të shekullit 20, nga një gjendje e analfabetizmit kolektiv të shqiptarëve, me ndryshimet politike e shoqërore që do të pasojnë në Kosovë

dhe rreth saj, prof. Idrizi do të gjendet në majat e institucioneve shkencore e kulturore të Kosovës. Ishte themeluesi dhe shefi i parë i Katedrës së Albanologjisë, kryeredaktori i parë i revistave prestigjioze “Gjurmime albanologjike” dhe “Studime”, drejtor i Institutit Albanologjik, dekan i Fakultetit Filozofik, rektor i UP-së, kryetar i ASHAK, ideator kryesor i Seminarit për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare dhe drejtor i parë i tij, kryetar i parë i Këshillit për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut në Kosovë, kryetar i Parlamentit të Republikës së Kosovës në vitet më të rënda për Kosovën dhe shqiptarët, pjesëmarrës i Konferencës së Rambujesë. Për punën e tij shkencore-hulumtuese dhe publike mori shumë mirënjohje dhe dekorata. Me trashëgiminë që po na lë, profesor Idriz Ajeti po lë dhe gjurmë të pashlyeshme në jetën shkencore, kulturore, pedagogjike, kombëtare dhe shoqërore të shqiptarëve të Kosovës dhe të shqiptarëve në përgjithësi në gjysmën e dytë të shekullit XX dhe në fillim të këtij që po e jetojmë. Brezat, pa mëdyshje, do të jenë mirënjohës për trashëgiminë e tij në fushën e dijeve albanologjike dhe në afirmimin e rezultateve të tyre jashtë kufijve kombëtarë e ballkanikë. Vepra e tij shkencore në gjuhësi pa dyshim do të mbetet burim i pashmangshëm reference.

Profesor Idriz Ajeti simbolizon një epokë të albanologjisë, prandaj emri dhe vepra i tij do të rrojnë sa kohë të rrojnë gjuhësia shqiptare dhe shkencat albanologjike.

Ju faleminderit!

Dëshiroj të ju njoftoj se me rastin e 100-vjetorit të Akademik Idriz Ajetit, Kryetari i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi e ka dekoruar profesorin me medalje për merita të jashtëzakonshme në fushën e shkencës, të arsimit dhe të kulturës. Në pamundësi që të vijë sot në këtë eveniment dhe t'ia dorëzojë dekoratën, ajo do t'i jepet me një rast të veçantë.

Në emër të Akademisë, e falënderoj Presidentin për kujdesin dhe respektin që tregoi për Akad. Ajetin. Është ky dhe një respekt për familjen Ajeti, për shkencën, për Akademinë dhe gjithë shoqërinë e dijes.

Faleminderit!"

Pas fjalës së Kryetarit ceremoninë e përshëndetën me fjalë rasti: akademik Myzafer Korkuti, kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, prof. dr. Marjan Demaj, Rektor i UP, prof. dr. Hysen Matoshi, drejtor i Institutit Albanologjik – Prishtinë dhe Prof. dr. Wilfried Fiedler, anëtar i jashtëm i ASHAK-ut. Pas fjalëve përshëndetëse

Konferenca vazhdoi punimet dhe në të dy seancat me kumtesat e tyre u paraqitën rreth 20 studiues nga brenda dhe jashtë vendit.

LIGJËRATË INAUGURUESE E PROF. DR. MENTOR PETRELA

Më 24 prill 2017, ASHAK-ut organizoi ligjëratën inauguruese të anëtarit të jashtëm, profesor dr. Mentor Petrela, me temë: "Transhumanizmi - realitet mitologjik evolucionist?"

Kryetari Islami fillimisht përshëndeti të pranishmit me një fjalë rasti, ku ndër të tjera tha:

"Na ka tubuar sot profesori, doktori e specialisti i shquar dhe organizatori i madh i veprimtarisë shkencore-kërkimore, akademike dhe menaxheriale në fushën e mjekësisë, Prof. Dr. Mentor Petrela, anëtar i Akademisë Botërore të Neurokirurgjisë (World Academy of Neurological Surgery), që ka vetëm 100 anëtarë nga gjithë bota, dhe anëtar i shumë institucioneve dhe asociacioneve



profesionale-shkencore evropiane dhe botërore, tashmë anëtar i jashtëm edhe i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Emri i tij është i njohur dhe i respektueshëm në gjithë botën mjekësore. Me propozimin e Kryesisë së Akademisë sonë të dt. 31.10.2016, prof. Petrela në Kuvendin e Akademisë, të mbajtur më 21 dhjetor 2017, u zgjodh anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Sot do të kemi rastin t'i dorëzojmë dëshminë e anëtarit të jashtëm të Akademisë sonë dhe njëkohësisht të ndjekim ligjëratën e tij. Para kësaj, më lejoni që ta paraqes një tablo të shkurtër të jetës dhe të punës së tij shkencore-hulumtuese.

Prof. dr. Mentor Petrela lindi në Tiranë në vitin 1950, ku e mbaroi shkollën fillore dhe të mesme. Studimet për mjekësi i kreu në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës në vitin 1973, me diplomën "Cum Laude". Studimet specialistike i mbaroi në Universitetin René-Descartes XI të Parisit, ku u kurorezuua me diplomën në fushën e neurokirurgjisë në vitin 1979 dhe në këtë mënyrë në këtë fushë arriti të ngrihej dhe afirmohej edhe jashtë kufijve kombëtarë e rajonalë, duke u bërë pjesë e qarqeve të njohura shkencore-hulumtuese evropiane. Nuk ka dyshim se pa prof. Petrelën neurokirurgjia në Shqipëri do të ishte më e varfër krahasuar me dimensionet dhe cilësinë që i ka dhënë ai sot. Në vitet 1990-1996 ishte shef i Shërbimit të Neurologjisë dhe Neurokirurgjisë të Qendrës Spitalore "Nëna Terezë", ndërsa në vitet 1993- 1997 ishte Drejtor i Përgjithshëm i kësaj Qendre

Spitalore. Nga viti 1994

është profesor i Neurokirurgjisë të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës. Në vitet 1995-2000 ushtroi funksionin e Presidentit të Shoqatës Shqiptare të Neurologjisë, ndërkaq nga viti 1996 gjendet në funksionin e Shefit të Neurokirurgjisë në Qendrën Spitalore Universitare "Nëna Terezë" në Tiranë. Në vitin 1997 zgjidhet President i Shoqatës Shqiptare të Neurokirurgjisë. Në vitet 1999-2002 ishte dekan i Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, ndërsa në vitet 2008-2011 ushtroi detyrën e shefit të Departamentit të Neurologjisë dhe Psikiatrisë. Aktualisht gjendet në detyrën e shefit të Neurokirurgjisë të Qendrës Spitalore "Nëna Terezë" në Tiranë dhe anëtar aktiv në Akademinë Botërore të Neurokirurgjisë dhe në institucione të tjera profesionale-shkencore evropiane. Nga viti 1992 është anëtar nderi i Shoqatës Franceze të Neurologjisë. Në vitin 1996 mori çmimin "Chevalier dans l'Ordre des Palmes Académiques" ("Kalorës i Urdhrit të Palmës Akademike") nga Kryeministri i Francës Alain Juppé. Me Konkurs Kombëtar për Universitetet e Francës në vitin 1997 në Paris zgjidhet Profesor i Neurokirurgjisë. Prej vitit 1998 është anëtar i Federatës Botërore të Neurokirurgjisë (World Federation of Neurological Surgery) dhe i Asociacionit Evropian të Shoqatave të Neurokirurgjisë (European Association of Neurological Societies). Ishte anëtar aktiv i Akademisë Botërore të Neurokirurgjisë (World Academy of Neurological Surgery) me seli në Vjenë, ku mbajti dhe ligjëratë. Në cilësi të

profesorit të ftuar (professeur invité) mbajti ligjërata në Universitetet e Parisit, pastaj të Milanos, Nju-Jorkut, Gjenevës etj. Në vitin 2014 Presidenti i Francës François Hollande ia dha dekoratën më prestigjioze të Francës “Chevalier de la Legion d’Honneur” (“Kalorës i Legjionit të Nderit”). Profesor Petrela publikoi shumë studime në revistat prestigjioze evropiane dhe botërore nga lëmi i neurologjisë dhe neurokirurgjisë.

Në arsyetimin e propozimit që e dhanë Kryesia dhe Komisioni për zgjedhjen e tij anëtar të jashtëm të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, përveç tjerash, thuhet: “Në mbështetje të rezultateve të punës shkencore-kërkimore, teorike dhe praktike, në klasifikimin ndër 100 neurokirurgët më të mirë të botës, në pjesëmarrjen aktive në strukturat botërore akademike dhe shkencore-profesionale, në kontributin e dhënë në kërkimin shkencor nëpërmjet publikimeve e ligjëratave në tubimet shkencore dhe në universitetet prestigjioze të Evropës dhe botës, duke qenë pika e referimit për pacientët në gjithë Shqipërinë dhe trojet etnike shqiptare dhe duke shpëtuar shumë jetë njerëzish, duke qenë organizator i shquar i punës në Shërbimin e Neurologjisë dhe Neurokirurgjisë në Qendrën Spitalore “Nëna Terezë” në Tiranë, në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës dhe si bartës të shumë dekoratave për meritat për punën në lëmin e neurokirurgjisë dhe në mbështetje të Ligjit dhe Statutit të ASHAK-ut -, është kënaqësi që t’i propozohet Kuvendit të Akademisë që

prof. Dr. Mentor Petrelën, anëtar i “Akademisë Botërore të Neurokirurgjisë” (“World Academy of Neurological Surgery”), ta zgjedhë anëtar të jashtëm të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës”. Vepra e tij shkencore-kërkimore dhe puna praktike në sferën e neurokirurgjisë dhe të mjekësisë në përgjithësi do të mbesin pa dyshim burim i pashmangshëm reference për brezat e sotme dhe të ardhshme.

Me të marrë lajmin zyrtar për zgjedhjen e tij anëtar të jashtëm të Akademisë sonë, prof. Petrela e pranoi këtë zgjedhje me respekt dhe falënderim, duke deklaruar: “Jam thellësisht i prekur nga vendimi që ju përcillni në këtë kalim vitesh. Ndjem i privilegjuar dhe pa fjalë”!

Të nderuar anëtarë të Akademisë dhe kolegë të botës shkencore, në fund më lejoni t’i uroj prof. Mentor Petrelës shëndet të plotë, jetë të gjatë dhe punë të frytshme shkencore-hulumtuese dhe ta ftoj të marrë dëshminë e mirënjohjes sonë për punën e tij, duke e zgjedhur anëtar të jashtëm të Akademisë sonë dhe t’ju ftoj të ndjekim bashkë fjalën/ligjëratën e tij me titull “Transhumanizmi – realitet mitologjik, evolucionist”? Profesori e ka zgjedhur këtë temë mjaft intriguese dhe aktuale edhe për shkak të përbërjes heterogjene të audiencës.

LIGJËRATË E AKADEMIK REXHEP ISMAJLIT NË AKADEMINË FRËNGE

Akademik Rexhep Ismajli me ftesë të Académie des Inscriptions et Belles-Lettres, me të cilën ASHAK ka nënshkruar

marrëveshje bashkëpunimi, më 4-7 maj 2017 qëndroi në Paris.

Ftesa nga Akademia frënge Akademik Rexhep Ismajlit iu bë për të mbajtur një ligjëratë për “Dinamikën e shqipes standarde nga vitet ’90 dhe perspektivat e zhvillimeve të saj”.

Para ligjëratës Akademik Rexhep Ismajli u prit nga Sekretari permanent Michel Zinc, ndërsa të pranishëm ishin edhe anëtarët Charles de Lamberterie – koparatist, armenolog i shquar, Jean-Pierre Sodini – arkeolog që ka marrë pjesë në hulumtime në Shqipëri dhe sekretari Hervé Danesi, me të cilët u bisedua për mundësitë e bashkëpunimit të mëtejshëm dhe që të gjithë shfaqën kënaqësi për një mundësi të tillë. Në takim u kërkuar nisma dhe ndonjë propozim eventual, natyrisht, të drejtuar përmes përgjegjësve për harmonizimin e këtij bashkëpunimi – Jean-Pierre Sodini nga Akademia frënge dhe Muhamedin Kullashi nga ASHAK-u.

Ligjëratat “Dinamika e shqipes standarde nga vitet ’90 dhe perspektivat e zhvillimeve të saj” /”La dynamique de l’albanais standard depuis les années 1990 et ses perspectives de développements futurs”/ u mbajt më 5 maj në orën 15:30 në Institut de France, Grande sale des seances. <http://www.aibl.fr/seances-et-manifestations/les-seances-du-vendredi/seances-2017/mai-2017/article/seance-du-5-mai?lang=fr> Seanca u kryesua nga tre anëtarë të Akademisë, një Kryesues, Sekretari permanent dhe një anëtar. Paraqitjen e bëri Sekretari permanent akademiku

Michel Zinc dhe pastaj edhe anëtar i akademisë, gjuhëtari komparatist Charles de Lamberterie. Në seancë morën pjesë rreth 70-80 pjesëmarrës. Pas ligjëratës pati pyetje dhe interesim të shumë anëtarëve. Përshtypja e përgjithshme ishte shumë pozitive. Në fund u afruan më shumë anëtarë për t’u njohur. Ligjëratat zgjatën 30 minuta ekspozim dhe pastaj mbi 30-35 minuta diskutim, gjithsejtë pak më shumë se një orë.

Nga pyetjet që u shprehën publikisht mund të gjykohej se u interesonin zhvillimet dhe e ardhmja e shqipes standarde në fushën e leksikografisë, në fushën e përkthimeve, në letërsi të tjera. Binte në sy që kishte më shumë arkeologë që kishin njohuri për historinë dhe kulturën shqiptare dhe në fund ata patën dhe pyetje të tjera jashtë subjektit të ligjëratës.

Të gjithë diskutuesit shprehën kënaqësi dhe vlerësim si për ligjëratën ashtu edhe për bashkëpunimin me Akademinë tonë.

KONCERT I PËRBASHKËT VEPRASH KAMERALE-MUZIKË DHOMË TË AKADEMIKUT VASIL S. TOLE

Më 18 maj 2017, në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, u organizua Koncerti i përbashkët veprash kamerele-muzikë dhomë të akademikut Vasil S. Tole. Koncertin e shpalli të hapur anëtar i Seksionit të Arteve, i cili në fjalën e tij theksoi se organizimi i koncertit dëshmon përkushtimin e të dy akademive për vazhdimin dhe thellimin



e bashkëpunimit të ndërsjellë. Rreth 24 interpretë dhe instrumentistë ekzekutuan në prani të një publiku të gjerë veprat e akademik Toles dhe me këtë rast sollën një atmosferë të këndshme artistike. Në mbyllje të koncertit akademik Tole falënderoi ASHAK-un për organizimin e shkëlqyer të koncertit dhe gjithë të pjesëmarrësit në sallë.

KRYETARI I AKADEMISË AKADEMIK HIVZI ISLAMI QËNDRON NË VJENË

Me ftesë të Kryetarit të Akademisë Austriake të Shkencave z. Anton Zeilinger, Kryetari Islami qëndroi në Vjenë, më 19 -21 maj, në selinë e Akademisë ku u mbajt sesi Ceremonial vjetor i saj dhe ku ishin të ftuar të gjithë kryetarët e akademive europiane. Ceremonia u përshëndet nga Kryetari i shtetit z. Aleksander Van Der Bellen, Minsitri i Kulturës dhe shumë personalitete të rëndësishme nga jeta shkencore dhe akademike e

Austrisë. Në ceremoni nga ASHAK-u mori pjesë edhe akademik Rexhep Ismajli, kryetar i Këshillit për marrëdhënie ndërkombëtare të ASHAK-ut.

PROMOVIMI I BOTIMEVE TË ASHAK- ut

Promovimi i botimeve të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës u bë më 31 maj 2017, në orën 12:00, në mjediset e Akademisë. Fjalën e hapjes e paraqiti Kryetari Islami, i cili ndër të tjera tha:

“Kolegë dhe miq të nderuar,
Zonja dhe zotërinj,
Media të nderuara,
Sot do të bëjmë promovimin e 40 botimeve origjinale të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës nga fusha të ndryshme: nga shkencat albanologjike, shkencat shoqërore, kulturo-historike, shkencat e natyrës, gjeoshkencat, shkencat e mjedisit dhe



publikimet nga sfera e arteve të realizuara brenda harkut kohor prej më pak se dy vjetëve. Përkundër problemeve të përhershme financiare dhe disa shkurtimeve shtesë që erdhën nga Qeveria për të gjitha zërat financiarë në Kosovë këto kohët e fundit, mund të konstatojmë se me një ekonomizim dhe racionalizim të kujdesshëm të mjeteve Akademia ka arritur ta realizojë këtë objektiv themelor të saj.

Përveç këtyre botimeve, Seksionet dhe trupat e tjera të Akademisë, me bashkëpunëtorë të jashtëm, punuan në disa projekte shkencore hulumtuese, në projekte enciklopedike-shkencore - afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, mbajtën shumë tryeza e konferenca shkencore dhe zhvilluan aktivitete të tjera shkencore dhe artistike (koncerte, ekspozita) dhe realizuan mjaft kontakte ndërkombëtare, përfshirë dhe nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me akademitë simotra

evropiane, si p. sh. me Akademinë e Mbishkrimeve dhe të Letërsisë të Francës (Académie des Inscriptions et Belle Lettres).

Para se t'ua jap fjalën sekretarëve të seksioneve që t'i prezantojnë shkurtimisht botimet e 4 seksioneve, me dy-tri fjalë po i prezantojë botimet e Kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Botimi 40-vjetori i ASHAK-ut përmban historikun e Akademisë, të gjitha fazat e veprimtarisë së saj, me ngritjet dhe rëniet, të ndërlidhura me zhvillimet e përgjithshme shoqërore dhe politike të Kosovës. Janë edhe 3 vjetarë, që secili tregon frymimin e jetës njëvjeçare të Akademisë, me të gjitha informacionet, si dhe Fjalësi shqip i lematizuar i fjalorit serbokroatisht-shqip i Sokol Dobroshit të vitit 1953, si pjesë e projektit "Shqipja e shekullit XX", që mëton të përfshijë korpusin e shqipes së shkruar gjatë këtij shekulli.

Tash shkojmë me radhë: nisim me botimet e Seksionit të Gjuhësisë dhe

Letërsisë, të Seksionit të Shkencave Shoqërore, të Shkencave të Natyrës dhe të Arteve. Fjalën e kanë sekretarët: Eqrem Basha, Jusuf Bajraktari, Fejzullah Krasniqi dhe Luan Mulliqi”.

Më pas secili sekretar i seksionit përkatës paraqiti listën e botimeve dhe disa fjalë për secilin botim.

SHËNOHET 70- VJETORI I LINDJES SË AKADEMIK REXHEP ISMAJLIT NË AKADEMINË E SHKENCave TË SHQIPËRISË

Me iniciativën e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, në mjediset e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë më 8 qershor 2017 u mbajt Konferenca shkencore jubilarë kushtuar 70 -vjetorit të lindjes të akademik Rexhep Ismajlit.

Konferenca ishte përgatitur nga grupi punues i përbërë nga akademikët Floresha Dado, Eqrem Basha, Shaban Sinani dhe anëtari korrespondent Bardh Rugova. Ashtu siç ishte paraparë, Konferenca, e drejtuar nga akademik Floresha Dado, kryetare e Seksionit të Shkencave shoqërore dhe Albanologjike të ASHSH, u zhvillua në tri pjesë: fjalët përshëndetëse të kryetarit të ASHSH-së, akademik Muzafer Korkuti, nënkryetarit të ASHAK-ut akademik Ali Aliu si dhe dekanes së Fakultetit Filologjik të UP-së dr. Lindita Sejdiu Rugova si dhe u lexua fjala përshëndetëse e prof. dr. Françesko Altmarit nga Universiteti i Kozencës, në Kalabri. Në pjesën shkencore me

kumtesa u praqitën: Seit Manasaku, Rrahman Paçarizi, Ethem Likaj, Ajlua Jubani dhe Shaban Sinani. Në pjesën e tretë u përurua libri më i ri i akademik Rexhep Ismajlit, Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik, për të cilën foli anëtari korrespondent Bardh Rugova dhe u lexua vështrimi i akademik Kolec Topallit, i cili mungonte për arsye shëndetësore. Pas diskutimeve një fjalë falënderimi në fund të Konferencës mbajti dhe akademik Ismajli.

Para Konferencës në hollin e sallës së Akademisë ishin ekspozuar veprat e akademik Ismajlit.

ASHAK MERR PJESË NË PANAIRIN E LIBRIT PRISHTINA 2017

Nga data 6-11 qershor, ASHAK-u ka marrë pjesë në panairin tradicional të librit në Prishtinë, "Prishtina 2017." Edhe kësaj here ASHAK-u ka pasur prezantim të suksesshëm. Interesimi i vizitorëve ka qenë i madh dhe janë shitur një numër i madh i botimeve.

AKADEMIK NEXHAT DACI MERR PJESË NË 3rd JOINT SCIENCE CONFERENCE OF WESTERN BALKANS PROCESS/BERLIN PROCESS

Më 14-16 qershor akademik Daci mori pjesë si përfaqësues i ASHAK-ut në 3rd Conference of Western Balkans Process/ Berlin Process, në Paris. Akademik Daci në kuadër të kësaj Konferencie ka paraqitur qëndrimet e ASHAK-ut për çështje të rëndësishme e po ashtu ka realizuar takime të

rëndësishme, që i kontribuojnë zgjerimit të bashkëpunimit ndërkombëtar të ASHAK-ut.

LIGJËRATË INAUGURUESE E AKADEMIK BAHRI BECIT ANËTAR I JASHTËM I ASHAK

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, më 27 qershor 2017, organizoi ligjëratën e anëtarit të jashtëm, akademik Bahri Becit, me temë: "RRETH HISTORISË SË FORMIMIT TË DY DIALEKTEVE TË SHQIPES"

Fjalën e hapjes e mbajti Kryetari i Akademisë, akademik Hivzi Islami, i cili tha:

"Kolegë dhe miq të nderuar, zonja dhe zotërinj,

Jemi tubuar sot këtu, në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës për t'ia dorëzuar Fletëdëshminë e anëtarit të jashtëm të Akademisë sonë, prof. dr. Bahri Becit,

anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Me propozimin e Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të dt. 25. 10. 2016 dhe të aprovuar në Kryesinë e Akademisë të dt. 31. 10. 2016, Kuvendi i Akademisë, i mbajtur më 21 dhjetor 2017, zgjodhi anëtar të jashtëm të Akademisë sonë prof. dr. Bahri Becin, anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Sot do të kemi rastin t'ia dorëzojmë Fletëdëshminë e anëtarit të jashtëm të Akademisë sonë dhe njëkohësisht ta ndjekim ligjëratën e tij me titull "Rreth historisë së formimit të dy dialekteve të shqipes".

Akademik Bahri Beci është emër i njohur në fusha të ndryshme të studimeve albanistike të pjesës së dytë të shek. të kaluar dhe të këtij që po jetojmë, veçanërisht shquhet në fushën e dialektologjisë, të fonetikës së shqipes, të historisë së gjuhës, të studimit të raporteve të shqipes me



gjuhët e Ballkanit, të studimeve gramatikore me konceptime më të moderuara nga ato tradicionalet në Shqipëri, të vështrimeve kritike të veprimtarive shkencore brenda shoqërisë shqiptare etj. Në të gjitha këto fusha pa dyshim ka lënë gjurmë të thella, duke u ngritur dhe afirmuar edhe jashtë kufijve kombëtarë e rajonalë. Si pjesëmarrës gati të rregullt në konferencat, tryezat dhe diskutimet tona shkencore për tema të ndryshme të albanistikës dhe aktivitetet e tjera që i organizon Akademia jonë, e kemi konsideruar gjithnjë si pjesë të rrethit tonë, duke e vlerësuar lart punën dhe kontributin e tij në gjuhësi, në shkencat albanologjike dhe në kulturën shqiptare.

Më lejoni që shkurtimisht të paraqes një tablo të jetës dhe të punës së tij shkencore-hulumtuese. Prof. Beci lindi në Shkodër në vitin 1936, ku mbaroi shkollën fillore dhe të mesme. Studimet e larta për gjuhë dhe letërsi shqipe i kreu në Universitetin e Tiranës, ndërsa studimet pasuniversitare për fonetikë e fonologji i mbaroi në Institutin e Fonetikës dhe të Gjuhësisë Aplikative në Universitetin e Sorbonës në vitet 1975-1977. Aty mori dhe gradën e doktorit të shkencave në temën “Le système vocalique et consonantique du parler de la ville de Shkodra (Albanie du Nord)” (“Sistemi i zanoreve dhe i bashkëtingëlloreve të së folmes së qytetit të Shkodrës – Shqipëria Veriore”). Në vitin 1979 mori gradën shkencore “kandidat i shkencave” me disertacionin “Të folmet e gegërishtes qendrore” dhe titullin “bashkëpunëtor i vjetër

shkencor” në Tiranë. Në vitin 1984 mori gradën tjetër shkencore “Doktor i shkencave” me disertacionin në temën “Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i të folmes së Shkodrës” dhe në vitin 1994 mori titullin Drejtues kërkimesh ose Profesor. Në vitet 1958-1997 ka punuar në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë në Tiranë. Në vitin 1997 ishte pedagog i shqipes në INALCO, në Institutin Kombëtar të Gjuhëve dhe Kulturave Orientale të Parisit.

Prof. Beci ka drejtuar me sukses disa institucione shkencore dhe revista profesionale-shkencore në Shqipëri: sekretar shkencor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, kryeredaktor i revistës “Studime filologjike”, sekretar shkencor i revistës “Studia Albanica”, shef i sektorit të Gramatikës dhe Historisë së Gjuhës Shqipe, drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, anëtar i Këshillit drejtues të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, nënkryetar i Komitetit Kombëtar të Shoqatës Ndërkombëtare të Studimeve të Evropës JL (AIESSE), anëtar i Këshillit të Politikës Shkencore dhe të Zhvillimit Teknologjik pranë Këshillit të Ministrave etj. Për punën e tij shkencore dhe organizative ka marrë disa dekorata dhe shpërblime, si medaljen e Kuvendit Popullor “Naim Frashëri”, titullin Presidencial “Për merita të Veçanta Civile” etj. Ka dhënë kurse të nivelit universitar e pasuniversitar në universitetet e Tiranës, të Shkodrës, të Prishtinës, të Napolit, të Kozencës, të Shkupit, të StPetersburgut, të Parisit etj. për dialektologji, fonetikë, fonologji,

gjuhësi të përgjithshme. Ka drejtuar edhe disa kandidatë në studimet e doktoratës.

Profesor Beci ka publikuar shumë libra shkencorë dhe studime e trajtesa në revistat prestigjioze në Shqipëri dhe në botën e jashtme, si në Austri, Gjermani, Francë, Itali, Greqi, SHBA, Maqedoni, Poloni, Rusi dhe në Kosovë nga fushat që u zunë në gojë më lart. Është bashkëkoautor i “Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe” dhe i “Atlasit gjuhësor evropian”.

Lidhjet e akademik Becit me Kosovën dhe mjediset shkencore e kulturore në Kosovë ishin të vazhdueshme qysh nga vitet e 70-ta të shek. XX. Përveç botimeve që ka bërë në Kosovë, ai ka dhënë një ndihmesë dhe për hartimin e teksteve të përbashkëta të gjuhës shqipe, por edhe për punë e përbashkët në Seminarin Ndërkombëtar të Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Shqiptare: në vitet 1995-1996, kur Seminari nuk mund të mbahej në Prishtinë për shkak të rrethanave tejet të rënda, ndihmesa e tij që vendimtare për realizimin e këtij projekti të përbashkët në Tiranë.

Të nderuar anëtarë të Akademisë dhe kolegë të botës shkencore, më lejoni në fund t’i uroj prof. Bahri Becit shëndet, jetë të gjatë dhe punë të frytshme shkencore-hulumtuese, duke pritur vepra të reja kështu kuptimplote dhe të rëndësishme për shkencën dhe kulturën tonë dhe ta ftoj të marrë dëshminë e mirënjohjes sonë për punën e tij, duke e zgjedhur anëtar të jashtëm të Akademisë sonë dhe t’ju ftoj të ndjekim bashkë ligjëratën e tij me titull “Rreth historisë së formimit të dy

dialekteve të shqipes”.

Më pas në praninë e anëtarëve të Akademisë dhe shumë pjesëmarrësve akademik Beci paraqiti ligjëratën e tij.

ASHAK PËRKUJTOI REOBERT ELSIE

Më 4 tetor 2017 ASHAK mbajti mbledhje përkujtimore me rastin e ndarjes nga jeta të albanologut Robert Elsie.

Mbledhjen e hapi Kryetari Islami i cili tha :

“Të nderuar kolegë dhe miq,

Me 2 tetor 2017 u shua njëri nga albanologët më në zë të kohës sonë, kanadezi me banim në Europë, kryesisht në Gjermani, studiuesi, përkthyesi, hulumtuesi i palodhshëm i arkivave dhe dokumenteve të hershme që dëshmojnë kulturën dhe traditën e lashtë shqiptare në këto troje, Dr. Robert Elsie, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës që nga viti 2000.

Ju ftoj që me një minutë heshtje të nderojmë personalitetin e tij!

Lavdi!

Dr. Robert Elsie ishte jo vetëm studiues dhe hulumtues i gjithanshëm, por edhe miku dhe kolegu ynë, i afërt dhe i pranishëm në shumë aktivitete të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, i angazhuar dhe i përkushtuar për të na mbajtur krahun edhe në momentet më të vështira. E kemi konsideruar gjithnjë si pjesë të rrethit tonë. Veprimtaria e dr. Elsie-t dhe interesimet e tij për gjuhën, letërsinë, historinë dhe traditën shqiptare janë aq të gjera sa ndonjëherë kapërcenin dhe kufijtë



disiplinorë. Në kërkimet e tij në arkiva dhe dokumente të hershme ai mbledhte, sistemonte dhe publikonte kontribute të veçanta, nga ato gjuhësore, historike, etnografike deri te zhvillimet më të reja të artit dhe të letërsisë sonë. Veçanërisht për ne janë të rëndësishme interesimet e tij për Kosovën, studimet e gjithanshme dhe përkthimet e autorëve tanë në gjuhë të tjera. Janë të shumtë botimet e hartuar apo të përgatitur nga Elsie që panë dritën edhe tek botuesit kosovarë në shqip, apo në gjermanisht, frëngjisht e anglisht dedikuar lexuesve të huaj apo komunitetit ndërkombëtar në Kosovë. Dr. Elsie mbetet pa dyshim përhapësi më i madh i kulturës shqiptare në botë”.

Më pas për jetën dhe veprën e Dr. Robert Elsie foli akademik Rexhep Ismajli, i cili tha:

“U SHUA ROBERT ELSIE.

HUMBJE E MADHE PËR KULTURËN DHE SHKENCËN.

Më 2 tetor 2017 në Bonn të Gjermanisë u nda nga jeta gjuhëtari, intelektual, keltologu, poliglotti, albanologu, studiuesi frymëgjatë i gjuhës dhe i kulturës shqiptare, përhapësi i pashoq i vlerave të saj, prezantuesi i historisë së dokumentuar të popullit shqiptar, përkthyesi i zellshëm i letërsisë shqipe në gjuhët angleze dhe gjermane, përkthyesi i letërsisë greke në gjuhën gjermane, miku i madh i botës shqiptare, anëtar i jashtëm i ASHAK-ut, dr. Robert Elsie.

Ndryshe nga kohët kur me Robertin komunikonim nga larg lidhur me projektet e punës, shumë shpesh dhe lidhur me gjendjen që na kishte kapluar në vitet '90 të sh. XX, në kohë më të vona që bërë e zakonshme të komunikonim për projektet e radhës në fushën e studimeve shqiptare. Sapo mbaruam diskutimet për përkthimet e biblës nga Toghri, për botimin e origjinalit me transliterim dhe përkthim anglisht në vizitën e tij në nëntor 2016,

Roberti më çonte dorëshkrimin për alfabetet e shqipes, libër që ndërkohë doli nga shtypi po ashtu. Javën që shkoi po komunikoni lidhur me programin e Konferencës së këtij muaji për studimet albanistike në botën ku flitet gjermanishtja, dhe po bënim llogari për bashkëpunime të mëtejme, Roberti nuk përtoi të çonte mesazhin vlerësues për përgatitjet e konferencës, por njëherësh tregonte se ndodhej në spital dhe nuk e dinte nëse do të ishte në gjendje të vinte vetë. Vetëm tri ditë pas kësaj na erdhi kumti i zi. Krejt i papritur dhe në valën e aktivitetit të tij, në kulmin e pjekurisë intelektuale me horizont të pritjes reale për shumë vepra me vlerë që do të na sillte. Si gjithnjë, në takimet e fundit në nëntor që i qetë, i afërt, plot kërshtëri dhe bindje për punët në vijim.

Në Arkivin e Akademisë, gjeta motivimin për pranimin e Robert Elsie-s anëtar të jashtëm të ASHAK-ut të fundit të tetorit të vitit 2000, ku, ndër të tjera shkruhej: “veprimtaria e dr. Robert Elsie është e shumanshme dhe e gjerë. Ndhimesat e tij në fushën e albanologjisë janë të rëndësishme, sidomos në fushën e studimeve historiko-letrare, po edhe në fushën e historisë së kulturës. Informimet e shumta dhe shpesh depërtimet në institucione, biblioteka apo mjedise të tjera ku mund të gjenden vlera të shkruara jo mjaft të njohura për kulturën dhe historinë shqiptare ia shtojnë edhe më shumë peshën punës së tij tejet të frytshme... Për kulturën shqiptare rëndësi të veçantë ka dhe puna e tij në përkthimin, përhapjen dhe interpretimin e vlerave të letërsisë dhe

të kulturës shqiptare nëpër botë, por nuk duhet të harrohet as ndihmesa e tij e drejtpërdrejtë për afirmimin e çështjes së Kosovës. Nuk ka dyshim se të gjithë punën e tij albanologjike e shquan një dashuri e jashtëzakonshme për kulturën dhe për popullin shqiptar”. Thelbi i këtij vlerësimi të bërë 17 vjet të shkuara në Kosovën e sapo dalë nga lufta sot vjen e rritet ndjeshëm, për të na bërë më të rëndë ndjenjën e humbjes së tij të parakohshme.

Robert Elsie lindi në Vankuver të Kanadasë më 1950, ku bëri studime për filologji klasike dhe gjuhësi, për të vazhduar më tej paralelisht me studime për gjuhësinë e krahasuar dhe nxënien e gjuhëve të ndryshme, ku hynin frëngjishtja, spanjishtja, gjermanishtja, italishtja, rusishtja, gjuhët baltike, gjuhët keltike, greqishtja, më vonë dhe gjuhët e tjera të Ballkanit, përfshirë shqipen, që u bë përqendrimi i tij më frymëgjatë. Në Universitetet e Berlinit, të Bonit e të Parisit studioi dhe sanskritishten, bretonishten, apo gjuhët e zhdukura të Europës jugore. Specializimin në gjuhësi të krahasuar e përfundoi me tezën e doktoratës për Raportet dialektore në goidelikshte, studim në dialektologjinë kelte në Bonn, që u botua më 1986. Në Bonn studimet për gjuhësinë e krahasuar në atë kohë i drejtonte Johann Knobloch, gjuhëtar i shquar, ish-nxënës i N. Jokl-it. Kontaktet e tij me botën shqiptare në Tiranë e në Prishtinë i hapën Robertit një horizont të ri interesimesh - atë të gjuhës shqipe. Kështu keltologu mori udhën drejt albanologjisë. Nga vitet 1978/79 Roberti, me gjithë angazhimet

e tjera, po zhytej gjithnjë e më shumë në studimet për shqipen dhe shqiptarët. Paralelisht ndërmerre vizita në Tiranë dhe në Prishtinë, sidomos në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, po edhe në veprimtari të tjera. Me kohë u specializua në fushën e përkthimeve, qoftë në veprimtaritë konkrete, apo edhe gjithnjë e më shumë në fushën e letrave dhe të kulturës. Përkthimet simultane R. Elsie i ka ushtruar në kontaktet qeveritare gjermano-shqiptare, po më vonë sidomos për nevojat e Gjykatës së Hagës, të NATO-s, të BE-së e të Këshillit të Europës dhe të instancave të ngjashme të niveleve më të larta ndërkombëtare.

Profili i tij prej studiuesi është i gjerë, kështu që ndihmesat e tij në albanologji shtrihen në shumë aspekte, në radhë të parë në fushat e studimit të letërsisë, të studimit të kulturës, të folklorit dhe të mitologjisë shqiptare, në fushën e gjuhës, etj. Njihet si hulumtues këmbëngulës i dokumenteve dhe i dokumentimit të historisë shqiptare dhe i botimit të dokumentacionit në origjinalin e tij, po shpesh dhe me përkthime qoftë anglisht, qoftë shqip. Në fushën e studimeve letrare ai njihet me veprën e tij Historia e letërsisë shqiptare anglisht të botuar më 1995 në 2 vëllime te Boulder dhe të shpërndarë nga Columbia University press në New York. Kjo vepër u përkthye dhe u botua te Dukagjini më 1997 me përhapje në tërë hapësirën shqiptare. U përkthye polonisht për nevoja të studentëve të Universitetit të Torunjit. Mëtesa e autorit ka qenë të

bënte një vepër gjithëpërfshirëse, nga fillimet e shkrimit shqip e deri sot, të paanshme, e mbi të gjitha me shënime sa më të plota e bibliografi shumë të pasur, në shumë aspekte shteruese. Tek i njëjti botues ai nxori më 1996 veprën Studies in Modern Albanian Literature and Culture me studime e recensione për letrat shqipe të botuara më parë në World Literature Today (ka një botim shqip te Buzuku, Prishtinë, 1995). Një version të shkurtë të Albanian Literature. A Short History, e botoi në Londër më 2005. Në këto vepra ai ka bërë sintezën e punës së tij shumëvjeçare me paraqitjen e letërsisë shqipe në botë.

Aspekt tjetër të studimeve të tij paraqesin hulumtimet për folklorin, kulturën popullore dhe mitologjinë, për çka po ashtu ka lënë vepra me vlerë. Te New York University Press ai më 2001 botoi veprën dyvëllimëshe A Dictionary of Albanian Religion, Mythology, and Folk Culture, për të vazhduar me serinë e veprave të karakterit enciklopedik shumë të rëndësishme për përhapjen e dijes dhe të ideve për popullin, kulturën dhe gjuhën shqipe: Historical Dictionary of Albania, Oxford 2004, Historical Dictionary of Kosova, Oxford 2004 me botime të zgjeruara më 2011, A Biographical Dictionary of Albanian History, London, etj.

Një aspekt me shumë rëndësi në punën e Robert Elsie-s paraqet veprimtaria e tij shumë e gjerë në fushën e mbledhjes dhe të botimit të dokumentacionit për historinë dhe zhvillimet ndër shqiptarë, të paraqitur dhe në gjuhën angleze. Në këto hulumtime të tij mbisundon vështrimi gjithëshqiptar, trajtimi i botës

shqiptare nga një vështrim i jashtëm, por si një tërësi. Në këtë fushë do të veçoja librin e vitit 1997 të botuar në Nju Jork "Kosovo in the Heart of the Powder Keg", ku botës iu paraqitën jo vetëm pikëpamjet e shqiptarëve, po edhe dokumentet e programet përmes të cilave dëshmohen zullumet gjenocidale ndaj shqiptarëve dhe projektimet nga instanca shtetërore të spastrimeve etnike, si ato të E. Durham, të Leo Freundlich, të Gj. Bisakut-Sh. Kurtit-L. Gashit, të V. Čubrilović-it, e të I. Andrić-it. Pastaj veprën *Early Albania. A reader of Historical Texts 11th-17th Centuries*, Wiesbaden, 2003 dhe librin me dokumente për fatin e çamëve dhe të gjenocidit ndaj tyre, të përgatitur bashkë me B. Destanin "The Cham Albanians of Greece", London 2013. Robert Elsie ka botuar dhe një varg veprash të tjera në këtë fushë dhe ka qenë vazhdimisht i angazhuar në përhapjen e së vërtetës së shqiptarëve edhe në kohët më të vështira për Kosovën. Në një prej reagimeve të tij publike për gjendjen në Kosovë në Londër e në New York më 1992, të pare nga Hotel Grand i Prishtinës, Elsie vlerësonte: "The spectre of nazi Germany arose before me as I watched the guests... I pictured myself in the 1930s in an elegant restaurant in Berlin... in a hotel recently made judenfrei".¹ Dhe nuk pushoi së ndihmuari gjithandej dhe me të gjitha fuqitë e tij për çlirimin nga gjendja ku ishte pllakosur Kosova. Informimi i drejtë, i plotë dhe i paanshëm e në instancat ku duhej ishte bërë punë e tij e ditës.

Një aspekt me shumë vlerë të punës së tij hulumtuese paraqet botimi i veprave më pak të njohura apo të mbetura dorëshkrim nga e kaluara, ndër të cilat do të shquaja botimin e Kujtimeve të Baron Nopçës, të Historisë së Shqipërisë të Faveyrial-it, etj. Më duket se me rëndësi jo të vogël janë ndihmesat e tij në gjurmimin dhe botimin e fotografive të hershme nga bota shqiptare, punë që deri tash ka mbetur unikale.

Si studiues Elsie ishte formuar për gjuhësi krahasuese indoeuropiane. Në fillimet e tij shqipen e shihte më parë në këto suaza, por shumë shpejt iu kthye një kuadri më të përgjithshëm të studimeve të shqiptare. Rëndësi kanë studimet e tij për aspektet kulturore dhe të shkrimit të hershëm të shqipes, të dokumentimit të hershëm, por edhe studimet për emrat e lumenjve, apo ato për shqipen tek E. Çelebi. Pak para vdekjes ai na la dhe dy vepra për këto aspekte: "Early Albanian Bible Translations in Todhri Script", London 2016, në të cilën sjell kopjen që ia doli ta gjente në arkivat për von Hahn, e që mendohej të ishte zhdukur. Ai kështu sjell një zbulim të rëndësishëm për shkrimin origjinal të sh. 18 nga Todhri, pastaj "Albanian Alphabets: Borrowed and Invented", London, 2017, ku jep një pasqyrë të gjithanshme të alfabetëve me të cilat u shkrua shqipja. Është marrë dhe me leksikun e besimeve dhe të mitologjisë, etj. Këto kohët e fundit, në kuadër të punës së tij të gjerë për paraqitjen e kulturës dhe të botës shqiptare përmes internetit, ai hapi dhe një sajt "Albanian Language", ku jepen shënime hyrjeje për gjuhën

shqipe, me elemente të dëshmime historike. Aty ka dhe një nismë shumë të lavdërueshme lidhur me dialektet e shqipes: ai ka sjellë një material audio për të folme shqipe të mbi 150 pikave, qoftë të vjela nga ai vetë, qoftë nga të tjerë.

Ndihmesat e Robert Elsie-s për njohjen ndërkombëtare të kulturës dhe të botës shqiptare kanë qenë të jashtëzakonshme dhe në drejtime të ndryshme. Do të përmendja me këtë rast përkthimet e tij gjermanisht të veprave Migjenit, të tregimtarëve të sh. XX, por pastaj sidomos anglisht të veprave të Migjenit, të E. Koliqit, të F. Brovinës, të A. Podrimjes, të Gj. Fishtës, të këngëve kreshnike, të E. Bashës, të F. Kongolit, të tregimeve shqiptare, të V. Zhitit, të A. Shkreli, të J. Nezirajt, e të tjerë. Sukses më vete paraqet përkthimi i kryeveprës "Lahuta e Malcís". Le të përmendim rrugës se ai ka përkthyer gjermanisht veprën e plotë të poetit të madh grek Konstatntin Kavafis, ashtu si dhe poezinë sorabe. Përveç përkthimeve në vepra të veçanta, ai ka bërë shumë përkthime të tjera nëpër revista të ndryshme në Gjermani, në Amerikë, etj. Ka përhapur informacione për letërsinë shqiptare nëpër të gjitha hapësirat e mundshme ndërkombëtare, po edhe përmes internetit në sajtin e tij Albanian Literature in Translation, ku përfshihen shumë vepra që dalin për herë të parë anglisht. Kur jemi te sajti, do të doja të përmend me këtë rast punën e tij jashtëzakonisht shumë të dobishme në sajtet Albanian Art, Texts and Documents of Albanian History, Early

Photography in Albania. Në këtë pikë ai ka qenë një hap më përpara se të gjithë ne që merremi me studime të këtij lloji, duke përfituar nga përparësitë e teknologjisë së kohës për përhapjen e pakonkurrencë të dijeve e të informacionit për kulturën, gjuhën, letërsinë dhe botën shqiptare.

Robert Elsie-n e njoh nga viti 1979, kryesisht nga Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, nga konferencat e ndryshme shkencore ndër ne dhe në botë, nga takimet në vizitat e tij në Kosovë. Ishte njeri jashtëzakonisht i qetë, i vëmendshëm dhe i interesuar. Ishte i saktë dhe i përgjegjshëm për punën që bënte. Ishte dashamirës dhe kishte dëshirë të ndihmonte, prandaj dhe kishte zënë shumë miqësi me shqiptarët gjithandej.

Gjatë ditës së djeshme kemi marrë telefonata nga studiues arbëreshë për të shprehur ngushëllimet e tyre (e dinin se ishte anëtar i jashtëm i Akademisë sonë) dhe keqardhjen për humbjen e një njeriu kaq të dashur dhe për arbëreshët.

Shuarja e tij është një humbje e madhe për albanologjinë në përmasat ndërkombëtare, është humbje e një miku të madh të botës shqiptare, e një dijetari të papërsëritshëm. Vepra e tij do të vazhdojë të rrezatojë dritë, dije e informacion për botën shqiptare.

I qoftë i lehtë dheu që do ta mbajë".



MBAHET EKSPOZITA PERSONALE E AKADEMIK REXHEP FERRIT

Me rastin e 80- vjetorit të lindjes të akademik Rexhep Ferrit, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës organizoi ekspozitën personale.

Në të u paraqitën vepra të shumta të akademik Ferrit, të realizuara në tapiceri dhe disa piktura të reja.

Fjalën e hapjes e mbajti sekretari i Seksionit të Arteve anëtar korrespondent Luan Mulliqi, i cili e vlerësoi lartë punën e akademik Ferrit. Në fund autori para një auditoriumi të gjerë, me fjalë të bukura e plot emocion, falënderoi Akademinë për organizimin e Ekspozitës dhe të gjithë të pranishmit në sallë.

Hapja e Ekspozitës u bë më 10 tetor 2017 dhe qëndroi e hapur deri më 23 tetor 2017.

ASHAK MERR PJESË NË SHËNIMIN E 50-VJETORIT TË THEMELIMIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË MAQEDONISË

Në këtë jubile, që u organizua në Shkup, më 9 tetor 2017 morën pjesë kryetari i ASHAK-ut, akademik Hivzi Islami dhe nënkryetari akademik Ali Aliu.

Kryetari Islami me këtë rast përshëndeti ceremoninë me një fjalë rasti, si më poshtë:

“Cher M. le Président de l’Académie Macédonienne des Sciences et des Arts, de MANU

Mesdames et Messieurs membres de l’Académie,

Chers Collègues,

Mesdames et Messieurs,

Permettez-moi de Vous présenter, au nom de l’Académie des Sciences et Arts du Kosovo, les félicitations les plus cordiales, à l’occasion du 50- ième anniversaire de la fondation de



l'Académie Macédonienne des Sciences et des Arts. Votre Académie, durant ce demi-siècle, a apporté une contribution très importante pour le développement des sciences et des arts, pour l'approfondissement de la pensée scientifique,

pour l'élargissement des connaissances et des valeurs culturelles.

Nos deux Académies cultivent la liberté des recherches dans les domaines des sciences et arts, selon les meilleures traditions européennes. Notre Académie, tout en étant plus jeune, a réussi également à développer une coopération fructueuse avec de nombreuses Académies et Instituts scientifiques de la région et de l'Europe, notamment avec ALLEA.

Avec l'Académie Macédonienne des Sciences et des Arts, à l'appui de l'Accord de Coopération, nous travaillons ensemble, à travers un dialogue ouvert scientifique, autour de différents thèmes qui sont pertinents

pour nos sociétés. La coopération de l'Académie du Kosovo avec Votre Académie, a, de même, un intérêt particulière qui tient au fait d'une présence d'une population importante autochtone albanaise qui aspire à être représentée par des scientifiques et des artistes afin de développer et affirmer ses valeurs culturelles également par l'Académie.

Nous vivons dans un temps qui est à l'épreuve des problèmes complexes et multidimensionnels de la civilisation contemporaine, qui concernent autant le présent que l'avenir de l'humanité. Face à ces défis et problèmes, la coopération et le travail commun dans différentes formes, des Académies s'avère, naturellement, nécessaire et exigeante afin de faire face aux problèmes qui marquent les sociétés contemporaines. Les Académies, à travers la coopération qui implique des débats scientifiques fructueux, peuvent contribuer aux

rapprochements des peuples par une meilleure connaissance réciproque de leurs cultures et en cultivant également la culture de la paix et de la tolérance, qui ouvrent de nouvelles perspectives pour le développement de nos Balkans, si souvent agités. Nos institutions scientifiques et artistiques devraient tenir à l'écart les discours empreints de préjugés et de haine, qui ont par ailleurs, produits des effets néfastes.

Nos efforts pour le développement des recherches scientifiques sur les questions qui travaillent nos sociétés, à différents niveaux, exigent des soutiens importants financiers, comme vous le savez.

Chers amis, je voudrais de nouveau vous féliciter pour le 50-ième anniversaire de Votre Académie, vous souhaitant beaucoup d'autres anniversaires, avec des succès encore plus importants.

Cher Monsieur le Président, permettez-moi, à cette occasion, au nom de l'Académie des Sciences et Arts du Kosovo, de Vous faire le don d'une peinture d'un de nos peintres les plus célèbres, M. Gjelo Gjokaj. Merci".

ASHAK PREZANTON BOTIMET E VETA NË PANAIRIN E FRANKFURTIT

Nga data 11 deri 16 tetor është mbajtur Panairi Ndërkombëtar i Frankfurtit, më i madhi i këtij lloji në Evropë. ASHAK-u është paraqitur në këtë panair me 20 botimeve të reja. Sikurse në vitet e mëhershme, në pamundësi për të marrë pjesë është autorizuar Shoqata e Botuesve të Kosovës të prezantojë botimet e ASHAK-ut.

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS BËHET ANËTARE E UNIONIT NDËRKOMBËTAR (Union Académique International)

Unioni Ndërkombëtar Akademik (Union Académique International), në Asamblenë e Përgjithshme të mbajtur në Tokio të Japonisë, të hënën, më 23 tetor 2017 pranoi në radhët e veta, me të drejta të plota, Akademienë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, të kandiduar sipas rekomandimeve me shkrim të Académie des inscriptions et Belles Lettres të Francës, Akademisë së Shkencave të Austrisë dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, të mbështetur gjithashtu me shkrim nga Akademia e Polonisë, e Maqedonisë, etj.

Fletëdëshmia e anëtarësimit të ASHAK në UAI iu dorëzua anëtarit korrespondent të ASHAK, Muhamedin Kullashi, deleguar në këtë Asamble të Përgjithshme.

Unioni Ndërkombëtar Akademik është organizatë botërore e akademive nacionale në fushën e dijeve humane dhe të shkencave sociale. I themeluar më 1919 në Paris, me një sekretariat të përgjithshëm të vendosur në Bruksel, sot Unioni tubon rreth vetes mbi 100 akademi nga 63 vende të të gjitha kontinenteve.

Të kujtojmë se ASHAK-u është anëtare e rregullt me të drejta të plota dhe tejet aktive e ALLEA-s (All European Academies), Federatës së Akademive Nacionale të Europës, që nga viti 2004, anëtare e Interacademic Panel (IAP), e Unionit të Akademive të Europës Juglindore, e Interacademic Human Right Network, me seli në Nju Jork, etj.



NËNSHKRUHET PROTOKOLLI I BASHKËPUNIMIT MIDIS ASHAK-ut DHE ASHSH-së

Më 24 tetor 2017, në Tiranë u nënshkrua Protokoli i nënti i radhës i bashkëpunimit kërkimor-shkencor dhe artistik midis Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për vitet 2018-2020. Protokoli për këtë periudhë dyvjeçare përfshin një gamë të gjerë temash, projektsh, botimesh, tryezash dhe konferencash të përbashkëta nga shkencat albanologjike, kulturo-historike, nga shkencat shoqërore, të natyrës dhe nga fusha e arteve. Me protokoll parashihet të mbahen disa konferenca dhe tryeza shkencore për tema të rëndësishme shkencore dhe artistike, si dhe të shënohen përvjetorë për ngjarje të ndritshme të popullit shqiptar, si për 550-vjetorin e vdekjes së Skënderbeut, figurës së shekujve të humanizmit

evropian, për 140-vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, 100-vjetorin e Komitetit “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”, 110-vjetorin e Kongresit të Manastirit etj., pastaj ligjërata të ndërsjella të akademikëve dhe punonjësve shkencorë për çështje të rëndësishme dhe aktuale shkencore dhe artistike, të bëhet përirimi dhe këmbimi i rregullt i literaturës dhe informatave etj.

Protokoli u nënshkrua nga dy sekretarët shkencorë, akademik Isuf Krasniqi dhe akademik Vasil Tole.

MBAHET KONFERENCA NDËRKOMBËTARE SHKENCORE: STUDIMET ALABNISTIKE NË VENDET KU FLITET GJERMANISHT (Albanistische Forschungen in den Deutschsprachigen Ländern)

Konferencë ndërkombëtare shkencore, e organizuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës



dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë, e mbajtur me datë 26 dhe 27 tetor 2017 në mjediset e ASHAK. Konferenca, pjesë e Protokollit të bashkëpunimit midis ASHAK dhe ASHSH, e mbështetur edhe nga Ministria e Kulturës, për akomodimin e pjesëmarrësve nga jashtë, u përgatit nga Këshilli Organizues i drejtuar nga akademik Rexhep Ismajli. Duke qenë një nga aktivitetet më të gjera dhe më komplekse të realizuar nga Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i ASHAK-ut, Konferenca, që tuboi emra të njohur studiuesish, jo vetëm në vendet ku flitet gjermanisht, por edhe nga Kosova, Shqipëria dhe disa vende të tjera të Europës, solli kontribute të rëndësishme shkencore. Ajo u zhvillua në shtatë seanca me rreth 50 kumtues, shoqëruar me diskutime të gjera, që do të botohen në një vëllim të veçantë brenda vitit 2018.

Në fund të Konferencës akademik Rexhep Ismajli, në fjalë e tij

përmbyllëse tha:

“Të nderuar miq dhe kolegë, është kënaqësi që pas dy ditësh pune kaq intensive ta mbyll këtë konferencë kaq interesante dhe në një nivel kështu të lartë shkencor. Para dy vjetësh patëm organizuar në ASHAK një konferencë për studimet albanistike në Amerikë dhe, me gjithë dyshimet e fillimit, doli se kishte shumë interes, kështu që konferenca doli me sukses dhe në fund patëm dhe një botim të bukur me punimet e saj. Pastaj vendosëm që bashkë me Akademinë e Shqipërisë të organizonim këtë konferencë për studimet albanistike në botën ku fli-tet gjermanisht. Këtë herë përgatitjet nisën pak më herët dhe u nisën njoftimet. Sinonim të bënim një pas-qyrë të këtyre studimeve, gjithë duke problematizuar pika të veçanta dhe në fund të nxirrnim edhe ndo-një përfundim.

Programi i konferencës qe shumë i begatshëm dhe kumtesat ishin në një

nivel të lartë shkencor, me shumë informata dhe analiza të reja. Të gjithë bashkë kemi mësuar gjëra të reja nga kjo konferencë. Në ditën e parë patëm nderin të dëgjonim ligjërata nga disa prej autoriteteve në fushat tona që vinin nga vende të ndryshme: Austri, Gjermani, Itali, Zvicër, Shqipëri, Kosovë. Pastaj patëm rastin të dëgjonim një seancë të tërë për studimet në botën gjermanishtfolëse për arbëreshët, të Italisë dhe të Greqisë, po ashtu me raportues shumë të cilësuar nga Italia, nga Zvicra, nga Gjermania, nga Kosova. Në vijim pati shumë kumtesa me interes nga studiues të brezave të ndryshëm dhe na gëzon fakti se midis nesh kishte një numër të mirë studiuesish të rinj me cilësi të larta hulumtuese, me formim e integritet shkencor dhe ata po punojnë barabar me brezin tjetër jo aq të ri.

Në konferencë u mbajtën 7 seanca me gjithsej 55 kumtesa nga vende të ndryshme (Gjermani, Austri, Zvicër, Itali, Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, Greqi, Hungari). U shqyrtuan çështje nga më të ndryshmet të studimeve albanistike në botën gjermanishtfolëse, duke filluar nga çështja e për-caktimit të vendit të gjuhës shqipe brenda gjuhëve indoeuropiane, prejardhja dhe his-toria e saj, studimet për strukturën e saj, për mësimdhënien dhe gramatikën e teksteve shkollorë mësimore, për studimet për le-tër-sinë shqipe e çështje të tjera nga këto komplekse veprimtarish. Pati shumë interesim dhe për kumtesat në fushën e historisë dhe të arkeologjisë, që ishin më të pakta në numër.

Studimet albanistike në botën gjermanishtfolëse kanë tashmë një traditë treshekullore dhe në periu-dha të caktuara kanë përjetuar zhvillime të rëndësishme. Do të kujtojmë me këtë rast emrat e mëdhenj si F. Bopp, G. Meyer, H. Pedersen, N. Jokl, G. Weigand, M. Lambert, G. Stadtmüller, O. Buchholz, e shumë të tjerë, që tashmë i takojnë historisë së këtyre studimeve. Po kaq me rëndësi ish-te prania e një numri jo të vogël autoriteteve në këto dije, qoftë nga bota gjermanishtfolëse, apo nga bota shqiptare. Në këtë mënyrë të gjithë së bashku, gjithë duke shënuar rezultatet që janë arritur në këto dije, u angazhuam dhe në një dialog konstruktiv dhe krijues për çështje të ndryshme. Ishte konstatim i përgjithshëm se rezultatet kaq të mëdha të albanistikës në gjuhën gjermane, ashtu si dhe studimet shqiptare në këto fusha, na obligojnë të angazhohemi edhe më shumë në shqyrtime e ndër-marrje të përbashkëta, në mënyrë që të evitohen mun-gesat eventuale që mund të dalin nga komu-nikimi i pamjaftueshëm. U konstatua me kënaqësi se tashmë kemi një brez që po vjen me njohje jo vetëm të studimeve albanistike, por edhe me përgatitje për gjuhët, sidomos për gjermanishten, çka krijon rrethana më të përshtatshme për një komunikim më të ngjeshur brenda komunitetit albanistik.

Njëherësh mund të themi se ishte mendim i përgjithshëm që, për ta ruajtur dhe ushqyer më tej këtë traditë të madhe albanistike, është e nevojshme të ndërmerren hapa që

studimet albanistike në botën gjermanisht-folëse të organizohen institucionalisht, në mënyrë që t'u dalin përpara sfidave që ka nxje-rrë gjendja që kemi tash në botën shqiptare me një gjuhë të veçantë dhe kulturë të zhvilluar brenda saj, një gjuhë ndër 20 më të përhapurat në Europë, por njëherësh ndër më pak të studiuarat, me një bashkësi kombëtare që synon integritet europian si tërësi, me shtete ku kjo gjuhë është zyr-tare, me diasporë të fuqishme në vendet gjermanishtfolëse e me prani gjithnjë e më të madhe në relatat ndërkombëtare. Në këtë drejtim ka vend për angazhim për të gjithë ne si studiues, por edhe për institucionet shtetërore e shoqërore përkatëse.

Konferenca i mbaroi punimet duke shprehur dhe një herë nevojën dhe interesin e shkencës për një ko-munikim më të ngjeshur midis studiuesve në fushat e albanistikës në vendet e ndryshme gjermanishtfolëse

me studiuesit në botën ku flitet shqip”.

INAUGUROHET ANËTARI I JASHTËM I ASHAK PROF. DR. MATTEO MANDALA

Më 26 tetor 2017 në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës u bë inaugurimi i anëtarit të jashtëm të saj, prof. dr. Matteo Mandalà. Në praninë e anëtarëve të Akademisë, pjesëmarrësve të Konferencës ndërkombëtare shkencore :”Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht” dhe mysafirëve të shumtë ceremoninë e hapi Kryetari i Akademisë, akademik Hivzi Islami, i cili në fjalën e tij e çmoi lartë veprimtarinë dhe kontributin e Prof. Mandala, duke thënë:

Të nderuar studiues dhe miq,
Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni në fillim t’ju uroj punë të mbarë në këtë Konferencë shkencore të organizuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe



Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Është një rast i rrallë të tubosh në një vend emrat e njohur të albanologjisë rreth një teme bosht - "Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht". Nuk ka asnjë dyshim se me trajtesat, kontributet dhe faktet që do t'i kumtoni këto dy ditë, do të sillni rezultate të rëndësishme për shkencën e albanologjisë dhe më gjerë. Rëndësia pasuese e kësaj Konference qëndron në nxjerrjen në dritë të kumtesave dhe diskutimeve, me botimin e tyre në një vëllim të veçantë ashtu siç vepron Akademia jonë dhe natyrisht prof. Rexhep Ismajli, sepse pa të nuk bëhen këto punë.

Akademia jonë që nga themelimi para 42 vjetësh pranon dhe anëtarë të jashtëm të saj. Sipas Ligjit, në këtë status "mund të zgjidhen punonjësit e shkencës ose të artit që jetojnë dhe veprojnë jashtë vendit, të cilët kanë krijuar vepra të rëndësishme për Kosovën, ose vepra me vlerë të përgjithshme për shkencën ose artin". Kjo Akademi ka zgjedhur anëtarë të jashtëm nga katër anët e botës, emra të mëdhenj të albanologjisë, ballkanologjisë, linguistë të spikatur në rrafshin teorik, figura të njohura të shkencave të natyrës, të shkencave shoqërore dhe të arteve. Në këtë sallë i kemi disa prej tyre, ndër albanologët më të shquar sot: Prof. Wilfried Fiedleri, Prof. Bahri Beci dhe Prof. Francesco Altimari.

Në zgjedhjet e fundit në dhjetor të vitit 2016, Kuvendi i Akademisë, me propozim të Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, zgjodhi anëtar të jashtëm edhe Prof. dr. Matteo Mandalanë. Dhe

sot, dua të përfitoj nga ky rast i veçantë që t'i ndaj, para jush, prof. Mandalasë, fletëdëshminë e anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Prof. Matteo Mandalà, studiues i letërsisë arbëreshe dhe i asaj shqiptare në përgjithësi, por edhe i gjuhës, dialektologjisë, kulturës dhe traditave arbëreshe, profesor i Universitetit të Palermos, është një nga personalitetet më të rëndësishme të shkencës dhe kulturës arbëreshe, por edhe i filologjisë shqiptare në përgjithësi. Bota e Arbëreshëve të Italisë prof. Francesco Altimarin dhe Prof. Matteo Mandalanë, i konsideron themelues të filologjisë moderne arbëreshe, personalitete nga më të vlerësuarit të studimeve për gjuhën, letërsinë e vjetër arbëreshe dhe shqiptare përgjithësisht, nga fillimet e deri më sot, për kulturën dhe traditën arbëreshe dhe për arsimimin, vetëdijesimin e qenies dhe identitetit arbëresh në Itali. Andaj ishte një kënaqësi, por edhe nder e privilegj që t'i kemi në mesin e anëtarëve të jashtëm, më të respektuar, të shkencave të albanologjisë.

Duke mos dashur t'ju shkëpus më shumë nga aktiviteti, për të cilin jeni tubuar këtu, ftoj prof. dr. Matteo Mandalanë ta marrë fletëdëshminë e anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

ZV/KRYEMINISTRI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS Z. ENVER HOXHAJ VIZITON ASHAK-un

Më 13 nëntor 2017, Zv/Kryeministri i



Qeverisë së Republikës së Kosovës, prof. dr. Enver Hoxhaj, i bëri një vizitë Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Kryetari i ASHAK-ut, akademik Hivzi Islami, e njoftoi Zv/Kryeministrin për veprimtarinë e Akademisë, për rrjedhat e punës, rezultatet dhe problemet në kushtet e reduktuara financiare, si në aspektin e vijave buxhetore për zhvillimet në shkencë dhe hulumtime në përgjithësi në Kosovë, ashtu dhe në aspektin e buxhetit të rezervuar për veprimtaritë e ASHAK-ut. Kryetari i Akademisë e njoftoi z. Hoxhaj edhe për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe hapjen e Akademisë ndaj hapësirës akademike dhe kërkimore-shkencore, nënshkrimin e shumë marrëveshjeve të bashkëpunimit me akademitë simotra në rajon dhe në Evropë. Para dy javëve, Akademia jonë, në Asamblenë e Përgjithshme të Unionit të Akademive Ndërkombëtare në Tokio, u bë anëtare e rregullt e tij, me

të gjitha të drejtat. Kryetari Islami e njoftoi Zv. Kryeministrin për projektet afatshkurta, afatmesme dhe afatgjata të Akademisë.

Z. Hoxhaj, shprehu vlerësimin e tij të lartë për Akademinë dhe gadishmërinë e tij dhe të Qeverisë që të mbështesin punën dhe veprimtarinë e Akademisë, e cila gjithnjë po zgjerohet, duke mirëpritur angazhimin e kësaj themelate dhe të institucioneve të tjera shkencore në të gjitha çështjet e zhvillimeve në Republikë, pa e lënë anash edhe Luginën e Preshevës. Interesimi i z. Hoxhaj u përqendrua kryesisht në bashkërenditjen e punëve të Akademisë me institucionet e tjera në Kosovë, në hapësirën shqiptare dhe në Evropë në sferën e hulumtimeve shkencore. Veçanërisht i shprehu mirënjohje Akademisë për integrimin e saj në institucionet relevante akademike dhe shkencore në rajon dhe në Evropë dhe më këtë në afirmimin e Kosovës në suaza ndërkombëtare.

PËRFAQËSUES TË ASHAK-ut MARRIN PJESË NË KONFERENCËN SHKENCORE "Qytetërimi i Voskopojës dhe shekulli i Iluminizmit në Ballkan".

Më 12-15 nëntor, me ftesë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë delegacioni nga ASHAK ka qëndruar në Shqipëri, me qëllim të pjesëmarrjes në Konferencën shkencore ndërkombëtare: "Qytetërimi i Voskopojës dhe shekulli i Iluminizmit në Ballkan".

Aktiviteti i Konferencës është zhvilluar në dy pjesë, në Tiranë, më 13 nëntor dhe në Voskopojë më 14 nëntor.

Nga ASHAK-u akademik Ali Aliu, nënkryetar, është paraqitur me fjalë përshëndetëse, ndërsa akademik Rexhep Ismajli ka drejtuar seancën e tretë të Konferencës dhe anëtari korrespondent Kujtim Shala ka drejtuar seancën e katërt dhe ka paraqitur kumtesën me titull: "Voskopoja dhe "tjetri".

ASHAK MERR PJESË NË PANAIRIN E LIBRIT "TIRANA 2017"

Nga data 15 deri 19 nëntor 2017, në Tiranë është mbajtur Panairi i 20-të ndërkombëtar i librit "Tirana 2017." ASHAK-u është paraqitur me botimet e veta në mesin e rreh 80 shtëpive botuese, institucioneve shkencore dhe arsimore nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, dhe Mali i Zi, përfshirë qendrat kulturore të disa nga ambasadave vendeve të akredituara në Tiranë. ASHAK-u ka pasur prezantim

të mirë. Janë shitur mbi 150 botime, veçanërisht të dy viteve të fundit.

Sikurse edhe në vitet e mëparshme, në këtë panair janë blerë një numër i konsiderueshëm i botimeve dhe një numër revistash e botime të tjera, kryesisht të reja apo që i kanë munguar Bibliotekës së ASHAK-ut.

VIZITË E LIDERËVE TË LUGINËS SË PRESHEVËS NË ASHAK

Kryetari i komunës së Bujanocit, z. Shaip Kamberi dhe ish-kryetarja e Komunës së Preshevës, znj. Ardita Sinani, më 21 nëntor 2017 i bënë një vizitë Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Me atë rast e njoftuan kryetarin e Akademisë, akademik Hivzi Islamin dhe sekretarin e Seksionit të Shkencave Shoqërore, akademik Jusuf Bajraktarin, për rrjedhat shoqërore dhe politike të Luginës dhe problemet me të cilat po ballafaqohen shqiptarët e Luginës, të diskriminuar në vazhdimësi në të gjitha aspektet nga regjimi i Beogradit. Ata ngritën disa çështje shqetësuese: mosrealizimi i kërkesave politike, ngecja në zhvillim ekonomik e social, shpërnguljen e shqiptarëve dhe tendencat për një valë të fuqishme të paralajmëruar të kolonizimit të Luginës me serbë nga Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina dhe viset e tjera. Kërkuan një mbështetje në rrafshin shkencor nga Akademia për trajtimin e Luginës dhe pozitën e rëndë të shqiptarëve atje, e cila nuk dallon nga koha e Millosheviqit.

Udhëheqësit e Akademisë e njoftuan delegacionin e Luginës së Preshevës



për punën, rezultatet dhe planet e Akademisë, hapjen e saj ndaj institucioneve akademike dhe shkencore-kërkimore në rajon dhe në Evropë. I premtuan delegacionit se do ta mbështesin Luginën në planin shkencor, ashtu siç e kanë mbështetur deri tash, me tri botime shkencore, duke u bërë kështu Lugina një nga trevat shqiptare më të hulumtuara e më të studiuara.

AKADEMIK REXHEP ISMALI QËNDRON NË KINË

Me ftesë të Foreign Studies University, Departamenti i Gjuhës shqipe, në Pekin, akademik Rexhep Ismajli, më 26 nëntor deri më 3 dhjetor, ka qëndruar në Pekin. Ai u paraqit atje me ligjërata të fushave: Shqipja standarde-zhvillimet e vona; Gjuha-identiteti në Ballkan; Zhvillimet në Kosovës në dy dekadat e fundit.

AKADEMIK HIVZI ISLAMI MERR PJESË NË KONFERENCËN SHKENCORE NDËRKOMBËTARE: “Hapësirat Ndërkufitare, Dinamika dhe Sfida”

Nën organizimin e Universitetit të Tiranës, Departamentit të Gjeografisë dhe Universitetit të Gjirokastrës, Departamentit të Gjeografisë, në Gjirokastrë, më 1 dhe 2 dhjetor, u organizua Konferenca shkencore ndërkombëtare: “Hapësirat Ndërkufitare, Dinamika dhe Sfida”. Akademik Hivzi Islami, në mbledhjen plenare paraqiti referatin: “Kufiri Kosovë-Mali i Zi: problemet, diskursi dhe efektet”. Referati zgjoi interesimin e pjesëmarrësve, me ç’rast pati shumë diskutime dhe pyetje nga ana e tyre.

MBAHET TRYEZA SHKENCORE:” RRUGA DREJT INTEGRIMIT EKONOMIK EVROPIAN E KOSOVËS

Tryeza u mbajt më 29 nëntor 2017 në



mjediset e Akademisë, nën organizimin e Këshillit organizues në përbërje prej: akademik Isa Mustafa, anëtare korrespondente Justina Shiroka-Pula dhe Prof. Dr. Valentin Toçi.

Fjalën e hapjes e mbajti akademik Jusuf Bajraktari, Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore.

Tryeza u zhvillua në dy sesione dhe me kumtesa u paraqitën dhjetë studiues të fushës përkatëse.

Gjithashtu pati edhe diskutime nga një numër i konsiderueshëm i pjesëmarrësve.

Tryeza përfundoi punimet me sukses. Kontributet autoriale të saj do të botohen në një vëllim të veçantë.

MBAHET TRYEZA MUZIKOLOGJIKE: "KOMPOZITORËT TANË PËR NËNËN SHËN TEREZË BOJAXHIU"

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Seksioni i Arteve, organizoi

Tryezën muzikologjike "Kompozitorët tanë për Nënë Shën Terezë Bojaxhiu". Tryeza u mbajt, më 30 nëntor 2017, në mjediset e Akademisë.

Fjalën e hapjes e mbajti akademik Zeqirja Ballata, ndërsa më pas u paraqitën me kumtesa:

Monsignor Don Lush Gjergji-"Prijet artistike të Nënës Shën Terezë Bojaxhiu";

Zeqirja Ballata-"Këngët korale për Shën Terezën tonë";

Indira Çipa-"Veprat kamerale për Nënë Shën Terezë";

Kushtrim Jakupi-"Këngët solo/romancat për Shën Terezën tonë";

Arnisa Rexhepi-"Këngët korale pionierësh kushtuar Nënës Shën Terezë", dhe

Rreze Kryeziu Breznica-"Të korrat e kompozitorëve tanë për Shën Terezën".

Tryeza përmbylli punimet me sukses.

AKADEMIK REXHEP ISMAJLI QËNDRON NË TIRANË

Me ftesë të Universitetit të Tiranës, akademik Ismajli, më 6 dhjetor, ka marrë pjesë Konferencën shkencore ndërkombëtare: “Gjuha shqipe në kontakt me gjuhët e tjera”. Konferenca u mbajt në mjediset e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe akademik Ismajli paraqiti kumtesën: “Historia dialektore e shqipes dhe ballkanistika”. Kumtesa u prit me interesim nga ana e pjesëmarrësve.

MBAHET TRYEZA SHKENCORE: “SFIDAT E NDËRTIMIT TË SHTETIT TË SË DREJTËS”

Tryeza u organizua nga Këshilli organizues në përbërje prej anëtar korrespondent Arsim Bajrami, kryetar, akademik Jusuf Bajraktari, anëtar, akademik Anton Berishaj, anëtar, anëtare korrespondente Gjyljeta

Mushkolaj, sekretare dhe anëtar korrespondent Frashër Demaj, anëtar dhe u mbajt më 8 dhjetor 2017, në mjediset e Akademisë.

Fjalën e hapjes e paraqiti akademik Jusuf Bajraktari, sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore. Pas paraqitjes së fjalës hyrëse me kumtesat e tyre u paraqitën tetë studiues nga fusha përkatëse, të cilët elaboruan problemet e ngritura në tryezë.

Tryeza u zhvillua në dy sesione dhe pas kumtesave u zhvillua një debat nga pjesëmarrësit në tryezë.

Tryeza përmbylli punimet me sukses. Kontributet autoriale do të botohen në një vëllim të veçantë.

ZGJEDHET KRYESIA E RE E ASHAK-ut

Kuvendi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 21 dhjetor 2017, mbajti zgjedhjet e rregullta të udhëheqjes së Akademisë dhe zgjodhi Kryesinë e re të Akademisë:



1. Akademik Nexhat DACI, Kryetar;
2. Akademik Jusuf BAJRAKTARI, Nën-kryetar;
3. Anëtare korrespondente Myzaferë LIMANI, Sekretar shkencor.

Kuvendi i Akademisë gjithashtu miratoi zgjedhjen e sekretarëve të seksioneve:

1. Akademik Eqrem BASHA, Sekretar i

- Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë;
2. Anëtare korrespondente Justina PULA, Sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore;
 3. Anëtar korrespondent Fetah PODVORICA, Sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës;
 4. Anëtar korrespondent Luan MULLIQI, Sekretar i Seksionit të Arteve.



VJETARI

2017

Botues

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:

Mr. Shefqet Riza

Redaktor teknik:

ASHAK

Realizimi kompjuterik:

ASHAK

Madhësia: 9 tabakë shtypi

Tirazhi: 200 copë

Formati: 16x24 cm

Shtypi:

Focus Print

Shkup